MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

RAPORT PËR GJENDJEN E NATYRËS

2018 - 2021

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

I. **PJESA HYRËSE** 12
1.1. Karakteristikat e përgjithshme të Kosovës 12
1.2. Qëllimi i raportit 13
1.3. Historiku i mbrojtjes së natyrës së Kosovës 14
1.3.1. Gjendja aktuale në IKMN 14

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E NATYRËS 15
2.1. Korniza ligjore
2.1.1. Ligjet 15
2.1.2. Aktet nënligjore të miratuara 15
2.1.3. Aktet në procedurë për miratim 2018 – 2021 16
2.1.4. Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve komunale 16
2.1.5. Lejet dhe licencat për mbrojtjen e natyrës 16
2.2. Korniza Institucionale 17
2.2.1. Organet vendimmarrëse 17
2.2.2. Organet përgjegjëse për menaxhimin e natyrës 17
2.2.3. Punët profesionale për mbrojtjen e natyrës 17
2.3. Analizë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitet 2016 - 2020 17

III. KRONOLOGJIA E ZONAVE TË MBROJTURA 22
3.1. Periudha 2018 - 2021 23

IV. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS 24
4.1. Klasifikimi i zonave të mbrojtura 24
4.1.1. Rezervat Strikt Natyrës 25
4.1.2. Park Kombëtar 25
4.1.3. Zona e Veçantë e Mbrojtur - ZVM dhe ZVR 25
4.1.4. Park Natyre 25
4.1.5. Monument i Natyrës 25
4.1.6. Peizazh i Mbrojtur 26
4.1.7. Monument i Arkitekturës së Parkut 26

V. REZERVATET STRIKTE 26
5.1. Lëndina e Shenjtë 26
5.2. Shutmani 27

5.3. Bredhiku 27
5.4. Pashallarë 27
5.5. Gryka 28
5.6. Lumbardhi 28
5.7. Luboteni 28
5.8. Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit 29
5.9. Koritniku 29
5.10. Kobilica 30
5.11. Dupnica 30
5.12. Bistra 30
5.13. Malet e Prilepit 31
5.14. Gubavci 31
5.15. Rusenica 32
5.16. Oshlaku 32
5.17. Maja e Arnenit 33
5.18. Pisha e Madhe 33
5.19. Kamilja 34
5.20. Gjendja 34
5.21. Rekomandimet 35

VI. PARKU KOMBËTAR "SHARRI" 36
6.1. Të dhënat e përgjithshme për Parkun Kombëtar "Sharri" 36
6.2. Gjendja e resurseve natyrore në Parkun Kombëtar "Sharri" 37
6.3. Ekosistemet pyjore 37
6.4. Ekosistemet barishtore 38
6.5. Zonat e para të mbrojtjes – Zonat strikte natyrore 39
6.6. Resurset ujore 40
6.7. Fauna 41
6.8. Masat sanitare për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve 42
6.9. Zonat turistike dhe ndërtimet në PK "Sharri" 42
6.10. Sfidat dhe problemet në Parkun Kombëtar "Sharri" 45
6.11. Rekomandimet 45

VII. PARKU KOMBËTAR "BJESHKËT E NEMUNA" 47
7.1. Vështrim i përgjithshëm PK. "Bjeshkët e Nemuna" 47
7.2. Flora 48
7.3. Fauna 49
7.4. Resurset ujore 50
7.5. Gjendja e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 51
7.6. Zjarret 56
7.7. Sfidat dhe problemet në PK "Bjeshkët e Nemuna" 58
7.8. Rekomandimet 58

VIII. ZONAT E VEÇANTA – ZVM dhe ZVR 60

8.1. Ligatina e Hencit-Radevës - Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve 60
8.2. Gjendja 61
8.3. Rekomandimet 62

IX. PARK NATYRE 62
9.1. Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës 62
9.2. Flora 63
9.3. Vegjetacioni 63
9.4. Fauna 64
9.5. Gjendja 64
9.6. Rekomandimet 65

X. MONUMENTET E NATYRËS 65
10.1. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes*"* 65
10.1.1. Gjendja 65
10.1.2. Rekomandimet 67
10.2. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës" 67
10.2.1. Gjendja 68
10.2.2. Rekomandimet 69
10.3. Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit 70
10.3.1. Gjendja 71
10.3.2. Rekomandimet 71
10.4. Bifurkacioni i Lumit Nerodime 72
10.4.1. Gjendja 73
10.4.2. Rekomandimet 74
10.5. Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë 75
10.5.1. Gjendja 75
10.5.2. Rekomandimet 76
10.6. Gjendja e disa Monumenteve tjera 76
10.6.1. Rekomandimet 78

XI. PEIZAZHET E MBROJTURA 79
11.1. Peizazhi i Mbrojtur "Gërmia" 79
11.1.2. Flora dhe vegjetacioni 79
11.1.3. Fauna e Gërmisë 80
11.1.4. Gjendja 81
11.1.5. Rekomandimet 82
11.2. Peisazhi i mbrojtur "Shkugëza" 82
11.2.1. Flora dhe vegjetacioni 83
11.2.2. Fauna 83
11.2.3. Gjendja 84
11.2.4. Rekomandimet 84
11.3. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës" 84
11.3.1. Gjendja 85

11.3.2. Rekomandimet 86
11.4. Perizazhi i Mbrojtur "Lugina e Lumit Llapushnik" 86
11.4.1. Rekomandimet 87

XII. ZONAT TJERA TË MBROJTURA 87
12.1. Vend gjuetitë me rëndësi të veçantë (VGJRV) 87
12.1.1. Vend gjuetia e rëndësisë së veçantë "Blinaja" 88
12.1.2. Vend gjuetia me rëndësi të veçantë "Duboçaku" 89
12.1.3. Vend gjuetitë e përbashkëta (VGJP) 89
12.1.4. Rekomandimet *90*
12.2. Natyra 2000 91
12.2.1. Rekomandimet 92
12.3. Pylli i Arinjve Prishtina 92
12.3.1. Gjendja 93
12.3.2. Projektet e gjelbërta 93
12.3.3. Rekomandimet 94

XIII. BIODIVERSITETI 95
13.1. Florës dhe vegjetacionit 95
13.1.1. Statuti i llojeve te vlerësuara 98
13.1.2. Kërpurdhat 99
13.2. Fauna 100
13.2.1. Libri i Kuq i Faunës 104
13.3. Gjendja 105
13.4. Konkluzionet 107
13.5. Rekomandimet 107

XIV. HIDROCENTRALET NË ZONAT E MBROJTURA - RREZIK PËR BIODIVERSITETIN 109
14. Rekomandimet 111

XV. PYJET E KOSOVËS 112
15.1. Aktivitetet për menaxhimin e pyjeve 114
15.2. Aktivitetet për mbrojtjen e pyjeve 114
15.3. Zjarret pyjore gjatë vitit 2018-2020 115
15.4. Aktivitetet në pyllëzime 116

XVI. INSPEKTIMI DHE PROCEDURAT LIGJORE TË NDËRMARRA NË FUSHËN E MBROJTJES SË NATYRËS 117

XVII. DISA PROJEKTE DHE AKTIVITETE TË RËNDËSISHME PËR MBROJTJEN E NATYRËS 2018 - 2021 120
17.1. Raportimi në EEA/EIONET 120
17.2. Cenzusi Ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit 2021 në Kosovë 121
17.3. Shpallja e llojeve të mbrojtura 121
17.4. Atllasi i Bimëve të Kosovës 122
17.5. SPELEOMEDIT një monografi për Speleologjinë e vendeve të Mesdheut 123
17.6. Habitati i llojit endemik Boshtra një vlerë e shtuar e regjistrit të zonave të mbrojtura 124
17.7. Përfaqësuesit e parqeve të Kosovës, diskutojnë për bashkërendimin e aktiviteteve në kuadër të rrjetit të Parqeve Dinarike 124
17.8. Unazimi i dy individëve të llojit Lejleku i Zi 125
17.9. Bashkëpunim me UP- FSHMN - Departamentin e Biologjisë 126
17.10. Parku Kombëtare Malet e Sharrit, habitat i një kërpudhe shumë të rrallë 126
17.11. Shenjëzimi i rezervateve strikte të natyrës 127
17.12. Me moton është koha për natyrën, AMMK shënoi Ditën Botërore të Mjedisit 127
17.13. Cenzusi ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit 128
17.14. Flora e Kosovës pasurohet edhe me një gjini dhe lloj të ri 129
17.15. Publikohet Libri i Kuq i Faunës së Kosovës 129
17.16. Zbulohet një lloj i ri për faunën e Kosovës 130
17.17. Kosova anëtarësohet në organizatën ndërkombëtare IUCN 131
17.18. Trajnimi i stafit të Parqeve Kombëtare për monitorimin e faunës së egër 132
17.19. Vendosen platforma me fole të lejlekëve 132
17.20. Ekspeditë hulumtuese Speleologjike 133
17.21. Bashkëpunimi me Shoqatën Evropiane "Brezi i Gjelbër Evropian" 133
17.22. Aktivitetet e organizuara nga MMPH për shënimin e "Ditës nderkombtare të biodiversitetit" dhe promovimin e vlerave për mbrojtjen e natyrës 2018 – 2021 134

XVIII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET 136
XIX . REFERENCAT 139
XX. SHTOJCA I: Harta e zonave të mbrojtura 2021 141
XXI. SHTOJCA II: Lista e zonave të mbrojtura 2021 142

Lista e shkurtesave

IKMN - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
AMMK - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
GZRK - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
QRK - Qeveria e Republikës së Kosovës
MAPL - Ministria e Administratë të Pushtetit Lokal
MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
DPK - Drejtoria e Parkut Kombëtar
PK - Parku Kombëtar
MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
BE - Bashkimi Evropian
OS - Objektivi Strategjik
IUCN - Organizata Botërore për Ruajtjen e Natyrës
IPA - Instrumentet e Para Aderimit
OJQ - Organizatat Jo Qeveritare
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
UP - Universiteti i Prishtinës
ZVB - Zone e Veçantë e Mbrojtur
AKP - Agjencioni Kosovar për Privatizim
MNRV - Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë
VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VGJRV - Vend gjuetitë me rëndësi të veçantë
EEA - Agjencia Evropiane e Mjedisit
IKP - Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve
PKPR - Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit i Kosovës
PKSHP - Programi Kombëtar i Shëndetit të Pyjeve
MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AME - Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave
PMK - Programit Mjedisor te Kosovës
KEDS - Kompaninë Kosovare për distribuim të Energjisë Elektrike
PLVB - Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
VGJP - Vend Gjuetitë e Përbashketa

Lista e tabelave

Tabela nr. 1. Realizimi i Planit të Veprimit për Biodiversitet sipas aktiviteteve (masat dhe veprimeve)
Tabela nr. 2. Zonat e Mbrojtura sipas kategorive (2021)
Tabela nr. 3. Prerja e pyjeve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 2018-2021 (në bazë të fletëparaqitjeve të drejtorisë)
Tabela nr. 4. Zjarret në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 2018 - 2021
Tabela nr. 5. Numri i vizitorëve në Shpellën e Gadimës
Tabela nr. 6. Lisat e Monumenteve të dëmtuara
Tabela nr. 7. Lista e Monumenteve që e kanë humbur statuesin e zonës së mbrojtur
Tabela nr. 8. Numri i vizitorëve sipas viteve 2018 - 2021
Tabela nr. 9. Numri i specieve bimore sipas kategorive të Listës së Kuqe të IUCN -së.
Tabela nr. 10. Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër.
Tabela nr. 11. Shpërndarja e llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës, sipas IUCN-së.
Tabela nr. 12. Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit, (ha)
Tabela nr. 13. Kallëzimet - fletëparaqitjet, 2018 - 2020
Tabela nr. 14. Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja në / ha, 2018-2020
Tabela nr. 15. Pyllëzimet, 2019-2020
Tabela nr. 16. Veprimet e ndërmarra në fushën e natyrës.
Tabela nr. 17. Inspektimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit
Tabela nr. 18. Veprimet e drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
Tabela nr. 19. Veprimet e drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri"

Lista e figurave

Figura nr. 1. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2021
Figura nr. 2. Numri i ndërtimeve në park sipas veprimtarive
Figura nr. 3. Natyra 2000
Figura nr. 4. Format jetësore të taksoneve sipas Raunkierit
Figura nr. 5. Numri i taksoneve
Figura nr. 6. Numri i llojeve bimore sipas kategorive të kërcënueshëmrisë
Figura nr. 7. Grupet themelore taksonomike të kërpudhave në Kosovë
Figura nr. 8. Klasat e përdorimit të tokës (%) nga sipërfaqja e përgjithshme
Figura nr. 9. Sipërfaqja e djegur të pyjeve në ha / vit 2008-2020
Figura nr. 10. IUCN

Lista e hartave

Harta nr. 1. Rezervatet strikte në Parku Kombëtar "Sharri"
Harta nr. 2. Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
Harta nr. 3. Ligatina e Hancit - Radevës
Harta nr. 4. Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës
Harta nr. 5. MNRV "Ujëvarat e Mirushës"

Harta nr. 6. Kufiri i Bifurkacionit të Lumit Nerodime i propozuar për mbrojtje
Harta nr. 7. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"
Harta nr. 8. Performanca e përgjithshme e shteteve në raportimin e vitit 2020
Harta nr. 9. Vendbanimi i llojit endemik Forsythia europaea
Harta nr. 10. Harta e shtrirjes së Brezit të Gjelbër

Lista e fotove

Foto nr. 1. Rrëqebullit Ballkanik (Lynx lynx)
Foto nr. 2. Bashkësia pyjore e Rrobullit (Pinetum heldreichii)
Foto nr. 3. Rezervati Strikt "Bistra"
Foto nr. 4 dhe 5. Shfrytëzimi ilegal i kullotave në rezervatin strikt të "Shutmanit"
Foto nr. 6. Parku Kombëtar "Sharri"
Foto nr. 7. Dëmtimi pyjeve nga zjarret dhe insektet dëmtues në pyjet e rrobullit në Koritnik
Foto nr. 8. Kullosat e maleve të larta në Vraca
Foto nr. 9. Ujëvara e Lumëbardhit në Parkun Kombëtar "Sharri"
Foto nr. 10. Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica
Foto nr.11 dhe 12. Ndërtimet ilegale në zonën e Gradac (komuna e Suharekës)
Foto nr. 13 dhe 14 Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica
Foto nr. 15 dhe 16 Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica
Foto nr. 17. Ndërtimet ilegale në Restelicë
Foto nr. 18. Ndërtimet ilegale në Prevallë
Foto nr. 19. Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
Foto nr. 20. Karafili i Sharrit (Diantus scardica)
Foto nr. 21. Sanëza (Gerntina lutea)
Foto nr. 22. Rrëqebulli Ballkanik (Lynx lynx balcanicus),
Foto nr. 23. Kaprolli (Capreolus capereolus)
Foto nr. 24. Ariu i murrëm (Ursus arctos)
Foto nr. 25. Ndërtimi i objekteve në Koshutan
Foto nr. 26. Ndërtimi i objekteve në Shkrel
Foto nr. 27. dhe 28. Ndërtimi i objekteve në Shtupeq dhe Stankaj
Foto nr. 29. Ndërtimi i objekteve në Bogë
Foto nr. 30. Ndërtimet në Bjeshkën e Lumëbardhit
Foto nr. 31. Ndërtimet në Qërshizë
Foto nr. 32. Ndërtimet në Bjeshkën e Strellcit
Foto nr. 33. Hapja e rrugëve të reja në Kushutan
Foto nr. 34. Ndërtimi i rrugës Junik - Lugu i Gjatë
Foto nr. 35 dhe 36. Rrëshqitjet masive e dheut në rrugën Deçan-Plavë dhe Lumbardhë - Milishevc
Foto nr. 37. Eksploatimit i shkëmbinjve gëlqerorë (afër KFOR-it, Italian në Pejë)
Foto nr. 38. Zjarri në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", njësia ekonomike Hajla - Shtupeq i Madhë
Foto nr. 39 dhe 40. Dëmtimi i pyjeve nga zjarret në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna",
Foto nr. 41. Peizazh nga Ligatina e Hencit - Radevës
Foto nr. 42. Rosa sqeplugë (Anas clypeata)

Foto nr. 43. Anax imperator
Foto nr. 44. Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vermicës
Foto nr. 45. Cerfalare e Pashtrikut (Cephalaria pastricensis)
Foto nr. 46. Kemashna (Hieraciumwaldsteinii)
Foto nr. 47. Polyommatus Icarus
Foto nr. 48. Pieris mannii
Foto nr. 49. Calias alfacariensis
Foto nr. 50. Gjendja e ndriçimit në Shpellën e Gadimës
Foto nr. 51. Myshqet në Shpellën e Gadimës
Foto nr. 52. Ujëvarat e Mirushës
Foto nr. 53 dhe 54. Zgjerimi i rrugës dhe rrëshqitja e dheut në MNRV "Ujëvarat e Mirushës
Foto nr. 55 dhe 56. Ndërtimet ilegale në MNRV "Ujëvarat e Mirushës"
Foto nr. 57 dhe 58. Burimi i Drinit të Bardh dhe Shpella e Radavcit
Foto nr. 59 dhe 60. Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur
Foto nr. 61. Bifurkacioni i lumit Nerodime
Foto nr. 62 dhe 63. Gjendja në degën e majtë të Bifurkacionit
Foto nr. 64. Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur
Foto nr. 65. Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Bubël, Malishevë
Foto nr. 66. Trungun i Dushkut (Quercus sp.) në Llapashticë, Podujevë
Foto nr. 67. Grurëziu i Heraklës (Melampyrum heracleticum)
Foto nr. 68. Hithëbuta e bigëzuar (Lamium bifidum)
Foto nr. 69. Karafili ngjyrë gjaku (Dianthus cruentus)
Foto nr. 70. Zhabinorja iliriane (Ranunculus illyricus)
Foto nr. 71. Liri (Linum gallicum)
Foto nr. 72. Haplofili (Haplophyllum suaveolus)
Foto nr. 73. Dëmtimi i trungjeve nga insektet
Foto nr. 74. Ndërhyrjet në Peizazhin e Mbrojtur "Germia"
Foto nr. 75. Aguliçja e zakonshme (Prinula vulgaris)
Foto nr. 76. Auqla dhëmbëqeni (Erythronium dens-canis)
Foto nr. 77. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"
Foto nr. 78. Lulekambana (campanula glomerata)
Foto nr. 79. Liri i verdhë (linum flavum)
Foto nr. 80. Prerja e trungjeve të ahut në Peizazhin e Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"
Foto nr. 81. Peizazhi i Mbrojtur "Lugina e Lumit LLapushnik"
Foto nr. 82. 83 dhe 84. Fauna në VGJRV "Blinaja"
Foto nr. 85 dhe 86. Fauna në VGJRP në Komunën e Therandës (2021)
Foto nr. 87. 88 dhe 89. Pjesëmarrja e nxënësve në programin edukativ "Gjuetia për thesar"
Foto nr. 90. 91 dhe 92. Projektet e gjelbërta
Foto nr. 93. Lule bozhure (Paeonia peregrina decora)
Foto nr. 94. Tulepani Shqiptar (Tulipa albanica) foto XH. Mala
Foto nr. 95. Iriqza perhereblertë (Saxifraga sempervivum)
Foto nr. 96. Burgulli i Maqedonisë (Sempervivum macedonicum)
Foto nr. 97. Gjeraqina këmbëshkurtër (Accipiter brevipes)
Foto nr. 98. Picrraku (Salamandra salamandra)
Foto nr. 99. Hardhuca e gjelber (Lacerta viridis)

Foto nr. 100. Thëllëza e malit - Alectoris graeca, (B. Hallaci)
Foto nr. 101. Zvarritesi krahekuq - Tichodroma muraria
Foto nr. 102. Lejleku i zi - Ciconia nigra
Foto nr. 103. Ariu i murrëm (Ursus arctos)
Foto nr. 104. Kaprolli (Capreolus capreolus)
Foto nr. 105. Rrëqebulli Ballkanik (Lynx lynx)
Foto nr. 106. dhe 107. Dëmtimi i vegjetacionit në PK. "Bjeshkët e Nemuna"
Foto nr. 108. Fragmentimi i habitateve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
Foto nr. 109. Degradimi i shtratit të lumit Berovec
Foto nr. 110. Degradimi i shtratit të Lumëbardhit në Deçan
Foto nr. 111. Llojet autoktone të pëllumbave
Foto nr. 112. Atllasi i Bimëve të Kosovës
Foto nr. 113. Forsythia europaea (Boshtra)
Foto nr. 114. Unazimi i individë të llojit Lejleku i Zi
Foto nr. 115. Bashkëpunim me UP - Departamentin e Biologjisë
Foto nr. 116. Kërpudha (Zeus olympius)
Foto nr. 117. Shenjëzimi i rezervateve strikte të natyrës
Foto nr. 118. Shënimi i ditës Botërore të Mjedisit
Foto nr. 119. Sternbergia colchiciflora Waldst. et Kit. (Amaryllidaceae)
Foto nr. 120. Libri i Kuq i Faunë
Foto nr. 121. Vertigo moulinsiana, lloj i ri për faunën e Kosovës
Foto nr. 122. Trajnimi i stafit të Parqeve Kombëtare për monitorimin e faunës së egër
Foto nr. 123. Vendosen platforma me fole të lejlekëve
Foto nr. 124. Ekspeditë hulumtuese Speleologjike
Foto nr. 124 dhe 126. Shënimi i ditës botërore të Biodiversitetit (2018)
Foto nr. 127. Shënimi i ditës botërore të Biodiversitetit (2019)
Foto nr. 128. Shënimi i ditës botërore të Biodiversitetit (2020)

1. PJESA HYRËSE

1.1. Karakteristikat e përgjithshme të Kosovës

Rajoni: Evropa Juglindore
Gjerësia: 41° 51’ 21 dhe 43° 16’ Gjatësia: 19° 59’ dhe 21° 47’
Emri zyrtar: Republika e Kosovës
Kryeqyteti: Prishtina
Sipërfaqja: 10,908 km^2
Popullsia: (2021 e vlerësuar) 1,773,971
Dendësia e popullsisë: 163 banorë në 1 km^2
Gjatësia e përgjithshme e kufirit: 743. 5 km
Gjatësia e kufijve: Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror .

- Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim 113.5 km
- Republikën e Maqedonisë në jug 170.7 km
- Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim 79.1 km
- Republikën e Serbisë në veri dhe lindje 380.1 km

Relievi: kodrinor-malor

- 63 % kodrinor-malor
- 37 % fushor

Lartësia mesatare mbidetare: 810 m

- Pika me e ulët 270 m (luginën e Drinit të Bardhë, në kufi me Shqipërinë)
- Pika më e lartë 2656 m (maja e Gjeravicës)

Klima: e mesme kontinentale
Lumi më i gjatë: Drini i Bardhë 111.5 km
Liqeni kryesor: Ujmani (Gazivodë) 9.10 km^2
Numri i zonave të mbrojtura: 248 (2021)
Sipërfaqja e zonave të mbrojtura (2021), 126023.2 ha, ose 11.55 % e sipërfaqes se përgjithshme të Kosovës.

- Rezervate strikte: 19, (1082,96 ha)
- Parqe kombëtare: 2, (115957 ha)
- Monument Natyre: 219, (61735 ha)
- Park Natyre: 1, (5934 ha)
- Peizazh i Mbrojtur: 6, (2227 ha)
- Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve 1 (109 ha)

Zonat biogjeografike: kontinentale dhe alpine

- Zona kontinentale 90 % të sipërfaqes së Kosovës
- Zona alpine 10 % të sipërfaqes së Kosovës

Pyjet: sipërfaqja e përgjithshme 481000 ha (44 %)

Pyjet e larta: 24 %

- Pyjet e mesme: 62 %
- Shkurre: 14 %

Flora: mbi 3000 lloje të florës vaskulare
Fauna: rreth 350 lloje të kurrizorëve, (220 lloje të shpendëve, rreth 20 lloje te reptilëve, mbi 10 lloje te ambifeve, mbi 30 lloje të peshqëve) dhe rreth 600 lloje të pa kurrizorëve (prej tyre rreth 180 lloje të fluturave).
Numri i komunave: 38
Numri i vendbanimeve: 1469

1.2. Qëllimi i raportit

Hartimi i Raportit për gjendjen e natyrës në Kosovë, është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, e rregulluar sipas Ligjit për Mbrojtje e Natyrës, nenit 142. Për nevojat e realizimit të strategjisë dhe programit të mbrojtjes së natyrës dhe dokumenteve tjera me të cilat rregullohen disa çështje për mbrojtjen e natyrës, hartohet raporti për gjendjen e natyrës në Republikën e Kosovës të cilin e miraton Qeveria dhe informohet Kuvendi[1].

Qëllimi kryesor i raportit është informimi për gjendjen e natyrës, zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit të Kosovës. Gjithashtu përmes këtij raporti, synohet të ndikohet edhe në përmirësimin e politikave për menaxhimin dhe konservimin e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit. Raporti do të shërbej edhe si një udhëzues i mirë për orientimin e projekteve dhe mbështetjes së donatorëve në sektorin e mbrojtjes dhe konzermimit të natyrës.

Raporti përmban të dhëna për kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale në sektorin e natyrës, gjendjen e zonave të mbrojtura, biodiversitetin, llojet e rralla bimore e shtazore, ekosistemet pyjore, ndërhyrjet në zonat e mbrojtura, shënimet e disa ndërhyrjeve në natyrë, si dhe aktivitetet dhe projektet e realizuar me qëllim të mbrojtjes së natyrës. Pjesë e rëndësishme e këtij raporti janë edhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e natyrës si dhe konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë mbledhur gjatë vizitave në terren, nga organet menaxhuese të zonave të mbrojtura, si dhe institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Pjesë e raportit janë edhe informatat nga ligjet, strategjitë, publikimet, raportet, analiza e zbatimit të Strategjisë së Biodiverzitetit dhe dokumentet tjera relevante për sektorin e mbrojtjes së natyrës. Prezantimi i gjendjes në raport për disa sektor (fusha) të natyrës është me pak i mbuluar, si pasoj e mungesës të të dhënave. Të dhënat e raportit i referohen periudhës 2018 - 2021, mirëpo në disa raste në mungesë të të dhënave dhe për aspekte të krahasimit, janë prezantuara të dhëna edhe për periudhat e më hershme (Raporti për gjendjen e natyrës 2010 - 2014 dhe raporti për gjendjen e natyrës 2015 -2017).

[1] Ligji Nr.03/L-233

1.3. Historiku i mbrojtjes së natyrës në Kosovë

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të 50 - ta. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Në vitin 1974 me Vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, themelohet Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, i cili vazhdoi punën me të njëjtin emër sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit.

Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së, me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës", me seli në Prishtinë. Në maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në kuadër të tij përfshihen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Mali Sharr".
Pas formimit të organeve qeverisëse të Kosovës (2001) formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në vitin 2002 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.2002/8 (Rreg.2003/22) sipas të cilit është paraparë themelimi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, dhe në kudër të tij të përfshihet Instituti i Kosovë për Mbrojtjen e Natyrës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovë.
Në vitin 2006 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Rreg. 2006/22), sipas këtij Ligji, Instituti është përgjegjës për çeshtjet e mbrojtjes së natyrës (neni 9 paragrafi 2). Në vitin 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Nga viti 2006, në kuadër te AMMK ka vepruar sektori për mbrojtjen e natyrës, ndërsa në vitin 2013 rithemelohet Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

1.3.1. Gjendja aktuale në IKMN

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233, GZRK Nr. 85/09, 2010), Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, është përgjegjësi për të gjitha punët profesionale në fushën e mbrojtjes së natyrës në Kosovë. Aktualisht, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e natyrës realizohet përmes IKMN-së, i cili vepron në kuadër të AMMK-së, me staf të pamjaftueshëm, me vetëm tre (3) zyrtarë, një (1) zyrtar për biodiversitet / faunë, një (1) zyrtar për florë dhe një (1) zyrtar për zonat e mbrojtura,
IKMN-ja, më numër kaq të vogël të stafit e ka të pa mundur realizimin e planit të punës, obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, implementimin e tij, raportimin në Agjencinë Evropine për Mjedis, si dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga konventat ndërkombëtare dhe Direktivat e Bashkimit Evropian (*Direktiva 2009/147/EC për ruajtjen e zogjve të egër dhe Direktiva 92/43/EEC për ruajtjen e vendbanimeve natyrore të florës dhe faunës së egër dhe rrjeti ekologjik "Natyra 2000*", etj.).

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E NATYRËS

2.1. Korniza ligjore

Përgjegjësia për Natyrën, Biodiversitetin dhe Mjedisin, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës i takon secilit (Neni 52).

2.1.1. Ligjet

Kuadri ligjor për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në Republikën e Kosovës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës GZRK Nr. 85/09 (Nëntor 2010);
- Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" GZRK Nr. 2/21 (Janar
- 2013);
- Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri" GZRK Nr. 2/21 (Janar 2013);
- Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedsit GZRK Nr.50/09 (Prill 2009);
- Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës me ndryshimet dhe plotësime 2004/29;
- Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, (11 Gusht 2006);
- Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (23 Shtator 2010);
- Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, (30 Shtator 2010);
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, (31 Korrik 2013);
- Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, (10 Tetor 2006);
- Ligji Nr. 02/L-122 për Bujqësi organike, (08 Janar 20008);
- Ligji Nr. 02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve, (31 Janar 2007);
- Ligji Nr. 02/L - 41 për Mbrojtjen nga Zjarri;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

2.1.2. Aktet nënligjore të miratuara

Kuadri ligjor ekzistues për mbrojtjen e natyrës gjatë periudhës 2018 - 2021 është përmirësuar dhe plotësuar me disa akte nënligjore sipas kërkesave për harmonizim me Acquis communitaire.

Në kuadër të obligimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 - 2010, gjatë kësaj periudhe janë miratuar tri (3) Udhëzime Administrative dhe shtatë (7) Vendim i QRK-së.

- Udhëzimi Administrativ MMPH (nr. 05/2018) për përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për mbikëqyrësit e zonave të mbrojtura.
- Udhëzimi Administrativ MEA, (nr. 12/2020) për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura.
- Udhëzimi Administrativ, (nr. 01/2021) për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ MMPH, (nr. 03/2016) për caktimin e tarifave për lëshimin e pëlqimeve,

lejeve, licencave, certifikatave dhe vërtetimeve të parapara me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës.

- Vendimi i QRK, (nr. 07/104) datë 23.05.2019 për shpalljen e zonës së Mbrojtur në kategorinë e Parkut Natyror "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës".
- Vendimi (nr.3173/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Pëllumbi i Pejës" lloj vendor i zbutur.
- Vendimi (nr. 3173-2/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Kryemusmi i Gjakovës" lloj vendor i zbutur.
- Vendimi (nr. 3173-1/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Gjylia e Prizrenit" lloj vendor i zbutur.
- Vendimi (nr. 3173-4/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Piklani i Pejës" lloj vendor i zbutur.
- Vendimi (nr. 3173-5/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Akrobatiku - Dyneku i Kosovës" lloj vendor i zbutur.
- Vendimi (nr. 3173-6/21 datë 16.08.2021) për shpalljen nën mbrojtje të racës autoktone të pëllumbit "Kuti i Drenicës" lloj vendor i zbutur.
- Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet (PLVB) të komunës së Gjakovës (2019-2024).

2.1.3. Aktet në procedurë për miratim 2018 - 2021

- Përgatitja e Plotësim ndryshimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.
- Përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2022-2030.
- Hartimi i draft Planit Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna",
- Hartimi i Planit Menaxhues për PK "Bjeshkët e Nemuna",
- Vendimi i Komunës së Ferizajt për kategorizimin e Bifurkacionit të Lumit Nerodime.

2.1.4 Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve komunale

Sipas kërkesave të pranuara nga MAPL, për vlerësimin e ligjshmërisë se akteve komunale është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimeve për shpalljen nën mbrojtje të 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) monumenteve natyrore dhe një (1) peizazhi të mbrojtur).

2.1.5. Lejet dhe licencat për mbrojtjen e natyrës

Gjatë periudhës së viteve 2018 - 2021 janë lëshuar pesëmbëdhjetë(15) leje për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, bazuar në kërkesat e bëra kryesisht nga institucionet universitare vendore dhe të huaja si dhe organizatat joqeveritare. Gjatë vitit 2021 është lëshuar edhe një Leje për mbajtjen e shtazëve të egra në internim nga Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten Kosova" Prishtinë.

2.2. Korniza institucionale

2.2.1. Organet vendimmarrëse:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës,
- Komisioni funksional i Kuvendit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,
- Qeveria e Republikës se Kosovës,
- Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI

2.2.2. Organet përgjegjëse për menaxhimin e natyrës

- Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI,
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - AMMK,
- Drejtoria e Parkut Kombëtar "Sharri"- DPK,
- Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" - DPK,
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - MBPZHR,
- Agjencia e Pyjeve të Kosovës - APK,
- Instituti i Pylltarisë së Kosovës - IPK,
- Niveli lokal - Komunat.

2.2.3. Punët profesionale për mbrojtjen e natyrës:

- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN (MMPHI),
- Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës - (DMMU/MMPHI),
- Muzeu i Kosovës - MKRS,
- Institucionet shkencore,
- Organizatat mjedisore të shoqërisë civile.

2.2.4. Organet përgjegjëse për Hartimin e Planeve Hapësinore

- Instituti i Planifikimit Hapësinor - (IPH/MMPHI).

2.3. Analizë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitet 2016 – 2020

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2016 - 2020 është dokumenti bazë për mbrojtjen e natyrës, me anë të së cilit janë përcaktuar synimet afatgjate të ruajtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyra e zbatimit të atyre masave dhe veprimeve në harmoni me zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Kosovës.

Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016 - 2020 është plani i dytë pesëvjeçar dhe paraqet dokumentin zbatues të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020, bazuar në objektivat strategjike si në vijim:

Objektiva Strategjike 1: Zhvillimi dhe zbatimi i kornizës ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së. Lidhur me ketë OS mund të raportohet se Ministria ka ndërmarrë masat e duhura lidhur me harmonizimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së, si dhe janë bërë përpjekje që të bëhet fuqizimi në zbatimin e tyre.

Lidhur me këtë Objektiv Strategjik, Ministria (MMPHI) gjithashtu ka ndërmarrë veprime konkrete lidhur me shtimin e kapaciteteve të organeve kompetente për zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit që ndërlidhet me ruajtjen e biodiversitetit.
Për sa i përket legjislacionit për mbrojtjen e natyrës, synimet e kësaj objektive janë arritur në masën prej 80 deri 100% varësisht prej Direktivës, ndërsa sa i përket fuqizimit të legjislacionit kemi hasur në vështirësi të cilat kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve për fuqizim dhe zbatim. Nënshkrimi i Konventave nuk është arritur për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet Kosova (mos anëtarsimi në Kombet e Bashkuara).

Një arritje në këtë objektiv është bërë pas anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore për Ruajtjen e Natyrës (International Union for Conservation of Nature - IUCN), i cili u realizua pas disa përpjekjeve dhe angazhimeve në muajin mars 2019.[2]
Objektiva Strategjike 2: Inicimi dhe mbështetja e projekteve të cilat do të kontribuojnë në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative.
Ministria ka ndërmarrë masa për shtimin e sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura në territorin e Republikës së Kosovës duke ngritur ne përqindje solide prej 11.56 % me çka është siguruar mbulim i disa llojeve dhe vendbanimeve natyrore. Përderisa mbrojtja Ex - situ e burimeve gjenetike bimore dhe shtazore si dhe punët përgatitore për krijimin e rrjetit ekologjik "Natyra 2000" nuk janë realizuar për shkak të mungesës se kapaciteteve institucionale si dhe mungesës së mbështetjes financiare (Këto janë projekte qe edhe vendet e regjionit i kanë përfunduar me asistence të IPA (Instrumenteve të para antaërsimit), andaj jemi duke bërë përpjekje që me IPA III ta përfitojmë këtë asistencë teknike.

Objektiva Strategjike 3: Mbrojtja e natyrës, të përfshihet në politikat sektoriale përmes bashkëpunimit me palët e rëndësishme të interesit. Ministria ka marrë pjesë aktive gjatë procesit të hartimit të politikave sektoriale të: energjisë, bujqësisë, pylltarisë, turizmit dhe gjuetisë si dhe ka kontribuar në krijimin e politikave të integruara sektoriale, menaxhim efektiv dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të biodiversitetit.

Objektiva Strategjike 4: Mbështetja dhe bashkëpunimi i ngushtë me komunat, OJQ-të dhe universitetin në zbatimin e projekteve në sektorin e edukimit dhe komunikimit. Ministria për periudhën raportuese ka bashkëpunuar me komunat, UP, dhe OJQ-të, në shpalljen e zonave të reja të mbrojtura si dhe në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit.

[2] Në vijim linku: https://www.iucn.org/search/Kosovo

Këto katër Objektiva Strategjike janë zbërthyer në 11 (njëmbëdhjetë) Objektiva Specifike (të ashtuquajtura në dokument si "masa") dhe 40 (dyzetë) projekte specifike të ashtuquajtura në dokument si veprime. Lidhur me zbatimin e aktiviteteve/veprimeve me qëllim të arritjes se objektivave strategjike do të japim detajet në tabelën si në vijim:

Tabela 1. Realizimi i Planit të Veprimit për Biodiversitet sipas aktiviteteve (masat dhe veprimet)

Nr.	A k t i v i t e t i	Institucionet përgjegjëse	Gjendja e arritur në realizim
1.	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen Natyrës.	MMPH, QRKS	Ky aktivitet është realizuar plotësisht.
2.	Të vazhdohet me promovimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës tek komuniteti.	MMPH, Komunat	Ky aktivitet është realizuar pjesërisht.
3.	Miratimi i programeve për mbrojtjen e natyrës për secilën komunë.	Komunat, MMPH	Pjesërisht i arritur, vetëm tri komuna kanë aprovuar Programe për ruajtjen e Biodiversitetit.
4.	Lobimi për ratifikimin e Konventave dhe traktateve relevante.	MPJ, MMPH, Kuvendi i Kosovës	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak të statusit të Kosovë është arritur vetëm pranimi në IUCN.
5.	Harmonizimi dhe fuqizimi i legjislacionit dhe qartësimi i kompetencave për menaxhimin e Parqeve Kombëtare.	MMPH, MBPZHR, Kuvendi i Kosovës	Nuk është arritur, Draft-ligji për Pyjet është në procedurë të miratimit.
6	Fuqizimi i institucioneve kompetente dhe organeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti zhvillohet në vazhdimësi dhe është realizuar pjesërisht.
7.	Ngritja e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare.	IKAP, Donatorët	Aktiviteti zhvillohet në vazhdimësi dhe është realizuar pjesërisht.
8.	Shpallja e Pashtrikut zonë e mbrojtur ndërkufitare.	Qeveria, MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht sepse me Vendim te QRKS zona është shpallur Park Natyror, kurse Republika e Shqipërisë akoma nuk e ka shpallur si ZM.
9.	Identifikimi dhe shpallja e zonave të rëndësishme të zogjve.	MMPH, Qeveria	Pjesërisht i arritur, për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale.
10.	Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët	Pjesërisht i arritur, ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi.
11.	Përditësimi i inventarizimit të zogjve në "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët, OJQ	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
12.	Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Sharri".	MMPH, Donatorët	Pjesërisht i arritur, ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi.
13.	Përditësimi i inventarizimit të zogjve në "Sharri".	MMPH, Donatorët, OJQ	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.

14.	Inventarizimi i llojeve bimore invazive dhe aliene.	MMPH, MBPZHR	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
15.	Përgatitja dhe publikimi i Librit të Kuq të Faunës.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar plotësisht, Libri për Faunën i publikuar.
16.	Sigurimi i pajisjeve për hulumtime dhe monitorimin e burimeve natyrore.	MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, janë siguruar pajisje për monitorim (trap kamera GPS, Kamera etj).
17.	Fuqizimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për bimët dhe Themelimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për kafshët.	MASHT, UP, MMPH	Aktiviteti nuk është realizuar, ka disa veprime që janë realizuar nga Fakulteti i Veterines dhe Bujqësisë i UP posaçërisht tek bimët.
18.	Përgatitja e doracakut për interpretimin e llojeve të vendbanimeve në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve.	MMPH, Donatorët, UP,	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
19.	Zhvillimi i Sistemit Qendror Informativ (SQI) për biodiversitetin.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti pjesërisht është realizuar SQI është organizuar në kuadër të Sistemit Informativ Mjedisor (SIM).
20.	Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për paraqitjen hartografike të vendbanimeve dhe inventarizimin e llojeve (trajnimet).	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht stafi është trajnuar për inventarizimin e llojeve
21.	Mbledhja e të dhënave për tipat e vendbanimeve dhe llojet (përfshirë shpërndarjen, përfaqësimin, etj.) duke përfshirë punën në terren.	MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht një hulumtim preliminar i vendbanimeve natyrore prezentë në Republikën e Kosovës është zbatuar, nevojitet të vazhdohet në të ardhmen.
22.	Prodhimi i hartave të shpërndarjes për të gjitha tipat e vendbanimeve dhe llojet, bazuar në të dhënat ekzistuese.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, disa harta preliminare janë realizuar (definimi i regjioneve biogjeografike) kurse në të ardhmen duhet vazhduar me pergatitja e hartave sipas kërkesave për Rrjetin ekologjik “Natura 2000”.
23.	Vazhdimi i zbatimit efektiv të procedurave të VSM dhe VNM.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti zbatohet në vazhdimësi në pajtim me ligjin e VNM dhe VSM.
24.	Përgatitja dhe miratimi i planeve rregulluese dhe Planit menaxhues për PK. "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët, Kuvendi i Kosovës	Me mbështetjen e Programit Mjedisor për Kosoven (SIDA) këto plane janë përgatitur por akoma nuk janë aprovuar.
25.	Përgatitja dhe miratimi i planeve të menaxhimit për zonat e tjera të mëdha të mbrojtura (mbi 500 ha).	MMPH, MBPZHR, Donatorët	Ky aktivitet nuk eshte realizuar.
26.	Përgatitja e Planeve të menaxhimit për llojet e gjitarëve të mëdhenj.	MMPH, MBPZHR, UP, OJQ, Donatorët	Nuk ka rezultate të prekshme, edhe pse janë zhvilluar konsultime me akterët përgjegjës, ky veprim pritet të bartet për realizim në dokumentet.
27.	Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Drini i Bardhë.	MMPH, Donatorët	Me mbështetjen e Programit Mjedisor për Kosovën (SIDA) Plani i Menaxhimit të Pellgut Drini i Bardhë është përgatitur por akoma nuk është aprovuar.

28.	Zhvillimi i masave nxitëse për promovimin e ruajtjes së biodiversitetit tek sektorët tjerë, të vazhdohet me zbatimin e masave në sektorin e pylltarisë - bujqësisë.	MMPH, MBPZHR	Ky aktivitet pjesërisht është realizuar me pjesëmarrjen në GP në hartimin e politikave tek sektorët tjerë me ndikim.
29.	Të vazhdohet me politikën e shqyrtimit të legjislacionit të sektorëve tjerë relevant në lidhje me objektivat, praktikat dhe rregulloret. që potencialisht kanë ndikim negativ në biodiversitet.	MMPH, MZHE, MTI, MBPZHR	Ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi me pjesëmarrjen në GP në hartimin e legjislacionit tek sektorët tjerë me ndikim në biodiversitet.
30.	Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e "Vlerësimit të Pranueshmerisë" (VP), në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti nuk është realizuar për shkak të mos mbështetjes nga donatorët, kurse MMPH nuk ka kapacitete që të ofrojë trajnime të tilla.
31.	Vazhdimi i përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës gjatë përgatitjes së legjislacionit, strategjive, programeve dhe planeve të sektorëve tjerë relevant.	MZHE, MTI, MI, MBPZHR	Aktiviteti zhvillohet në kontinuitet dhe aktualisht mundë të vlerësohet si pjesërisht i përmbushur.
32.	Zbatimin e programeve shtesë të trajnimit për mësuesit në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe zbatimin e kurrikulës në të gjitha nivelet.	MASHT, MMPH, Drejtoritë Komunale	Ky aktivitet është realizuar në vazhdimësi.
33.	Vazhdimi i Projektit Pako e Gjelbër Junior, trajnimi i mësimdhënësve të ciklit të ultë.	MASHT, MMPH, Drejtoritë Komunale	Aktiviteti është realizuar në disa prej komunave për temat e përzgjedhura.
34.	Rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve lokalë që jetojnë brenda ose në afërsi të zonave të mbrojtura.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, shembulli Projekti i Financuar nga JICA në Suharekë.
35.	Fuqizimi i bashkëpunimit në mes MMPH-së dhe OJQ-të për aktivitete të edukimit jo-formal.	MMPH, OJQ	Aktiviteti është realizuar përmes aktiviteteve me rastin e shënimit të festave mjedisore, javës së gjelbër për zhvillim të qëndrueshëm.
36.	Zhvillimi i Projektit të Eko shtegut në Parkun Regjional "Gërmia" si dhe planit të menaxhimit me fokus në edukim.	Komuna e Prishtinës, Donatorët	Aktiviteti është realizuar plotësisht, shtegu është funksional.
37.	Zhvillimi dhe Zbatimi i Projektit Kopshti Botanik.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti nuk është realizuar për mungesë të fondeve.
38.	Zhvillimi dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit në nivel kombëtar.	MMPH, MBPZHR, MZHE, MTI, MI, Mediat	Aktiviteti është realizuar pjesërisht dhe duhet të vazhdojë në të ardhmen.
39.	Shtimi i stafit universitar për taksonomi, hartografi, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit.	MAShT, UP	Aktiviteti është realizuar pjesërisht me angazhim të stafit për fushatë specifike.
40.	Mbështetja e hulumtimeve shkencore dhe projekteve në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit.	MAShT, UP, MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, aktivitet të tilla zhvillohen në kontinuitet.
	I realizuar plotësisht,	Pjesërisht i realizuar	Nuk është realizuar

Burimi: DMMU /MMPHI

Siç u cek edhe më lartë me Planin e Veprimit për Biodiversitet 2016-2020 janë planifikuar 40 (dyzetë) aktivitete me anë të të cilave do të arrihen Objektivat strategjike për ruajtjen e biodiversitetit. Prej këtyre dyzetë veprimeve janë realizuar plotësisht 6 (gjashtë) aktivitete, 22 (njëzet e dy) janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 12 (dymbëdhjetë) aktivitete mbesin të realizohen në të ardhmen.

III. KRONOLOGJIA E ZONAVE TË MBROJTURA

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës mund të veçohen katër periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999 janë shënuar rezultate të konsiderueshme në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura si dhe në zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës të të gjitha kategorive.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën fillestare të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë, e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte "Gazimestani". Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura kishte arritur në 19 (nëntëmbdhjetë). Në këtë periudhë janë venë nën mbrojtje: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj.

Periudha në mes viteve 1970-1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura. Arsyeja e këtij suksesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, janë vënë nën mbrojtje gjithsej 32 zona, prej të cilave duhet veçuar: "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr"(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha 1989-1999, sikur edhe në sferat tjera edhe në atë të mbrojtjes së natyrës kishte stagnim të plotë edhe sa i përket shpalljës së zonave të mbrojtura. Ishte periudha kur si pasoj e përjashtimit të ekspertëve shqiptar nga institucionet për mbrojtjen e natyrës por jo vetëm, nuk kemi as edhe një zonë të mbrojtur ose të propozuar për mbrojtje.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe janë marrë nën mbrojtje ligjore rreth 200 zona të ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 30 zona tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës, Ligatina e Hencit - Radevës etj. Ndërsa shumicën zonave e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik etj.

Figura. 1. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2021



Burimi: IKMN

3.1. Periudha 2018 -2021

Gjatë periudhës 2018 - 2021 numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura u janë shtuar gjithsejtë 64 zona të reja (Gjakovë 10, Mitrovicë 12, Obiliq 4, Viti 7, Gjilan 13, Deçan 17 dhe Lokaliteti i Boshtrës në zonën e Goleshit i cili shtrihet ne territorin e komunave: Drenas, Fushë Kosovë dhe Lipjan) nga të cilat: 62 monumente të natyrës (trungu i bungëbutës në Hareq, kompleksi i trungjeve në Jabllanic - Gjakovë, shpellat në Kaçandoll, Ujëvara e Trepçalive në Melenicë, kroni i akullit në Rahovë, trungjet e qarrit në Zabërgjë - Mitrovicë, trungu i manit në Mazgit - Obiliq, kompleksi i trungjeve të dushkut në Sllatinë të Poshtme, trungu i bungëbutës në Zhiti - Viti, trungu i qarrit në Llashticë, trungu i shpardhit në Llovcë - Gjilan, trungu bungëbutës në Ratish e Ulët, Burimi i ujit mineral në Deçan, gleni i Llukës në Llukë e Ulët - Deçan etj.), dhe dy (2) peizazhe të mbrojtura (ahishtat e Llomovës në Selac - Mitrovicë dhe lugina e lumit Lapushnik në fshatin Pogragjë - Gjilan).

Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e biodiversitetit, me iniciativën e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, Ministri i MMPHI, përmes vendimeve të ndara ka marrë në mbrojtje disa raca autoktone të pëllumbave të Kosovës. Me miratimin e këtyre vendimeve llojet autoktone të pëllumbave: Pëllumbi i Pejës, Kryemusmi i Gjakovës, Gjylia e Prizrenit, Piklani i Pejës, Akrobatiku-Dyneku i Kosovës, dhe Kuti i Drenicës janë marrë nën mbrojtje ligjore.
Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë identifikuar edhe disa zona të reja natyrore në komunat: Novobërdës, Pejës, Fushe Kosovë, Podujevë, Prishtinë, Ferizaj. Pas evidentimi të vlerave natyrore IKMN-ja, ka hartuar arsyeshëmerit profesionale dhe do ti procedon për mbrojtje ligjore.

IV. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2021) është 248 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126, 023.2 ha, ose 11.5 % e sipërfaqes të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: *19 Rezervate Strikte të Natyrës* ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj.), *2 Parqe Kombëtare* (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), *219 Monumente të Natyrës* ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj.), *1 Park i Natyrës* ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), 6 Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza" "Germia" dhe "Pishat e Deçanit"etj.) dhe një(1) *Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve* ("Ligatina e Hencit-Radeves").
Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia", MNRV "Ujëvarat e Mirushës" dhe MN "Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit" etj.

Tabela 2. Zonat e Mbrojtura sipas kategorive (2021)

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ ha	Pjesëmarrja në sip. e përgjithshme të	Pjesëmarrja e ZM në sip. e Kosovës
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,882.96	7.7	0.99
II	Parqet Kombëtare	2	115,957	82.1	10.6
III	Monumentet Natyrore	219	6,173.35	4.4	0.56
V	Park Natyre	1	5,934	4.2	0.5
V	Peizazh i Mbrojtur	6	2,227.35	1.6	0.2
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.08	0.01
	Totali	248	126023.2[3]	100[4]	11.55 %

Burimi: IKMN

4.1. Klasifikimi i zonave të mbrojtura

Klasifikimi i Zonave të Mbrojtura bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L233) dhe pjesërisht është në harmoni me kriteret e Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Zonat e mbrojtura të natyrës në Kosovë sipas këtij Ligji klasifikohen në shtatë (7) kategori:

[3] Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"
[4] Sqarim: perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshirë edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.

4.1.1. Rezervat Strikt i Natyrës

Rezervati strikt i natyrës është zonë e tokës dhe/ose ujit e pandryshuar ose shumë pak e ndryshuar dhe është i dedikuar ekskluzivisht për ruajtjen e natyrës së paprekur, hulumtime shkencore të larmisë biologjike dhe përcjelljen e gjendjes së natyrës. *Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave te mbrojtura, rezervatet strikte natyrore përfshijnë 10882.82 ha. Në Kosovë deri më tani janë të shpallura 19 Rezervate Strikte të mbrojtura.*

4.1.2. Park Kombëtar

Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës. Parku kombëtar ka rëndësi shkencore, kulturore, edukativo arsimore dhe rekreative.
Në Kosovë ekzistojnë dy Parqe Kombëtare të shpallura nga Kuvendi i Kosovës: PK "Sharri" me sipërfaqe 53 469 ha dhe PK. "Bjeshkët e Nemuna" me 62.488 ha. Parqet kombëtare përfshijnë sipërfaqen prej gjithsej 115.957 ha.

4.1.3. Zona e Veçantë e Mbrojtur – ZVM dhe ZVR

Zona e veçantë e mbrojtur është zonë e tokës dhe/ose ujit me rëndësi të veçantë për shkak se është unike, e rrallë - reprezentative, ose është vendbanim i llojeve të egra dhe veçanërisht është i rëndësishëm për hulumtime shkencore. *Në Kosovë ekziston një Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve - Ligatina e Hencit - Radeves me sipërfaqe 109 ha.*

4.1.4. Park Natyre

Parku i Natyrës paraqet zonë të madhe natyrore ose pjesërisht artificiale të tokës dhe/ose ujit me karakteristika ekologjik të rëndësisë kombëtare e ndërkombëtare me vlera të theksuara të larmisë peizazhore, edukative-arsimore, kulturo - historike dhe turistike - rekreative.
Në kuadër të kësaj kategorie është vënë në mbrojtje "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës" si zonë e mbrojtur ndërkufitare Kosovë - Shqipëri, më sipërfaqe prej 5934 ha.

4.1.5. Monumenti i Natyrës

Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

Në Kosovë janë të mbrojtura gjithsejt 219 Monumente të Natyrës, me sipërfaqe prej 6173.35 ha. Prej tyre 161 me karakter botanik, 29 hidrologjik, 11 gjeomorfologjik dhe 18 speleologjik.

4.1.6. Peizazhi i Mbrojtur

Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion.
Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë: Gërmia,(Prishtinë) Shkugza (Gjakovë), Kompleksi i Pishave në Strazhë, (Kaçanik), Pishat e Deçanit (Deçan), Lugina e Lumit Lapushnikë (Gjilan), Ahishtat e Llomovës (Mitrovicë). Sipërfaqja e përgjithshme e kategorisë së Peizazheve të mbrojtura është 2227 ha.

4.1.7. Monumenti i Arkitekturës së Parkut

Monumenti i arkitekturës së parkut është hapësirë e krijuar artificialisht - kopshti botanik, arboretumi, parku i qytetit, dru radhitjet, si dhe format tjera të kopshteve dhe parqeve, përkatësisht trungje individuale ose grupe trungjesh që kanë vlerë të madhe estetike, kulturo-historike, ekologjike ose shkencore. *Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes ende nuk është klasifikuar asnjë Zonë e Mbrojtur.*

V. REZERVATET STRIKTE

Në Kosovë janë të shpallura nëntëmbëdhjetë (19) Rezervate Strikte. Rezervatet strikte kryesisht gjenden ne mbrendsi të Parqeve Kombtare. Në PK. "Sharri" gjenden këto rezervate: Lëndina e Shenjtë, Shutmani, Bredhiku, Pashallar, Gryka, Lumëbardhi, Luboteni, Koritniku, Kobilica, Dupnica, Bistra, Rusenica, Oshllaku, Maja e Arnenit dhe Pisha e Madhe. Ndërsa në parkun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" janë: Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit, Malet e Prilepit dhe Gubavci, kurse në Leposaviq gjendet rezervati i Kamiljes.

5.1. Lëndina e Shenjët

Lëndina e Shenjët gjendet në malet e Mushtishtit, komuna e Suharekës, në lartësinë mbidetare 1150 -1372 m, me sipërfaqe prej 17.98 ha. Në këtë zonë përveç llojit stenoendemik bornmullera e Dieckit (*Bornmuellera dieckii*), gjenden llojet e rralla dhe endemike si: rrobulli (*Pinus heldreichii*), dredhaku (*Pinus mugo*), sarusha e sharrit (*Stachys scardica*), poligala e Doerflerit (*Polygala doerfleri*) etj. Llojet mjekësore janë: sarusha mjekësore (*Stachis officinalis*), solidagu shufërartë (*Solidago virga-aurea*), aguliqja mjekësore (*Primula officinalis*), gencianë e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), poligonati mjekësor (*Polygonatum officinale*), salepi (*Orchis morio*), gentianë pranverore (*Gentiana verna*), etj.

Në aspektin e faunës në këtë zonë veçohet prania e llojeve si: kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër *(Sus scrofa),* vjedulla *(Meles meles),* shqarthi *(Martes foina),* shqiponja minj ngrënëse *(Buteo buteo),* qyqja *(Cuculus canorus),* pikthi i gjelbër *(Picus viridis).*

5.2. Shutmani

Shutmani gjendet në shkëmbinjtë silikat dhe gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1400 deri 2658 m dhe përfshinë sipërfaqe prej 5057 ha. Në këto zonë gjenden llojet bimore si: Alkana e Sharrit *(Alkana scardica),* Qepa siberiane *(Allium sibiricum), Alyssum scardicum,* Armeria e alpeve *(Armeria alpina),* Barbarea ballkanike *(Barbarea balcana), Cardus scardicus,* Lulekambana shqiptare *(Campanula albanica),* Cicerbita e Pançiçit *(Cicerbita pancicii),* Krokusi i Sharrit *(Crocus scardicus),* Karafili i Sharrit (*Dianthus scardicus),* Karafili madhështor *(Dianthus superbus),* Groshë e egër *(Discorea balcanica),* Gencianëza bullgare *(Gentianella bulgaria var. Albanica), Draba scardica, Draba korabensis, Achillea abrotanoides, Achillea chrysocoma, Achillea atrata etj.* Llojet më të rëndësishme mjekuese janë: Sanëza *(Gentiana lutea),* Genciana pikaloshe *(Gentiana punctata),* etj. Nga llojet e zogjëve veçohet prania e shqiponjës së artë (*Aquila crysaetos*) e ndonjëherë edhe e shkabës (*Gyps fulvus).*

5.3. Bredhiku

Bredhiku gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1100 - 1450 m dhe ka sipërfaqe 123.16 ha. Në këtë zonë janë evidentuar llojet e vegjetacionit, si: bredhi maqedonas (*Abies borisi regis)* dhe bredhi i bardhë *(Abies alba).* Në kuadër të kësaj zone gjenden edhe këto llojet bimore: Arunku dioik *(Aruncus dioicus), Campanula foliosa, Chyrsanthemum leucanthemum, Melampyrum bihariense* etj. Kjo zonë është habitat i kaprollit (*Capreolus capreolus*) dhe ariut të murrmë (*Ursus arctos).*

5.4. Pashallarë

Pashallarë gjendet në shkëmbinjtë serpentin, në lartësinë mbidetare 1280 - 2092 m dhe ka sipërfaqe 400 ha. Prej llojeve drunore dhe shkurrore që gjenden në këtë zonë veçohen: Rrobulli (*Pinus heldreichii*), Arneni (*Pinus peuce*), Dredhaku (*Pinus mugho*), Tisi (*Taxus bacata*), Boronica *(Vaccinium myrtillus*), Dëllinja e siberisë (*Juniperus nana*), Trendafili malor (*Rosa pendulina*), etj. Në kuadër të këtij rezervati janë prezente llojet bimore stenoendemike, burnmullera e Dieckit (*Bornmullera dieckii*) dhe cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum*), të cilat kanë rëndësi ndërkombëtare. Prej llojeve tjera endemike veçohen: *Adenostyles glabra, Anthylis vitelina, Lazerpitium sp., Lilium albanicum, Campanula moesiaca, Campanula albanica, Campanula foliosa, Campanula glomerata, Knautia dinarica, etj.*
Fauna e kësaj zone është e pasur me lloje të shumta e më të rëndësishme janë: *Lynx lynx, Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Sus scrofa, Felis sylvestris, Martes martes, Meles meles, Apodemus silvaticus,* etj. Kohët e fundit vërehet prania e dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*) që ka migruar nga habitati i tyre në Oshlak.

Llojet më të rëndësishme të zogjëve në zonës janë: *Aquila chrysaetos, Falco biarmicus, Accepiter gentilis, Accepiter nisus, Bubo bubo, Strix aluco, Otus scops, Alectoris graeca, Tetrastes bonasia, Loxia curvirosta, Pyrrhocorax pyrrhocorax, Lullula arborea, Parus atricapillus,* etj.

5.5. Gryka

Gryka gjendet në shkëmbinjtë serpentine, në lartësinë mbidetare 1050 - 1531 m dhe ka sipërfaqe 103.98 ha. Në kuadër të vegjetacionit pyjor në këtë zonë gjendet Tisi me Ahun *(Fageto-Taxetum baccata)*. Ndërsa prej llojeve bimore mund të përmendim: lloji endemorelikt, ramonda *(Ramonda nathaliae),* si dhe llojet telekia e bukur *(Telekia speciosa),* klokëza e rëndomtë *(Silene vulgaris),* fier guri *(Asplenium trichomanes)* etj.
Zona paraqet habitat dhe zonë e migrimit për llojet e shumta të kafshëve të egra: *Ursus arctos, Capreolus capreolus, Felis sylvestris, Canis vulpes, Sus scrofa, Meles meles, Martes foina, Testudo graeca*. Zogjtë më të rëndësishëm të zonës janë: *Buteo buteo, Falco biarmicus, Accipiter gentilis, Bubo bubo, Strix aluco, Lanius collurio, Lullula arborea, Dryobates minor, Picus viridis, Alectoris graeca, Cuculus canorus, Turdus merula*, etj.

5.6. Lumëbardhi

Lumëbardhi gjendet në shkëmbinjtë silikat në lartësinë mbidetare 1570 - 2609 m dhe ka sipërfaqe 304 ha. Në kuadër të këtij rezervati përfshihen bashkësitë bimore: Pyjet e ahut (*Fagetum subalpinun*) dhe Dëllinja me Boronicën (*Vaccinio-Juniperetum nanae*). Kurse prej llojeve bimore mund të veçohen: *Dinathus scardicus, Crocus scardicus, Draba korabensis, Potentilla montonegrina, Selaginella selaginoides, Pedicularis oederi, Silene waldsteinii, Salix herbacea, Lilium albanicum, Ranunculus incomparabilis, Pinguicula balcanica, Allysum scardicum, Anemone narcissiflora, Draba doerfleri* etj. Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat te dhive të egra dhe shqiponjës së maleve (*Aquila crysaetos*), ndërsa pyjet dhe kullosat në pjesët e poshtme të zonës shfrytëzohen nga ariu i murrmë dhe kaprojtë.

5.7. Luboteni

Luboteni gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1600 - 2514 m dhe ka sipërfaqe 202.16 ha. Në këtë zonë gjendet vegjetacioni: *Carex laevis-Helianthemum.*
Në kuadër të llojeve bimore mund të veçohen: *Achillea ageratifolia var aizooni, Centaurea kosanini, Euphorbia glabriflora, Draba scardica, Genista hassertiana, Thlaspi bellidifolium, Salvia scardica, Stachys scardica, Thymus albanus, Thymus lykae, Dianthus microlepis, Dianthus scardicus, Silene roemeri, Ranunculus millefoliatus, Silene sendtneri, Asperula dorfleri, Fumana bonapartei,* etj.
Kjo zonë paraqet habitin i dhive të egra, ndërsa gjatë verës vërehen edhe shpendët grabiqar: shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), skifteri i përhimtë (*Falco peregrinus*) dhe shqiponja minjëngrënëse (*Buteo buteo*) të cilët këtë zonë e shfrytëzojnë për kërkim të ushqimit.

5.8. Bjeshka e Kozhnjerit dhe Maja e Ropsit

Bjeshka e Kozhnjerit dhe Maja e Ropsit gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror dhe serpentin, në lartësinë mbidetare 1708 - 2501 m dhe ka sipërfaqe 1,110.57 ha. Në këtë zonë gjenden bashkësitë bimore si: Bashkësia e hormoqit *(Picetum excelsae)*, Bashkësia e hormoqit dhe arnenit *(Piceo-Pinetum peucis)* dhe Bashkësia e arnenit *(Pinetum peucis).* Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Saxifraga stellaris, Valeriana tripteris, Malva moschata, Cirsium candelabrum, Tanacetum vulgare, Salix eleagnos, Lilium martagon, Centaurea ipecensis, Verbascum baldacii, etj.* Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat të dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*), dhe i rrëqebullit (*Lynx lynx*,) ndërsa pyjet paraqesin habitat të ariut të murrmë (*Ursus arctos*), kaprollit *(Capreolus capreolus)*, derrit të egër *(Sus scrofa)* etj.



Burimi ERA. Foto nr. 1. Rrëqebullit Ballkanik (*Lynx lynx Balcanicus*,)

5.9. Koritniku

Koritnik gjendet në shkëmbinjtë gëlqëror dhe ka sipërfaqe 818 ha. Në këtë zonë gjendet bashkësia bimore: Rrobulli *(Pinetum heldreichii).* Ndërsa në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Achillea chrysocoma Friv., Achillea holosericea, Alysum montanum, Armeria alpina, Anthylis vitelina, Asperula doerfleri Wettst., Bunium alpinum, Carex laevis, Campanula versicolor, Centaurea napulifera, Crocus veluchensis Herb., Euphrasia salisburgensis, Festuca panciciana, Daphne cneorum, Dianthus scardicus, Draba lasiocarpa, Draba corabensis Kumm. et. Deg., etj.* Koritniku është habitat i llojeve të shumta të faunës ku më të rëndësishmet janë: *Lynx lynx, Felis silvestris, Rupicapra rupicapra, Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Meles meles, Canis vulpes, Sus scrofa, Glis glis, Mustela nivalis, Sciurus vulgaris, Sorex alpinus,* etj.



Foto nr. 2. Bashkësia pyjore e Rrobullit *(Pinetum heldreichii)*

5.10. Kobilica

Kobilica gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1800 - 2527 m dhe ka sipërfaqe 199 ha. Në këtë pjesë është prezent lloji bimor stenoendemik, me rëndësi ndërkombëtare si: *Hieracium kobilicanum*, ndërsa nga llojet e tjera endemike veçohen: *Silene schmucheri, Rumex nivalis, Dinathus superbus, Viola grisebachiana, Erigeron uniflorus, Saussurea alpine; Lilium albanicum dhe Salix herbacea*, etj.

5.11. Dupnica

Dupnica gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1250 – 2585 m dhe ka sipërfaqe 494 ha. Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore, si në vijim: Ahu *(Fagetum subalpinum)* dhe Dëlinja siberiane *(Juniperetum nanae).* Llojet më të rëndësishme në kuadër të bimëve endemike janë: Klokëz shmukeri *(Silene schmucheri),* Shelgu barishtor *(Salix herbacea),* Karafil me balluke (*Dianthus superbus*) etj. Dupnica paraqet habitatin e dhive të egra. Kjo zonë posedon kushtet të volitshme për zhvillimin e faunës në PK "Sharri". Në pjesët e poshtme të zonës gjenden strofullat (çerdhet) e ariut të murrmë dhe ujkut. Gjatë stinës se verës kjo zonë vizitohet nga shpendët grabitqar si: shqiponja e maleve (*Aquila crysaetos*), shqiponja minjëgrenëse (*Buteo buteo*), skifteri i përhimtë (*Falco peregrinus*) etj.

5.12. Bistra

Bistra gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1350 - 2651 m dhe ka sipërfaqe 642.12 ha. Në këtë zonë janë prezente bashkësitë bimore si: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Arneni *(Ajugo-Pinetum peucis),* Bredhi, Rrobulli dhe Arneni *(Abieti-Pinetum peucis heldreichii*), Ahu dhe Pisha e bardhë *(Fago-Pinetum silvestris*), Ahu, Bredhi dhe Arneni *(Abieto-Fageto-Pinetum peucae*), Arneni, Dëllinja siberike dhe Boronica (*Vaccinio-Junipero-Pinetum peucae*) etj.

Në lartësitë mbidetare më të larta paraqitet subasociacioni (*Vaccinetum uliginosi*). Nga llojet e rrezikuara të faunës veçojmë: *Felis silvestris, Rupicapra rupicapra, Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Spermophilus citellus, Meles meles, Glis glis, Spalax monticola, Mustela erminea, Mustela nivalis, Arvicola terrestris* etj. Në zonën e Bistres gjenden habitatet e llojeve të rralla dhe të rrezikuara të zogjëve: *Tetrao urogalus, Aquila chrysaetos, Aquila heliaca, Buteo buteo, Falco peregrinus, Accipiter gentilis, Bubo bubo, Strix aluco, Loxia curvirosta, Tetrastes bonasia, Lullula arborea, Dryobates minor, Monitifringilla nivalis* etj.



Foto nr. 3. Rezervati Strikt "Bistra"

5.13. Malet e Prilepit

Malet e Prilepit gjenden në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1815 m dhe ka sipërfaqe 106.04 ha. Në këtë zonë janë prezent bashkësitë bimore si në vijim: Panja e heldrahit *(Acer heldreichii),* Arneni *(Pinus peuce),* Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer pseudoplatanus*), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiacae*), Mushtekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea)* etj. Llojet më të rëndësishme të faunës janë: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Shqarthi (*Martes foina*), Vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: Fëllëza e gureve (*Alectoris graeca*), Pëllumbi i egër (*Columba oenas*), Korbi (*Corvus corax*), Qyqja (*Cuculus canorus*), Qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), Lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj.

5.14. Gubavci

Rezervati Strikt "Gubavci" gjendet në pjesën perëndimore të Pejës rrëzë Koprivnikut. Në vitin 2016 është zgjeruar sipërfaqja e rezervatit nga 38 ha në 76.84 ha. Në këtë zonë është prezent bashkësia bimore e Boshtrës *(Forsythia europaea).*

Në kuadër të llojeve të bimëve barishtore mund të përmendim: *Centaurea kosaninii, Fumana bonapartei* etj. Sipas te dhënave (literaturës) përmendet edhe lloji stenoendemik *Rubus ipecensis*[5].

5.15. Rusenica

Rusenicë gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 780 - 1810 m dhe ka sipërfaqe 270 ha. Në këtë zonë janë prezente bashkësitë bimore si: Ahu dhe Bredhi (*Abieto-Fagetum*), Ahu *(Fagetum montanum*), Mëlleza dhe Frashri i zi *(Orno-Ostryio carpinetum*), Rrobulli dhe Bornmullera (*Bornmullero-Pinetum heldreichii*), dhe Dëllinjës së kuqe (*Daphno-Juniperetum oxicedri*), etj.
Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Bornmullera dieckii, Potentila argentea, Pilygala doerfleri, Ramonda serbica, Achillea holosericea, Hieraceum weldsteini, Galium rupestre, Scrophularia bosniaca, Minuartia verna, Achillea ageratifolia, Erysimum silvestre, Aetionema saxatile, Eryngium palmatum, Sylibum marianum, Camapnula secundiflora* etj.
Sa i përket faunës, përveç rrëqebullit, në këtë zonë gjenden edhe llojet tjera si: *Rupicapra rupicapra*, *Ursus arctos, Capreolus capreolus, Sus scrofa, Felis sylvestris*, *Meles meles*, *Lepus europeus*, *Erinaceus europaeus, Vipera amodydes*, *Lacerta viridis,* etj. Rusenica është habitat i shumë llojeve të lakuriqëve (*Chiroptera*), të cilët duhet më hollësisht të hulumtohen.
Llojet më të rëndësishme të zogjëve në zonën e Rusenicës janë: *Milvus milvus, Falco peregrinus, Accipiter gentilis, Bubo bubo, Lullula arborea, Dryobates leucotos, Cuculus canorus, Turdus merula*, *Parus atricapillus, Pyrrhocorax pyrrhocorax, Alectoris graeca*, etj.

5.16. Oshlaku

Oshlak gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1150 - 2212 m dhe ka sipërfaqe 550.47 ha. Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Achillea Alexandri regis, Gentiana lutea, Helianthemum canum, Dianthus scardicus, Dianthus integer, Dianthus superbus, Dianthus cruenthus, Gencianella bullgarica, Thymus albanicus, Lilium albanicum, Alkanas scardica, Potentilla montenegrina*, etj.
Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Dredhaku (*Pinetum mugho*), Dredhaku dhe Mushtekna (*Betulo-Pinetum mugho*), Hormoqi (*Picetum excelsae*), Shkoza orientale (*Carpinetum orientalis*), Ahu (*Fagetum montanum*).
Oshlaku është habitat i llojeve të shumta të kafshëve të egra. Lloji më i përhapur është dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*) e cila gjendet në pjesët më të larta të Oshakut ku dominojnë kullosat malore dhe shkëmbinjtë gëlqeror. Nga llojet e tjera të kafshëve të egra, veçohen: *Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Sus scrofa, Felis sylvestris*, *Martes foina, Glis glis*, *Spalax monticola*, *Talpa europea*, *Mustela nivalis*, *Sorex aranens*, *Vipera ammodydes, Lacerta viridis*, etj.

[5] Raporti – Zonimi i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Prishtinë, 2014

Në Oshlak janë vërejtur (gjurmët) e rrëqebullit (*Lynx lynx*) i cili këtë zonë e shfrytëzon për kërkim të ushqimit dhe migrim nga habitatet e tij në Rusenicë, Prevallë dhe Ujërat e Humbur, por nuk përjashtohet edhe përqendrimi i tij në këtë habitat pasi që kjo zonë (pjesa veriore e Oshlakut) mbulohet me pyje të dendura ku prania dhe ndikimi njerëzor është i kufizuar.

5.17. Maja e Arnenit

Rezervati Strikt "Maja e Arnenit" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1100 - 1946 m dhe ka sipërfaqe 145.48 ha. Në këtë zonë gjenden bashkësitë bimore, si në vijim: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), edifikator i florës barishtore është (*Sesleria autumnalis*), Rrobulli (*Luzulo-Pinetum heldreichii),* edifikator i florës barishtore është *Luzula maxima),* Ahu (*Fagetum montanum*), Rrobuli dhe Ahu (*Fago-Pinetum heldreichii*), Ahu dhe Bredhi (*Abieto-Fagetum*), Hormoqi (*Picetum excelsae*). Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Verbascum nikolai, Vrbascum scardicolum, Gentianella bulgarica var. Albanica, Dianthus cartusonarum, Dianthus integer, Lazerpitium siler subsp. garganicum, Campanula albanica, Thymus albanus, Stachys scardica, Viola grisebachii, Ephilobium anagallidifolium, Lilium albanicum, Onobrychis scardica, Scabioza dubia, Potentilla speciosa,* etj.
Në këtë pjesë gjenden këto lloje të shtazëve: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhelpra (*Canis vulpes*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Shqarthi i artë (*Martes martes*), Fishnjari (*Martes foina*), etj. Ne kuadër të shpezëve mund të përmendim këto lloje: Shqiponja e maleve (*Aquila chrusaetos*), Shqiponja minj ngrënëse (*Buteo buteo*), Skifteri malor (*Falco biarmicus*), Pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), Thëllëzës së gurit (*Alectoris graeca*), Stërqoka (*Pyrrhocorax pyrrhocorax*), *Tichodroma muraria,* etj.

5.18. Pisha e Madhe

Rezervati Strikt "Pisha e madhe" karakterizohet me pyjet të vjetra të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të Rrobullit *(Pinus heldreichii)* në Ballkan, ku një pjesë e tyre me sipërfaqe prej 35 ha, janë shpallur si rezervat strikt në vitin 1960, ndërsa me Vendimin e vitit 2016 është zgjeruar në 44 ha.
Në këtë zonë gjenden bashkësitë bimore, si në vijim: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Rrobulli dhe Hormoqi (*Piceto-Pinetum heldreichi*), Ahu, Hormoqi dhe Rrobulli (*Fageto-Piceto-Pinetum heldreichii*), Rrobulli dhe Mështekna (*Betulo-Pinetum heldreichii*), Dredahku (*Pinetum mughi*), Hormoqi (*Picetum excelsae subalpium*), Bredhi dhe Ahu (*Abieto-Fagetum*), Ahu, Bredhi dhe Hormoqi (*Abieto-Fagetum-Picetosum*), Rrobulli (*Selserio-Pinetum heldreichii*) etj. Kjo zonë është e pasur me lloje të shumta të florës kosmopolite, pra me lloje që kanë përhapje të gjerë, në kuadër të parkut.

Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen lloji stenoendemik i bimës *Sedum flexiosum*, por zona është e pasur edhe me lloje të shumta mjekësore, siç janë: badhra e bardhë (*Asphodelus albus*), ushojza pakërcell (*Carlina acaulis*), genciane e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), bari i ethes (*Centaurium erytrea*), rigoni i zakonshëm (*Origanum vulgare*), zorrëca e përhimtë (*Potentilla tormentilla*), etj.[6]
Pisha e Madhe paraqet habitat edhe për shumë lloje të kafshëve të egra, prej të cilave mund të veçohen: ariu i murrmë *(Ursus arctos),* kaprolli *(Capreolus capreolus),* macja e egër *(Felis sylvestris),* fishnjari *(Martes foina),* Skifteri malor *(Falco biarmicus),* shqiponja minjngrënëse *(Buteo buteo)* etj. Problem shumë i madh në këtë zonë është gjuetia e paligjshme.

5.19. Kamilja

Kamilja është shpallur rezervat në vitin 1988 dhe ka një sipërfaqe prej 228 ha**.** Kodra e gëlqerorëve të Kamiljes karakterizohet me vlera të veçanta natyrore të periudhës paleontologjike. Kjo zonë duhet të përfshihet në kuadër të planit për monitorim, në mënyrë që të konstatohet gjendja e vlerave natyrore dhe biodiversitetit në kuadër të saj.

5.20. Gjendja

Gjendja e përgjithshme e rezervateve nuk është në nivelin e duhur për arsye se në territorin e tyre janë duke u zhvilluar aktiviteti të ndryshme, të cilat në aspektin ligjor nuk janë të lejuara. Ndikimet negative janë si rezultat i aktiviteteve të ndryshme që po realizohen brenda dhe në afërsi të rezervateve.
Bazuar në gjendjen në terren, pjesa më e madhe e ndikimeve negative shkaktohen nga veprimet e faktorit njeri siç janë: ndërtimi i rrugëve dhe shfrytëzimi i inerteve në afërsi të rezervateve, ndërtimi i kampë-shtëpizave, (në rezervatin Bjeshka e Kozhnjerit - maja e Ropsit, Shutmani, Lendina e Shejtë, malet e Prilepit etj.), kullosat e bagëtive, (Rezervatin e Shutmani, malet e Prilepit, etj.) eksploatimi ilegal i bimëve mjekësore, (Rezervatin e Shutmani, Malet e Prilepit etj.), ndezja e zjarreve në pyje, (Rezervatin e Oshlakut, Koretnikut, Pisha e Madhe, etj.), prerja e pyjeve, (Kozhnjer, Koretnik, malet e Prilepit, Rusenica, Pashallarët, etj,) gjuetia ilegale, (Bjeshka e Kozhnjerit - maja e Ropsit, Oshlak, Bistra, Pashallarët, etj.) turizmi pa kriter, meqenëse rezervatet strike gjenden kryesisht në majat e larta malore, këto zona shfrytëzohen nga bjeshkataret për ecje ne natyrë), hedhja e mbeturinave (në të gjitha rezervatet) etj.

Ndërsa ndikimet nga faktorët natyror janë: rrëshqitja e materialit shkëmbor, tharja e trungjeve brenda rezervateve si pasoje e parazitëve (Koritnik, pyjet e rrobullit kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret dhe insektet dëmtues – nënlëvorës që janë zhvilluar në masë të madhe pas zjarreve pyjore), ndikimeve klimatike etj.
Prezenca e lumenjve në shumë rezervate strikte është shndërruar në një problem serioz, meqenëse ndërhyrjet më të shpeshta janë në shfrytëzimin e këtyre rrjedhave ujore, siç është rasti në Rezervatin Strikt (Bredhiku) etj.

[6] Zonat me vlera të veçanta natyrore në Parkun Kombëtar "SHARRI"

Në rezervate është shumë e shprehur edhe dukuria e eksploatimit ilegal të llojeve bimore mjekësore dhe aromatike që është duke ndikuar në masë të madhe në reduktimin e numrit të individëve të llojeve bimore.
Këto veprime janë duke ndikuar negativisht në vlerat natyrore dhe biodiveristetin që përmbajnë Rezervatet Strikte, në bazë të të cilave janë shpallur si zona të kategorisë së parë të mbrojtës. Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve gjendja e rezervateve, në disa pjesë ka filluar të ndryshoj, duke u shoqëruar po ashtu me pasoja negative për llojet, ekosistemet, si dhe pamjen natyrale të peizazheve të tyre.

Meqenëse 18 rezervate gjenden në kudër të parqeve Kombëtare, organet për Administrimin e Parqeve Kombëtare nuk kanë kapacitete profesionalet dhe teknike për monitorimin dhe menaxhimin e këtyre rezervateve. Po ashtu problem në menaxhimin e rezervateve mbetet mungesa e stafit, mungesa e planeve dhe programeve, mungesa e tabelave informues, shënjësimi i kufirit të jashtëm, mos vetëdisimi i komunitetit lokal për rëndisin e rezervateve etj.
Organet menaxhuese dhe Inspektorati i MMPHI duhet të ndërmarrin veprime konkrete dhe të menjëhershëm për parandalimin e këtyre aktiviteteve ilegale konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.



Foto nr. 4 dhe 5. Shfrytëzimi ilegal i kullosave në rezervatin strikt të “Shutmanit”

5.21. Rekomandimet

1. Të hartohen planet menaxhuese për rezervatet strikte;
2. Të formohen Grupet Punuese për rivlerësimin e rezervateve strikte dhe të shqyrtohet mundësia e definimit të saktë të kufijve të tyre;
3. Të ndërpriten të gjitha aktivitetet ilegale në rezervatet strikte si: kullosja e deleve, ndërtimet, turizmi, infrastruktura, shfrytëzimi i resurseve etj.;
4. Të ndërmerren masa për parandalimin e eksploatimit ilegal të llojeve bimore mejkësore në rezervatet strikte;
5. Të ndalohen ndërtimet ilegale dhe të rrënohen të gjitha ndërtimet qe gjenden në rezervatet strikte;

6. Të bëhen hulumtime shkencore për florën, faunën dhe habitatet në territorin e të gjitha rezervateve strikte ;
7. Rezervatet strikte të menaxhohen dhe të mbikqyren më mirë nga drejtoritë për administrimin e Parqve Kombtare;
8. Inspektorati i MMPHI-së, në bashkëpunim me Drejtorit e Parqeve Kombëtare të shton numrin e inspektimeve në rezervatet strikte;
9. Të behët shënizimi i kufirit të jashtëm të rezervateve strikte;
10. Të ndalohen vizitat e bjeshkatarëve dhe e turistëve në rezervatet strikte.

VI. PARKU KOMBËTAR SHARRI

6.1. Të dhënat e përgjithshme për Parkun Kombëtar "Sharri"

Malet e Sharri renditen ndër malet më atraktive dhe më të rëndësishme jo vetëm në Ballkan por dhe në Evropë. Në vitin 1986, sipërfaqja prej 39000 ha, e këtij mali është shpallur Park Kombëtar[7], ndërsa në vitin 2013 është zgjeruar sipërfaqja me 53.469 ha[8] dhe shtrihet në 5 komuna: Dragash (45.1 %), Shtërpc (23.9 %), Prizren (22.2 %), Suharekë (4.7 %) dhe Kaçanik (4.1 %). Sipas mbulesës bimore dhe përdorimit të tokave parku kombëtar "Sharri" ka këtë strukturë: vegjetacioni barishtor 30,904.85 ha (57.81 %), pyjet 18,298.82 ha (34.22 %), shkurret 1,419.15 ha (2.65 %), ujërat 1,467.64 ha (2.74 %); sipërfaqet e zhveshura 1,355.33 ha (2.54 %), sipërfaqet urbane 23.21 ha (0.04 %).[9]

Parku Kombëtar "Sharri" karakterizohet me bukuri dhe vlera të veçanta natyrore (biologjike, biogjeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, pedologjike, hidrologjike, klimatike dhe peizazhore) që kanë rëndësi të posaçme ekologjike dhe socio-ekonomike.

Karakteristik e Sharrit është biodiverziteti jashtëzakonisht i pasur i florës dhe faunës që përfshinë: rreth 1800 lloje të bimëve (350 lloje janë me karakter endemik, 21 lloje stenoendemike, 500 lloje mjekësore, 200 lloje drunore etj.), 180 bashkësi/asociacione bimore, 32 lloje të gjitarëve (pa lakuriqët), 19 lloje të zvarranikëve, 12 lloje të ujit tokësor, 6 lloje të peshqve, 147 lloje të fluturave ditore, etj.
Rëndësi të veçantë kanë llojet endemike, të rralla dhe të rrezikuara të florës dhe faunës të cilët kryesisht janë të koncentruar në 15 zonat strikte të natyrës (zona e parë e mbrojtjes) me sipërfaqe prej 9363.51 ha që paraqet 17.5 % të sipërfaqes së Parkut Kombëtar "Sharri". Kjo begati natyrore ka ndikuar që parku të radhitet ndër qendrat kryesore të biodiverzitetit në Ballkan dhe Evropë.[10]

[7] Ligji i Parkut Nacional "Mali Shar" nr. 11/86 (1986)
[8] Ligji i Parkut Kombëtar "Sharri" nr. 04/L-87 (2013)
[9] Plani i menaxhimit i Parkut Kommbëtar "Sharri" (2015)
[10] Plani i menaxhimit i Parkut Kommbëtar "Sharri" (2015)

Pozita gjeografike e Sharrit dhe atraksionet natyrore (pyjet, kullosat malore, lumenjtë, liqenet glacial, klima malore, peizazhet e bukura, terrenet për skijim dhe rekreacion) mundësojnë kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit gjatë gjithë vitit.



Foto nr. 6. Parku Kombëtar "Sharri"

6.2. Gjendja e resurseve natyrore në Parkun Kombëtar "Sharri"

Resurset natyrore të Parkut Kombëtar "Sharri" janë vazhdimisht të rrezikuara nga ndikmet negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet, sëmundjet) dhe abiotik (zjarri, fatkeqësitë natyrore: era, bora, ortiqet etj.), të cilët kanë ndikuar në gjendjen e paqëndrueshme të tyre. Dëmet më të theksuara në natyrë shkaktohen nga faktori antropogjen, ndikimi i të cilit shfaqet në mënyra të ndryshme, siç janë: prerjet ilagale të pyjeve, gjuetia ilegale, ndërtimet e paligjshme, ndezja e zjarreve, hudhja e mbeturinave, ndotja e tokës, ajrit dhe ujit etj.

6.3. Ekosistemet pyjore

Pyjet paraqesin ekosistemet më komplekse, më të rëndësishme por edhe më të rrezikuara në Parkun Kombëtar "Sharri". Pyjet më të përhapura (dominante) janë ato të ahut *(Fagetum montanum, Fagetum subalpinum)* të cilët rrezikohen nga fatkeqësitë natyrore (era, bora, etj.) dhe prerjet ilegale. Dëmet nga fatkeqësitë natyrore paraqitën në vazhdimësi, kryesisht në mënyrë sporadike dhe gjatë periudhës 2018-2021 nuk kanë qenë të shprehura në masë të madhe. Dëmet e theksuara në pyjet e ahut janë paraqitur nga prerjet ilegale, në veçanti në malin Luboten që shtrihet në komunat e Kaçanikut dhe Shtërpcës. Faktorët kryesor që kanë ndikuar në prerjet e theksuara ilegale janë:

- Gjendja e vështirë socio-ekonomike e popullatës rurale në zonën kufitare me PK "Sharri";
- Mungesa e punëtorëve (rojtarëve të natyrës dhe zyrtarëve profesional) të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" në komunat e Shtërpcës dhe Kaçanikut;
- Mungesa e investimeve për mbrojtjen e resurseve natyrore;
- Zvarritja dhe mosrealizimi i fletë padive për vjedhjen e pyjeve në gjykatat përkatëse.

Gjendja e vështirë paraqitet edhe në pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichii*) në zonat e Koritnikut dhe Pishës së Madhe, si pasojë e zjarreve (2000, 2007, 2012 dhe 2015) dhe zhvillimit të insekteve dëmtues (nënlëvorëse). Nga djegiet masive të pyjeve dhe zhvillimi intensiv i insekteve dëmtues (nënlëvorëse) pas zjarreve janë tharë mbi 1000 ha të pyjeve në malin Koritnik dhe rreth 100 ha të pyjeve të rrobullit në zonën e Pishës së Madhe. Masa e tharë drunore ka filluar të kalbet, ndërsa shumë prej drurëve të thara janë rrezuar nga erërat malore.
Pyjet e tjera të pastra dhe të përziera halore dhe gjethore në PK "Sharri" kanë stabilitet të mirë shëndetësor dhe zhvillimor. Dëmet pyjore nga fatkeqësitë natyrore dhe faktorët e tjerë (sëmundjet dhe insektet dëmtues) paraqitën në mënyrë sporadike dhe nuk kanë ndikim të veçantë ekologjik dhe ekonomik në këto pyje.
Ripërtëritja natyrore është e pamjaftueshme në pyjet e ahut dhe rrobullit, ndërsa më e theksuar paraqitet në pyjet e bredhit dhe arnenit. Kjo ka ndikuar në zgjerimin e sipërfaqeve të këtyre pyjeve, në veçanti të arnenit, në zonat e Pashallarës, Prockës së Durllës dhe Ujërave të Humbur.



Foto nr. 7. Dëmtimi pyjeve nga zjarret dhe insektet në pyjet e rrobullit në Koritnik

6.4. Ekosistemet barishtore

Gjendja e ekosistemeve barishtore, të cilët në veçanti janë të përhapura në komunën e Dragashit, është relativisht e mirë. Një pjesë e vegjetacioneve barishtore në zonat e maleve të larta mbi vegjetacionin pyjor shfrytëzohen si kullosa nga blegtorët sezonal (maj-shtator). Koncentrimi më i madh i bagëtive gjatë sezonës verore është në rajonet e Restelicës dhe Brodit

(komuna e Dragashit) për shkak së këtu gjenden sipërfaqet më të mëdha dhe më kualitative të kullosave në PK "Sharri" dhe Kosovë.
Shumica e bimëve endemike gjenden në ekosistemet barishtore të maleve të larta të PK "Sharri". Në bazë të hulumtimeve të kryera është krijuar baza e të dhënave për bimët me karakter endemik që numërojnë rreth 350 lloje dhe bimët mjekuese me rreth 500 lloje. Këto të dhëna tregojnë për biodiversitetin e jashtëzakonshëm të PK "Sharri" i cili renditet ndër 6 qendrat kryesore të biodiversitetit në Evropë.

Çdo vit është duke u rritur interesimi i popullatës lokale dhe bizneseve përkatëse për mbledhjen e bimëve mjekuese dhe frutave pyjore në gjithë territorin e PK "Sharri". Nga mbledhja nuk kursehen as bimët e rralla mjekuese në veçanti sanëza (*Gentiana lutea*) e cila është e rrezikuar për zhdukje. Një dukuri negative në rritje të vazhdueshme është mbledhja ilegale e bimëve mjekuese dhe frutave pyjore (boronicave, dëllinjës, kaçave etj.) nga banorët e Shqipërisë që kalojnë ilegalisht kufirin shtetëror në komunën e Dragashit. DAPK "Sharri", për ndalimin e këtyre veprimeve ilegale ka bashkëpunuar me policinë kufitare, por ka pasur vështirësi për shkak të mungesës së punëtorëve (rojtarëve dhe stafit profesional) në këtë komunë ku gjendet 45 % e territorit të PK "Sharri".



Foto nr. 8. Kullosat e maleve të larta në Vraca

6.5. Zonat e para të mbrojtjes

Sipas Planit Hapësinor të PK "Sharri" (2014) në këtë park gjenden 15 zona të para të mbrojtjes me sipërfaqe prej 9374.18 ha ose 17.60 % nga territori i përgjithshëm i PK "Sharri". Këto zona gjenden kryesisht në pjesët më të larta të PK ku janë të koncentruar vlerat më të rëndësishme natyrore. Qeveria e Kosovës në vitin 2016, me vendim, këto zona të para i ka shpallur rezervate strikte të natyrës. Gjendja e këtyre zonave është pjesërisht e mirë, ndërsa rrezikun më të madh paraqesin zjarret dhe veprimet e faktorit njeri. Më e vështirë paraqitet në Koritnik ku pyjet e rrobullit kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret dhe insektet dëmtues

(nënlëvorësit) që janë zhvilluar në masë të madhe pas zjarreve. Në zonat e para ku dominojnë vegjetacionet barishtore paraqitet shfrytëzimi ilegal i kullosave dhe bimëve mjekuese. Për evitimin e këtyre dukurive ilegale nevojitet shenjëzimi i zonave të para të mbrojtjes në terren me shenja të dukshme dhe organizimi e trajnimeve vetdijsuese me blegtorët dhe komunitetin lokal per ruajtjen e biodiversiteti. Shumica e rezervateve strikte shfrytëzohen nga vizitorët, në veçanti nga bjeshkatarët, për ecje në natyrë. Në të ardhmen aktivitetet e bjeshkatarisë në PK "Sharri" duhet të vihet nën mbikëqyrje të plotë.



Burimi IPH. Harta nr. 1. Rezervatet strikte në Parku Kombëtar "Sharri"

6.6. Resurset ujore

Shumë prej burimeve të ujit në të kaluarën janë marr në shfrytëzim nga fshatrat (komunitetet) lokale për t'i plotësuar nevojat me ujë të pishëm. Ndotje të ujërave nuk ka pasur, por në disa zona turistike, në veçanti në zonën e gjerë të Prevallës, përgjatë lumenjve, prrockave dhe burimeve ujore janë krijuar mbeturinat e llojeve të ndryshme. Kjo çështje mund të rregullohet me menaxhimin institucional të mbeturinave në territorin e parkut dhe ngritjes së vetëdijes qytetare për përkujdesje ndaj natyrës. Lumenjtë e PK "Sharri" paraqesin habitatin e troftës së prrockave, numri i të cilëve për çdo vit është duke u zvogëluar. Andaj në të ardhmen duhet planifikuar ripopullimin e lumenjve të parkut me këtë lloj të rëndësishëm të peshkut. Peshkimi ilegal paraqitet kohë pas kohe, në veçanti në Lumenjtë: Manastericës, Lumëbardhi i Prizrenit dhe të Brodit etj. Rrezikun më të madh për degradimin e ekosistemeve ujore në park paraqesin minihidrocentralet në komunën e Shtërpcës qe janë ndërtuar gjatë periudhës 2017-2020.

Nga këto punime janë degraduar dhe shkatërruar pesë lumenj: Lumi i Berevcit, Lumi i Kallugjerit, Murzhnica, Blateshtica dhe rrjedhja e Durlës. Degradimi i vlerave të mbrojtura të natyrës, në veçanti ato hidrologjike në PK "Sharri" është i ndaluar.
Andaj për të gjitha rastet e shkatërrimit të lumejve dhe natyrës, duhet të ndërmerren masat adekuate ligjore. Problemi është edhe më i theksuar kur merret parasysh fakti së për këto veprime shkatërruese, për vlerat burimore natyrore të parkut janë dhënë dokumentacionet mjedisore (pëlqimet) nga MMPH- ja.



Foto nr. 9. Ujëvara e Lumbardhit në Parkun Kombëtar "Sharri"

6.7. Fauna

Gjendja e faunës është relativisht e mirë, por rrezik i përhershëm për disa lloje të kafshëve (kaprojtë dhe dhitë e egra) paraqet gjuetia ilegale e cila shfaqet kohë pas kohe (posaçërisht gjatë vikendit) në disa zona të PK "Sharri", siç janë: Shutmani, Oshlaku, Bistra, Koxha Ballkani, Rusenica dhe Liqeni i Jazhincës. Destinimi i kafshëve të vrara nga gjuetia ilegale janë restorantet në zonën e Zhupës dhe më gjërë. Për ndalimin e shitjes së mishit të ndaluar duhet më seriozitet të angazhohet inspektorati përkatës komunal dhe ai qëndror.
Nga hulumtimet e kryera, posaçërisht me vendosjen e kamerave kurth në zonat malore të Oshlakut, Rusenicës, Pashallarës, Vrtopit dhe Brezovicës është konstatuar prania e shumëllojshme e faunës, në veçanti të gjitarëve (ariu i murrmë, ujku, dhelpra, kaprolli, dhija e egër, derri i egër, shqarthi i bardhë, shqarthi i artë, lepuri, ketri, vjedulla, gjeri i lajthive etj.) dhe shpendëve (shqiponja e artë, shqiponja mijëgrënëse, skifteri malor, skifteri i përhimet, huti i madh, huti pyjor, pula e pyjeve, shkurtëza, fëllënza e gurit, etj.).

Në bazë të gjurmëve të gjetura në terren është verifikuar edhe prania e rrëqebullit ballkanik *(Lynx Lynx balcanicus)* në lokalitetin e Rusenicës, Vrtopit, Oshlakut dhe Brezovicës. Këto zona edhe në të kaluarën ka qenë habitat i kësaj kafshe të rrallë dhe të rrezikuar për zhdukje. Zhvillimin më të mirë e kanë ariu i murrmë dhe ujku, në gjithë territorin e PK "Sharri", ndërsa të rrezikuar janë, në veçanti, dhitë e egra dhe kaprojtë si pasojë e gjuetisë ilegale.

6.8. Masat sanitare për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve

Me qëllim të evitimit të përhapjes së infektimeve dhe përmirësimit të gjendjes së pyjeve janë ndërmarr masat për prerjet dhe pastrimet e kufizuara sanitare të pyjeve të dëmtuara nga zjarret, fatkeqësitë natyrore (era dhe dëbora), insektet dëmtues dhe sëmundjet e ndryshme. Pastrimet sanitare aplikohen në bazë të legjislacionit (rregulloret për shërbime dhe rendin e brendshëm etj.) dhe planeve përkatëse menaxhuese.
Masa e dëmtuar dhe e infektuar drunore që përfshihet në pastrimet sanitare vjetore (rreth 6.000 m^3)[11] paraqet minimumin e sasisë që ka prioritet të pastrohet nga pyjet publike dhe private me qëllim të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së ekosistemeve pyjore. Kjo masë drunore që realizohet nga pastrimet sanitare paraqet një përqindje të vogël (9.5 %) në krahasim me masën drunore (vjetore) prej 63.000 m^3 dhe kapacitetin prodhues të pyjeve të PK "Sharri".[12]

Masa drunore nga pastrimet sanitare është dedikuar për plotësimin e nevojave për dru djegëse të komunitetit lokal. Kjo ka ndikuar në reduktimin e kërkesave për dru djegëse në zonat rurale të PK "Sharri", parandalimin e prerjeve ilegale si dhe krijimin e marrëdhënieve miqësore të DAPK "Sharri" me komunitetin lokal, që paraqesin grupin e interesit me rëndësi të veçantë për parkun. Dobitë e pastrimeve sanitare janë të gjithanshme në aspektin ekologjik, social dhe ekonomik.
Me aplikimin e masave sanitare janë arritur këto objektiva:

- Evitimi i zhvillimit të dëmtuesve entomologjik dhe fitopatologjik,
- Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të pyjeve,
- Krijimi i kushteve optimale për ripërtëritjen dhe zhvillimin e pyjeve,
- Përmirësimi i funksioneve polivalente (ekonomike, ekologjike dhe sociale) të pyjeve,
- Furnizimi i popullatës lokale me dru (zjarri) në kuadër të kapaciteteve planifikuese,
- Parandalimi i prerjeve ilegale të pyjeve,
- Sigurimi e mjeteve financiare për buxhetin e MMPHI.

6.9. Zonat turistike dhe ndërtimet në PK "Sharri"

Sipas Planit Hapësinor, në Parkun Kombëtar "Sharri" në zonën e tretë të mbrojtjes, gjenden nëntë (9) zona me sipërfaqe prej 3769.81 ha (7.1% të territorit të Parkut) të planifikuara për zhvillimin e turizmit: Guri i Dellocit (22 ha, komuna Suharekë), Gradaci (9 ha, komuna Suharekë), Prevalla (31 ha komuna Prizren), Ujërat e Gropuar (3 ha, Shtëpia e Malorëve mbi

[11] Raportet vjetore të punës të DAPK "Sharri" për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021
[1212] Plani i menaxhimit i PK "Sharri" (2015)

Skorobisht, komuna Prizren), Guri i Zi (35 ha, Zaplluxhe, komuna Prizren / Dragash), Restelica (109 ha komuna Dragash), Brodi (44 ha, komuna Dragash), Brezovica (3426 ha, komuna Shtërpcë), Nënahishte (91 ha komuna Kaçanik).[13]

Për këto zona është planifikuar hartimi i Planeve rregulluese, detaje të cilat duhet të rregullojnë ndërtimet turistike dhe zhvillimin e veprimtarive ekonomike në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK "Sharri". Zonat më të njohura turistike janë Prevalla dhe Brezovica ku turizmi është duke u zhvilluar në mënyrë të egër dhe pa menaxhim të mirëfilltë nga MMPHI. Problem në këto zona turistike paraqesin mungesa e infrastrukturës fizike (parkingjeve etj.), menaxhimi jo adekuat i mbeturinave dhe vetëdija e ulët e vizitorëve të cilit i hedhin mbeturinat pa kontroll në hapësirat parkut etj.

Ndër problemet më të mëdha në zonat turistike (zonat e treta) janë ndërtimet ilegale dhe shumë katesh që vazhdimisht janë paraqitur nga përfundimi i luftës dhe vazhdojnë edhe tani. Problemi i veçantë është mosdefinimi i kompetencave për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore që ka ndikuar që institucionet e ndryshme lokale dhe qëndrore të japin këto dokumentacione duke anashkaluar tërësisht autoritetin menaxhues të PK "Sharri". Në Prevallë dokumentacioni mjedisor dhe ndërtimor lëshohet nga Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit i MMPHI-së, ndërsa në Brezovicë lëshohet nga komuna e Shtërpcës pa kritere mjedisore dhe konsultime me DAPK "Sharri". Dhënia e lejeve ndërtimore duhet të ndërpritet deri në hartimin e Planeve rregullative për zonat e treta që janë paraparë me Planin Hapësinor dhe Planin menaxhues të PK "Sharri".

Gjatë periudhës 2018-2021 janë bërë ndërtimet ilegale edhe në zonën e dytë të mbrojtjes, në zonat malore Guri i Livadheve (komuna e Suharekës), Stanët e Brodit dhe Firajës (komuna e Shtërpcës) Stanët e Doganajve dhe Dubravës (komuna e Kaçanikut) dhe Sherupa (Komuna e Dragashit). Për këto raste janë paraqitur paditë në gjykatat përkatëse nga DAPK "Sharri" dhe Inspektorati i MMPH-së. Zvarritja dhe mosrealizimi i padive në organet e drejtësisë ka vështirësuar ndalimin e këtyre veprimeve ilegale në territorin e PK "Sharri".



Foto nr. 10. Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica

[13] Plani Hapësinor i PK "Sharri" (Vendimi i Kuvendit të Kosovës nr. Nr. 04-V-772, shkurt 2014.)




Foto nr. 11 dhe 12. Ndërtimet ilegale në zonën e Gradac (komuna e Suharekës)




Foto nr. 13 dhe 14. Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica




Foto nr. 15 dhe 16. Ndërtimet ilegale në vikend zonën Brezovica



Foto nr. 17. Ndërtimet ilegale në Restelicë



Foto nr. 18. Ndërtimet ilegale në Prevallë

6.10. Sfidat dhe problemet në PK "Sharri"

Nga sfidat dhe problemet e shumta më të cilët ballafaqohet Parku Kombëtar "Sharri", veçohen:

1. Struktura organizative e pa kompletuar (mungojnë rojat e pyllit në komunat: Dragash, Shtërpcë dhe Kaçanik, sektorët përkatës profesional, zyret lokale në komuna) etj.,
2. Mungesa e buxhetit dhe investimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Sharri",
3. Mungesa e shenjëzimit të kufirit të jashtëm dhe të brendshëm (zonave të parë, të dytë dhe të tretë të mbrojtjes) të PK. "Sharri",
4. Ndërtimet e shumta ilegale dhe tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore te Parkut,
5. Ndërtimi i hidrocentraleve në lumejtë e PK "Sharri" dhe shkatërrimi i vlerave burimore natyrore të cilët kanë ndikuar që ky territor të shpallet Park Kombëtar,
6. Prerjet ilegale të pyjeve në malin Luboten (komunat e Kaçanikut dhe Shtërpcës),
7. Mos definimi i pronësisë së shumicës së ngastrave të cilët janë në pronësi shoqërore të ish kooperativave bujqësore dhe ekonomive pyjore (nevojitet që këto prona shoqërore të transferohen në pronë publike të MMPHI),
8. Zvarritja dhe mosrealizimi i fletëpadive për vepra ilegale në gjykatat përkatëse,
9. Pasiguria e objekteve të DAPK "Sharri" në Prizren dhe Brezovicë në mungesë të rojtarëve,
10. Rreziku permanent për resurset natyrore nga fatkeqësitë natyrore (era dhe bora), sëmundjet bimore dhe insektet dëmtues.
11. Etj.

6.11. Rekomandimet

Për të siguruar mbrojtjen e mirëfilltë të resurseve natyrore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Parkun Kombëtar "Sharri" nevojitet ndërmarrja e masave të ndryshme, ndër të cilat veçohen:

1. Rritja e stafit profesional dhe rojtarëve të natyrës në PK "Sharri";
2. Sigurimi i buxhetit dhe investimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Sharri";
3. Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale;
4. Mbrojtja e pyjeve nga zjarret, insektet dëmtues dhe sëmundjet bimore;
5. Monitorimi dhe mbrojtja e florës dhe faunës (bimëve endemike dhe mjekuese) dhe ekosistemeve;
6. Monitorimi i gjendjes se rezervateve strikte në park;
7. Monitorimi i vendeve turistike në park;
8. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore të parkut;
9. Informimi i publikut dhe promovimi i vlerave natyrore në PK "Sharri";
10. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në projektet të ndryshme;
11. Pjesëmarrje në projektet për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar "Sharri";

12. Ngritja e aftësive profesionale të stafit të PK. “Sharri”;
13. Ndalimi të gjitha veprimtarive që kanë ndikim degradues dhe shkatërrues për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e PK “Sharri”;
14. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të PK “Sharri” të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjin për PK “Sharri”, Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare, Planin Hapësinorë dhe Planin menaxhues të PK “Sharri”;
15. Të ndalohen ndërtimet ilegale në gjithë territorin e parkut kombëtar “Sharr” ;
16. Të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në PK “Sharri” dhe të bëhet rehabilitimi i zonave të dëmtuara;
17. Të gjitha veprimtaritë dhe punimet të cilat realizohen brenda territorit të PK “Sharri” të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga Inspektorati i MMPHI-së dhe DPK “Sharri”;
18. Të ndërtohet qendra e informimit në PK “Sharri”;
19. Dhënia e lejeve ndërtimore duhet të ndërpritet deri në hartimin e planeve rregullative për zonat e treta që janë paraparë me Planin Hapësinor dhe Menaxhues të PK “Sharri”;
20. Funksionalizimi i pikave hyrëse në zonat turistike Brezovicë dhe Prevallë;
21. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat, procedurat, kompetencat dhe kushtet e ndërtimeve në parqet kombëtare;
22. Pronat e ndërmarrjeve shoqërore të barten në pronësi të MMPHI;
23. Rrënimi i të gjitha objekteve ilegale në park (jashtë zonave të treta);
24. Hartimi i Planeve rregulluese, detaje për zonat e treta në territorin e PK “Sharri” të cilët duhet të rregullojnë ndërtimet në zonat turistike dhe zhvillimin e veprimtarive ekonomike në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK “Sharri” sipas ligjeve në fuqi;
25. Definimi i kompetencave për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore në park;

VII. PARKU KOMBËTAR "BJESHKËT E NEMUNA"

7.1. Vështrimi i përgjithshëm i PK "Bjeshkët e Nemuna"

Bjeshkët e Nemuna paraqesin një zonë malore në pjesën veri-perëndimore të Kosovës që kanë vazhdimësi në pjesën veriore të Shqipërisë dhe jug-lindje të Malit të Zi.
Për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristike dhe faunistike, paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe më interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe të Gadishullit Ballkanik. Ky masiv përbën pjesën perëndimore të Kosovës, i cili zbret vertikalisht dhe përfundojnë në lindje dhe verilindje në fund të Rrafshit të Dukagjinit dhe në luginën e Ibrit. Kurse në perëndim e mbyllin malet (kufiri) me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Kanë shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësi afro 50 km, ndërsa gjerësia e tyre nuk e kalon 26 km. Bjeshkët e Nemuna prehen nga luginat e thella e të tërthort, shpesh në formë kanioni siç janë ato të Lumëbardhit të Pejës, Deçanit dhe Erenikut etj.

PK. "Bjeshkët e Nemuna" dallohen me një numër të madh të majave të larta mbi 2000 m, duke filluar me majën më të lartë në Kosovë, Gjeravica (2.656 m), Koprivniku (2377 m), Negjinati (2341 m), Malet e Lumbardhit (2335 m), Zhlebi (2352 m) dhe Rusolija (2381 m) etj. Lartësia mesatare mbidetare në Bjeshkët e Nemuna kalon mbi 1.600 m. Morfologjia e Bjeshkëve të Nemuna cilësohet me shpate të thepisura, me lugina të thella, me gryka të ngushta dhe me pragje të shumta, që paraqesin bukuri të rralla natyrore jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Kuvendi i Kosovës, në dhjetor të 2012-ës e miratoi Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me sipërfaqe të përgjithshme prej 62.488 ha, me shtrirje në territorin e 5 komunave: Pejës 52.1 %, Deçanit 26.6 %, Junikut 8.4 %, Istogut 8.1% dhe Gjakovës 4.8 %.



Harta nr: 2. Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"



Foto nr.19. Parku Kombëtar "Bjeshket e Nemuna"

7.2. Flora

Bjeshkët e Nemuna janë ndër masivet malore më karakteristike të Ballkanit për sa i përket llojllojshmërisë së florës dhe vegjetacionit. Në kuadër të llojeve endemike në Bjeshkët e Nemuna vetëm në zonën alpike dhe subalpike janë prezentë 128 lloje endemike të Ballkanit. Ndër llojet endemike të Kosovës në Bjeshkët e Nemuna janë edhe *Sempervivum kosaninii* (burgulli i Koshaninit), *Cephalaria pastricensis* (Cefalaria e Pashtrikut), *Astragalus fialae* (Arrithja e Fialit), *Aconitum pentheri* (Akoniti i Rusolisë), *Rubus ipecensis* (Manaferra e Pejës), *Saxifraga scardica* (Iriqëza e Sharrit), *Wulfenia blecicii* (Vulfenia e Bleçiqit); *Centaurea nervosa* (Kokoçeli), *Thlaspi cuneifolium* (Tlaspi), *Thymus rohlenae* (Listra e Rohleries) etj.
Nga llojet relikte të përhapura në Bjeshkët e Nemuna karakteristike janë: *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë) e përhapur në kuadër të pyjeve të dushkut dhe ahut. Në Grykën e Rugovës gjenden në ekspozicionin verior, ndërsa në Malin e Thatë, Bjeshkët e Sinajit dhe Lebeniq në ekspozicionin jugor. Në afërsi të Bistricës së Lloçanit së bashku me të paraqitet edhe *Carpinus betulus* (shkoza e bardhë) i cila po ashtu është relikt i tercierit. Pos llojeve endemike autoktone në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme edhe shumë lloje endemike të Ballkanit ndër të cilat edhe *Crepis albanica* (Shmanga shqiptare), *Draba korabensis* (Draba e Korabit), *Cerastium dinaricum* (Cerasti dinarik), *Sempervivum macedonicum* (Burgulli maqedonas), *Euphorbia montenegrina* (Qumështorja malazeze) etj.



Foto nr. 20. Karafili i Sharrit (*Dianthus scardica*)



Foto nr. 21. Sanëza (*Gerntina lutea*)

7.3. Fauna

Masivi i Bjeshkëve të Nemuna karakterizohet me një faunë mjaftë të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës fauna e Bjeshkëve të Nemuna, përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 178 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në territorin e Bjeshkëve të Nemuna janë: Rrëqebulli ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus)*, Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Shqiponja perandorake (*Aquilla heliaca*), Shqiponja e maleve (*Aquilla chrysaetos*), Faikoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), Pulë egra (*Tetrao urogallus*) etj, të cilat kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka përcjellë në vazhdimësi gjendjen e faunës në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna ", ndërsa rezultate me gjithëpërfshirëse në lidhje me faunën e Kosovës, e në këtë kuadër edhe të masivit Bjeshkët e Nemuna, janë publikuar në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës i cili është publikuar gjatë periudhës për të cilën përgatitet raporti (2019).



Foto nr. 22. Rrëqebulli Ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), foto ERA



Foto nr. 23. Kaprolli (*Capreolus capereolus*)



Foto nr. 24. Ariu i murrëm (*Ursus arctos*)

7.4. Resurset Ujore

Territori i parkut kombëtar "Bjeshket e Nemuna" ka rrjet hidrografi mjaft të dendur. Në park rrjedhin lumenjët si: Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi Deçanit, Ereniku, Lumbardhi i Lloqanit, etj. Të gjitha rrjedhat ujore të parkut kanë drejtimin e rrjedhjës perëndim - lindje dhe jug-lindje,të cilët shkarkohen në lumin Drini i Bardhë, i cili paraqet ujëmbledhësin kryesor të Basenit të Dukagjinit. Të gjitha burimet e lumenjve ndodhen në lartësi mbidetare mbi 1000 m, duke rrjedhur nëpër lugina të thella dhe të ngushta të komplekseve malore të parkut. Uji i këtyre lumenjve nga burimi e deri në rrjedhën e mesme, vlerësohet të ketë cilësi të mirë. Lumenjve nga të dy anët i bashkohen numër i madh i ujërrjedhave (lumenj të vegjël dhe përrocka).
Bazuar në të dhënat ekzistuese brenda kufirit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ekzistojnë rreth 730 burime uji. Prurjet e ujit (kapaciteti ujëdhënës) luhaten nga 0,03 deri në 3000 l/s. Vlera e pH luhatet nga 5 deri në 7. Uji nga këto burime ka cilësi të lartë.

7.5. Gjendja e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Ndër problemet më të mëdha të evidentuara gjatë periudhës 2018 – 2021, në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" janë ndërtimet ilegale, prerja e pyjeve, hapja dhe zgjerimi i rrugëve të reja, gurthyesit në park dhe në afërsi të tij, hidrocentralet (në gryken e Deçanit), zjarret, gjuetia ilegale, turizmi i pa kontrolluar, elektrifikimi dhe mbeturinat, etj.

Ndërtimet ilegale – kanë marrë hov në gjithë territorin e parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", por më të atakuarat mbeten zonat potenciale turistike, si: Gryka e Rugovës, Bogë, Leqinat, Gropa e Erenikut, Lugu i Butë, Bjeshkën e Belegut, Bjeshkën e Strellcit, Gryka e Deçanit, Bjeshkën e Lumëbardhit, Qërshiz, Stankaj, Shkrel, Kushutan, Dugajevë, Burimi i Drinit të Bardhë etj.
Deri sa në vitin 2014, në park janë identifikuar rreth 3000 ndërtime, ndërsa në vitin 2019, numri i ndërtimeve arrin rreth 5397[14], çka tregon për përmasat shqetësuese të ndërtimeve ilegale në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", duke ndikuar kështu në degradimin e vlerave natyrore, shqetësimin e florës dhe faunës dhe kanë ndryshuar imazhin e parkut.

Numri më i madh i ndërtimeve në park është regjistruar në komunën e Pejës 3085 (pasi që në territorin e kësaj komune që shtrihet brenda parkut ekzistojnë 13 vendbanime), Deçanit 1490, Istogut 442, Junikut 257 dhe Gjakovës 123 objekte. Gjatë periudhën 2019 - 2021, drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ka proceduar në gjykatë rreth 400 procesverbale për ndërtime pa leje në kuadër të parkut. Në kudër të ndërtime ilegale në PK. "Bjeshkët e Nemuna" janë edhe ndërtimi i disa Via Ferrata të ndërtuar nga shoqata e ndryshme pa leje dhe pëlqime përkatëse.

Figura nr. 2 Numri i ndërtimeve në PKBN sipas veprimtarive[15]



[14]Raporti i grupit punues për evidentimin e ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të tjera në Parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", AMMK, 24.06.2020. (nr.proto. 2916/20).
[15] Po aty.



Foto nr. 25. Ndërtimi i objekteve në Koshutan



Foto nr. 26. Ndërtimi i objekteve në Shkrel





Foto nr. 27 dhe 28. Ndërtimi i objekteve në Shtupeq dhe Stankaj



Foto nr. 29. Ndërtimet në Bogë



Foto nr. 30. Ndërtimet ilegale në Bjeshkën e Lumbardhit



Foto nr. 31. Ndërtimet ilegale në Qërshiz



Foto nr. 32. Ndërtimet ilegale në Bjeshkën e Strellcit

Prerjet ilegale - janë duke u bërë pothuajse në të gjitha komunat ku shtrihet territori i PK "Bjeshkët e Nemuna", me theks të veçantë në komunën e Deçanit, Pejës dhe Istog. Prerjet e pakontrolluara të pyjeve kanë pasoja të pariparueshme që përveç humbjes së masës drunore, reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemeve dhe degradimin e biodiversitetit, si dhe shqetësimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit, etj.

Tabela nr. 3. Prerja e pyjeve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"2018-2021 (në bazë të fletëparaqitjeve të drejtorisë)[16].

Viti	Sasia m^3
2018	1023.75
2019	1048.35
2020	299.98
2021	237.33
Gjithsejtë	2609.41

Burmi: Drejtoria e PKBN.

[16] Të dhënat e ofruara nga Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", shkurt 2022.

Infrastruktura - ndërtimi, zgjerimi dhe hapja e rrugëve të reja është një problem shqetësues në parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Fragmentimi i habitateve nga infrastruktura rrugore janë dukuri të shpeshta edhe gjatë kësaj periudhe. Akset me ndikim më të madh në biodiversitetin dhe peizazhin janë rrugët: Maja e Zezë - Peklenë - Shtupeq i Vogël - Varri i Sykyt, Junik - Livadh i gjatë - Gropat e Erenikut, Lugu i Butë - Stanet e Mehajve dhe Haxhiajve, rruga në Grykën e Lloqanit, rruga Grykë e Rugovës - Milishevc, Deçan - Plavë, etj. Një numër i madh i rrugëve të hapura kanë filluar vetëm me paramasë dhe parallogari, pa plane dhe projekte të detajuar, pa pëlqime mjedisore dhe pa studime të mirëfillta të ndikimit në mjedis.
Kjo infrastrukturë , e cila ka ndikim negativ për parkun, financohet nga komuna dhe Ministria e Infrastrukturës, pa i respektuar procedurat ligjore (pa Vlerësim të Ndikimit në Mjedis, etj.).


Foto nr. 33. Hapja e rrugëve të reja në Kushutan


Foto nr. 34. Ndërtimi i rrugës Junik - Lugu i Gjatë

Në periudhën 2018-2021, përveç vazhdimit të rrugëve të lartpërmendura ka pasur investime edhe në hapjen, zgjerimin dhe asfaltimin edhe të këtyre rrugëve:

- Pejë:- rruga Koshutan - Hajl (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Koshutan - kodra e Lekajve (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Shtupeq i Madhë - Podi i Jakupit (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Shtupeq i Madhë - Brezë Kofile (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Peklen (Maja e Zezë) pjesa e dytë (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Pejë - Bjeshkë e Lumbardhit (zgjerim), Bogë - Stankaj (pjesërisht ekzistuese dhe asfaltuar), Drelaj - Leqinat (ekzistuese - zgjerim), Kuqisht - Leqinat (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Drelaj - Rekë e Allages (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Koshutan - Pepiq (ekzistuese e zgjeruar dhe asfaltuar), Stankaj - Bogë (rruge e re e hapur), Bogë - Shkrrel pjesa nga Gropa e Madhe (ekzistuese e zgjeruar dhe e përgatitur për asfaltim)[17].
- Deçan: - rruga për Plavë (ekzistuese e zgjeruar), rruga ne bjeshkën e Strellcit (zgjerim dhe asfaltim).
- Junik: - Batushë-Stanet e Babajve, ujësjellsi[18.]

[17] Të dhënat e ofruara nga Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshket e Nemuna", shkurt 2022.
[18]Të dhënat e ofruara nga Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshket e Nemuna", shkurt 2022.

Hapja dhe zgjerimi i akseve rrugore është përcjell edhe me fenomene tjera negative siç është paraqitja e erozionit (rrëshqitjeve). Si pasoje e kësaj ka ardhur deri të procesi i rrëshqitjeve të masave shkëmbore që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në biodiversitet dhe në peisazhin e parkut.




Foto nr. 35 dhe 36. Rrëshqitjet masive e dheut në rrugët Deçan-Plavë dhe Lumbardh - Milishevc

Gjuetia - në park nuk ka hulumtim të detajuara sa i përket numrit të saktë të faunës, kështu që nuk dihet qartë se sa është popullata e një lloji në një lokacion të caktuar, ose informacione kualitative rreth faunës në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Gjuetia ilegale në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është prezentë dhe nëse vazhdon mund të çoj deri tek ulja e popullatës të një lloji në një habitat, ku vihet në rrezik direkt zhdukja e tij.
Fauna e parkut është shumë e larmishme, me lloje të ndryshme të specieve dhe disa prej tyre janë të rrezikuara në nivel kombëtar dhe europian. Në këtë grup përfshihen gjitarët e mëdhenj, si rrëqebulli ballkanik, ariu i murrmë, ujku, macja e egër, çakalli i artë etj.
Gjendja e faunës është relativisht e mirë, por me rrezik të përhershëm për disa lloje të kafshëve (kaprojtë dhe dhitë e egra) nga gjuetia ilegale e cila shfaqet kohë pas kohe (posaçërisht vikendit) në disa zona të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", siç janë: Gryka e Rugovës, Gropa e Erenikut, Gryka e Lumbardhit të Deçanit etj.
Me këtë rast duhet të theksohet se është e nevojshme një fushat vetedijsimit për banorët e zonës dhe shoqatat e gjahtarëve, meqenëse shumë gjahtarë i shfrytëzojnë lejet për gjueti të cilën e marrin nëse anëtarësohen në ndonjë shoqatë për gjueti.

Gurthyesit - në kuadër të parkut, aktivitetin e kanë zhvilluar dy gurthyes të cilët kanë ndikuar në degradim të vlerave të natyrës. Ndërsa në zonën buferike prej 100 m afër kufirit të parkut, aktivitetin e zhvillojnë edhe disa gurthyes të tjerë dhe ky aktiviteti është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233), Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Nr. 04/ L-086), Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare 21/2013. Prezenca e gurthyesve ka ndikuar në dëmtimin dhe shqetësimin e florës dhe faunës. Pas skadimit të licencave të punës, vend guroret i kanë lënë të pa rehabilituar duke krijuar kështu një imazh të keq për parkun.



Foto nr. 37. Eksploatimit i shkëmbinjve gëlqerorë (afër KFOR-it, italian në Pejë)

7.6. Zjarret

Shqetësim i madh për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është dukuria e zjarreve të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në pjesë të ndryshme të tij. Sipërfaqja e pyjeve të djegura nga zjarret në periudhën 2018 - 2021 në park, ishte rreth 218 ha.
Siç shihet nga tabela nr. 4 në vitin 2021, Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është përfshirë nga dy zjarre me rrezikshmëri të lartë që kanë shkaktuar dëmtime të konsiderueshme në pyjet halore dhe gjethore (pishë, bredh, hormoq dhe ahu, etj.) duke dëmtuar lloje të ndryshime të pyjeve të cilat paraqesin habitat për shumë lloje të botës shtazore dhe bimore .

Tabela nr. 4. Zjarret në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 2018 - 2021[19]

Nr:	Njësia ekonomike	Sip./ha	Lloji i drurit	Data e paraqitjes së zjarrit	Data e shuarjes së zjarrit	Pjesëmarrësit në shuarjen e zjarrit	Dëmet nga zjarri
1	Kozhnjer - Roshkodol - Zllonopoj	10	Halor-barishta	20.10.20219	30.11.2019	DAPK, Zjarrfikësit	70%
2	Kozhnjer - Roshkodol	15	Halor - barishta	22.10.20219	30.11.2019	DAPK, Zjarrfikësit	40%
3	Hajla - Stankaj	12	Halor - gjethor	25.10.2019	29.10.2019	DAPK, Zjarrfikësit	30%
4	Rusolia - Zhleb	10	Halor - gjethor	21.03.2020	25.10.2020	DAPK, Zjarrfikësit	40%
5	Rusolia - Zhleb	7	Halor - barishta	18.04.2020	21.04.2020	DAPK, Zjarrfikësit	40%
6	Kopranik	2	Halor - gjethor	12.04.2020	13.04.2020	DAPK.	10%

[19] Të dhënat e ofruara nga Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

7	Lloqani - 1	6	halor - gjethor	16.10.2020	19.10.2020	DAPK, Zjarrfikësit	15%
8	Hajla - Shtupeq i Madh	150	Halor - gjethor	23.07.2021	12.08.2021	FSK, KFORI, Zjarrfikësit DAPK	70%
9	Hajla - Shtupeq i Madh	6	Halor - gjethor	10.05.2021	13.05.2021	DAPK, Zjarrfikësit	20%
	Gjithsejtë	218					

Burimi: DPKBN



Foto nr. 38. Zjarri në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", njësia ekonomike Hajla-Shtupeq i Madh





Foto nr. 39 dhe 40. Dëmtimi i pyjeve nga zjarret në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna",

7.7. Sfidat dhe problemet në PK. "Bjeshkët e Nemuna"

Nder sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna janë:

1. Mungesa e Planit Hapësinor;
2. Mungesa e Planit Menaxhues;
3. Mungesa e stafit profesional dhe e rojeve në drejtorin e PK. Bjeshkët e Nemuna",
4. Mungesa e buxhetit dhe investimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Bjeshkët e Nemuna";
5. Ndërtime ilegale dhe pa kriter në PK "Bjeshkët e Nemuna",
6. Ndërtimi i hidrocentralit në gryken e Deçanit dhe shkatërrimin masiv i vlerave burimore natyrore;
7. Zvarritja dhe mosrealizimi i fletëpadive për vepra ilegale në gjykatat përkatëse;
8. Rreziku i perhershëm për resurset natyrore nga ndikimet negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet dëmtues dhe fitopatogjenet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora, etj.);
9. Mungesa e shenjëzimit të kufirit të jashtëm dhe të brendshëm (zonës së parë, të dytë dhe të tretë) të parkut,
10. Transformimi i pronave shoqërore të ish ndërmarrjeve shoqërore bujqësore (kooperativave) dhe pyjore (ekonomive pyjore) në pronësi të PK "Bjeshkët e Nemuna", (MMPHI),
11. Tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore;
12. Mos bashkëpunimi i komunitetit lokal për shuarjen e zjarreve me drejtorin e parkut dhe institucionet tjera;
13. Mungesa e pajisjeve për shuarjen e zjarreve dhe veturave të terrenit;
14. Ndërtimet infrastrukturore pa leje (pa pëlqime mjedisire) dhe pa projektet konkrete,
15. Mungesa e fondeve për inventarizimin e florës dhe faunës në PK. "Bjeshket e Nemuna",
16. Mos koordinimi i aktiviteteve në mes Drejtorisë për Administrimin e PK. "Bjeshkët e Nemuna" dhe nivelit lokal.

7.8. Rekomandime

Për të siguruar mbrojtjen e mirëfilltë të resurseve natyrore dhe menaxhimin e qëndrueshëm në PK "Bjeshkët e Nemuna" nevojitet ndërmarrja e menjëhershme e këtyre masave.

1. Të miratohet Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
2. Të hartohet Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
3. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të PK Bjeshkët e Nemuna", të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjin për PK "Bjeshkët e Nemuna", dhe Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare;
4. MMPHI-ja, të nxjerr vendim për ndalimin e të gjitha aktiviteteve ilegale (ndërtimet, hapjen dhe zgjerimin e rrugëve etj.) në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" deri sa të miratohet Planin Hapësinor dhe Plani menaxhues i parkut;

5. Hartimi i Planeve rregulluese detaje për zonat e treta në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna", të cilët duhet të përcaktojnë kahjet e zhvillimeve në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK "Bjeshkët e Nemuna";
6. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat, procedurat, kompetencat dhe kushtet e ndërtimeve në zonat e treta të PK "Bjeshkët e Nemuna";
7. Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim negativ për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna";
8. Bartja e pronave të ish ndërmarrjeve shoqërore bujqësore (kooperativave) dhe pyjore (ekonomive pyjore) në pronësi të MMPHI;
9. Të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në PK "Bjeshkët e Nemuna" dhe zonat e degraduara të rehabilitohen;
10. Të definohen kompentancat për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore në park;
11. Të ndalohen operimet i gurthyeseve dhe të bëhet rehabilitimi i zonave të degraduar në park dhe në afërsi të ti;
12. Të ndalohen operimet i sharrave në Pakun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
13. Të ndalohen të gjitha ndërtimet ilegale në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" deri në aprovimin e planit Hapësinor dhe Menaxhusë për parkun;
14. Të gjitha veprimtaritë dhe punimet të cilat realizohen brenda territorit të PK "Bjeshkët e Nemuna", të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga Inspektorati i MMPH-së dhe DPK "Bjeshkët e Nemuna";
15. Të ndërmerren masa nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, zjarret, insekte dëmtues dhe sëmundjet;
16. Të behet monitorimi i vazhdueshem i gjendjes së florës dhe faunës dhe ekosistemeve në territorin e parkut dhe në rezervatet strikte;
17. Të organizohen sa më shumë aktivitete dhe veprimet që ndërlidhen me informimin dhe vetëdijesimi e publikut për mbrojtjen e parkut dhe promovimin e vlerave natyrore të PK "Bjeshkët e Nemuna", si dhe të ndërtohen qendrat informative në PK Bjeshkët e Nemuna";
18. Të rritet bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe të koordinohen aktivitetet e përbashkëta;
19. Të vazhdohet pjesëmarrje në projekte nacionale, ndërkufitare dhe regjionale për menaxhimin e qëndrueshëm të vlerave të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
20. Të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të PK "Bjeshkët e Nemuna" dhe të rritet numri i stafit profesional në park
21. Instalimi i sistemit vëzhgues për monitorimin dhe lajmërimin e hershëm të zjarreve;
22. Pajisje adekuate, në veçanti të aparateve të shpinës kundër zjarreve (V-25 litra) të drejtorisë së parqeve, krijimi i grupeve vullnetare në vendbanimet brenda parkut për reagim të shpejt në rast të paraqitjes së zjarreve.

VIII. ZONAT E VEÇANTA - ZVM dhe ZVR

8.1. Ligatina e Hencit - Radevës - Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve

Ligatina e Hencit - Radeves shtrihet në pjesën qendrore të fushës se Kosovës, në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtare "Adem Jashari" në mes të fshatrave, Henc - komuna e Fushë Kosovës, Vrellë – komuna e Lipjanit dhe Radevë - Komuna e Graçanicës në lartësi mbidetare rreth 545m dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 109 ha 52 ari 35 m^2 .

Kjo zonë është krijuar nga bashkimi i rrjedhave ujore të Magurës dhe Vrellës, të cilat janë degë e majtë e lumit Sitnica. Ligatina është krijuar në vitet e `60-ta, më qëllim të kultivimit të llojit të peshkut Krap (*Cyprinus carpio*). Ligatina e Hencit - Radevës duke pas parasysh se është i vetmi ekosistem i llojit të tillë në Kosovë edhe pse i formuar në mënyrë artificiale, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogjeologjike, botanike, peizazhore etj. Në vitin 2013 është përgatitur arsyeshmërinë profesionale për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radevës zone e mbrojtur. Ndersa Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka nxjerr Vendim (Nr. 08/178, datë 18.03.2014) për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radeves Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.



Harta nr. 3. Ligatina e Hancit - Radevës

Sipas konstatimeve në terren, në këtë zonë janë të pranishme mbi 50 lloje të bimëve vaskulare. Këtu jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër e prej tyre numrin më të madh e përfaqësojnë shpendët e egra për çka edhe shquhet kjo zonë. Numri i llojeve të shpendëve të konstatuara deri tani është rreth 78, por mendohet se ky numër duhet të jetë shumë më i madh, duke pasur parasysh se asnjëherë deri tani nuk është bërë ndonjë hulumtim sistematik dhe profesional në nivel të dëshiruar. Habitatet natyrore të Ligatinës se Hencit - Radevës me rrethinë ofrojnë vendstrehim për shume lloje të shpendëve, shumë prej tyre lloje të rralla dhe me status të pafavorshëm të ruajtjes tek në dhe Europë.

Zona karakterizohet me veprimtaritë ekonomike si: peshkataria, bujqësia, blegtoria, gjuetia, etj. Basenet kryesisht përdoren për rritjen e peshkut ndërsa në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre zhvillohen aktivitete të prodhimtarisë bujqësore, kurse është i zhvilluar edhe turizmi rural dhe rekreacioni. E gjithë zona e Ligatinës së Hencit- Radeves është pronë publike dhe menaxhohet nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP).



Foto nr. 41. Peizazh nga Ligatina e Hencit - Radevës



Foto nr. 42. Rosa sqeplugë -*Anas clypeata* (A. Mavriqi)



Foto nr. 43. *Anax imperator*

8.2. Gjendja

Meqenëse zona është nën autoritetit e AKP-së, dhe nuk menaxhohet nga institucionet qendrore degradimi i zonës vërehen çdo ditë e më tepër. Problem më i theksuar mbetet mungesa e ujit në basene dhe zona tjera përreth për shkak të ndaljes së rrjedhjes së ujit në të, e cila shprehet me mungesë të peshqve që janë ushqim kryesor për llojet e zogjve të pranishëm në këtë zonë, ku numri i tyre në krahasim me vitet e mëhershme ka rënë në mënyrë të dukshme.
Problem tjetër mjaft shqetësues mbetet dukuria e djegies së kallamishteve për rreth baseneve e të cilat shërbejnë si një vendstrehim për shumë lloje te shpendëve ujore e gjithashtu edhe si vend ku shumica prej llojeve folenizuese i ndërtojnë foletë e tyre në të.

Ndikim tjetër në këtë zonë kanë mbeturinat, turizmi i pa kontrolluar, gjuetia ilegale dhe e pakontrolluar në llojet e zogjve prezent. Nëse vazhdohet në këtë mënyrë do të rrezikohet prezenca e një numri të madh të shpenzve duke perfshirë edhe llojet shtegtare.
Meqenëse në kufi të kësaj zone gjendet Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari", sipas zyrtarëve të aeroportit numër i madhe i shpendëve dhe afërsia e Ligatinës me aeroportin, paraqesin shqetësim për sigurinë në aeroport, andaj mbetet që në të ardhmen të punohet bashkërisht në mënyrë që të rritet siguria maksimale e përgjithshme në aeroport.

8.3. Rekomandimet

1. MMPHI të themeloj organi për administrimin dhe menaxhimin me këtë zonë;
2. Autoritetet e Aeroportit Ndërkombëtare "Adem Jashari" të bëjnë monitorimin e numrit të zogjve dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e kushteve të sigurta në hapësirën e aeroportit dhe rreth tij;
3. Të hartohet Plani për Menaxhimin e Ligatinës;
4. Hartimi i një projekti me qëllim të funksionalizimit të kësaj zone;
5. Vazhdimi i hulumtimeve për inventarizimin e llojeve dhe habitateve në këtë zonë;
6. Të ndalohet privatizimi i kesajë zone dhe pronat që menaxhohet nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP), të bartet në përgjegjësi të MMPHI -së.

IX. PARK NATYRE

9.1. Mali i Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës

Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës në vitin 2019 janë shpallë park natyre, me sipërfaqe 5.762.57 ha. Sipas hulumtimeve të deritanishme është konstatuar se Mali i Pashtrikut është qendër e rëndësishme e vlerave natyrore dhe biodiversitetit, jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjërë. Kjo zonë është shumë e pasur në aspektin floristik, faunistik, gjeologjik, gjeomorfologjik, kulturor dhe turistik etj.
Liqeni i Vërmicës është krijuar në rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë në dalje të lumit, në territorin e Shqipërisë dhe karakterizohet me vlera të veçanta biologjike, biogjeografike, gjeologjike, hidrologjike dhe peizazhore. Në ketë zonë, lumi ka krijuar gryken epirogjenike e cila paraqet monument të rëndësishëm me karakter gjeomorfologjik. Kjo zonë paraqet potenciale shumë të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit ndërkufitar.



Harta nr. 4. Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës



Foto nr. 44. Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës

9.2. Flora

Mali i Pashtrikut paraqet një mozaik të vërtetë me vegjetacion heterogjen, në shtrirjen vertikale, ku mund të dallojmë disa zona të fitocenozave me veti karakteristike për rajonin. Bazuar në hulumtimet e deritashme është konstatuar se në malin e Pashtrikut, janë prezente më shumë se 1000 llojeve të bimëve vaskulare dhe 120 bimë mjekësore e aromatike, 56 lloje bimore (janë bimë endemike të Ballkanit), 12 lloje relikte, si dhe lloji endemik lokal Gjuhëqeni i Krasniqit (*Cynoglossum krasniqii* T. Wraber, 1986)[20].



Foto nr. 45. Cerfalare e Pashtrikut (*Cephalaria pastricensis*)



Foto nr. 46. Kemashna (*Hieraciumwaldsteinii*)

9.3. Vegjetacioni

Vegjetacioni i Malit të Pashtrikut përbehet nga 20 asociacione bimore siç janë: *Quercetum frainetto cerris scardicum, Quercetum trojana dukagjini, Dioscoreo- carpinetum orientalis, Quercetum pubescentis cerris, Ostryo-Quercetum cerris, Colurno-Ostryetum carpinifolia, Polygalo-Forsythietum europeae, Polygalo-Gensitetum hassertianae,*

[20] Hulmtimet nga Krasniqi, 1972; Rexhepi & Ruzic, 1985; Rexhepi, 1985; 1994; Wraber, 1985; 1990; Mustafa, 1999; Veselaj, 2006, si dhe hulumtimet gjatë viteve 2012-2014.

Astero-Juniperetum oxycedri, Teucrio-Artemisietum camphoratae, Echinaria-Convoletum altheoides, Fagetum moesiaca montanum, Abieti-Fagetum moesiaca, Inulo-Danthonietum alpinae, Centaureo-Trifolietum velenovsxky, Fagetum subalpinum, Potentillo-Anthylletum montanae, Coronillo-Arctostaphylletum uvae ursi, Erico-Quercetum petraeae serpentinicum, Ostryo-Fagetum[21],prej të cilave dy asociacione janë endemike si: *Polygalo-Forsythietum europeae dhe Polygalo -Gensitetum hassertianae* dhe dy të tjera janë asociacione relikte si: *Dioscoreo - carpinetum orientalis dhe Colurno-Ostryetum carpinifoliae,* etj.

9.4. Fauna

Mali Pashtrik është i pasur në aspektin e faunës. Në këtë zonë gjenden lloje të ndryshme të faunës, si: shpezë, gjitarë, zvarranikë, ujë tokësorë, etj. Gjitarët e mëdhenj si Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*) dhelpra, kaprolli, dhija e egër, derri i egër, shqarthi i bardhë, shqarthi i artë, ketri, vjedulla, gjeri i lajthive etj., kurse shpendët janë shqiponja e artë, shqiponja mijëgrënëse, skifteri maloretj etj..
Ndërsa fluturat janë ndër grupet më të hulumtuara të shtazëve në kuadër të Malit Pashtrik, ku janë konstatuar gjithsejtë 98 lloje të fluturave. Prej tyre 95 lloje të flutura janë listuar në "Librin e Kuq të Fluturave të Evropës"[22].


Foto nr. 47. *Polyommatus Icarus.*


Foto nr. 48. *Pieris mannii*


Foto nr. 49. *Calias* alfacariensis

9.5. Gjendja

Edhe pse Mali Pashtrik dhe liqeni i Vërmicës janë shpallur Park i Natyre në vitin 2019 ende Ministria nuk kanë arritur të themelojnë organi për administrimin e zonës, si dhe nuk ka plan të menaxhimin. Si pasoj e mos themelimit të organit menaxhues, janë duke u degraduar vlerat natyrore dhe biodiversitetit, kryesisht degradimi vjen nga faktori njeri si: prerja ilegale e pyjeve, ndërtimet ilegale, zjarret, gjueti ilegale e faunës, hedhja e mbeturinave, hapja e rrugëve, (pa projekte), turizmi i pa kontrolluar si dhe mbledhja ilegale e bimëve mjekësore dhe aromatike; etj. Në afërsi të liqenit të Vermicës janë duke u zhvilluar aktivitete të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me sektorin e hotelerisë. Në disa vende ka hedhje të mbeturinave nga vizitoret dhe operatoret ekonomik dhe shkarkimi i ujërave të zeza.

[21] Hulumtimet nga Rexhepi (1986, 1994)
[22] Hulumtimet nga Jaksic, 1999;

Kjo dukuri është në rritje e sipër dhe po ndikon në biodiversiteti e liqenit dhe në pamjen e përgjithshme , e njëkohësisht po shkakton ndotjen e sipërfaqës tokësore dhe ujore të liqenit.

9.6. Rekomandimet

1. Urgjentisht të themelohet organi për administrimin e Parkut të Natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës";
2. Të hartohet Plani Menaxhues për "Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vermicës";
3. Inspektorati i MMPHI-së në bashkëpunim me Inspektoratin Komunal, të inspektojnë zonën dhe të ndërmarrin masa konform ligjeve në fuqi;
4. Të ndalohen ndërtimet ilegale, infrastruktura dhe mbledhja ilegale e bimëve mjekësore dhe aromatike;
5. Të bëhet vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme florës dhe faunës;
6. Të bëhet pastrimi i tërësishëm i Malit Pashtrik nga minat;
7. Të promovohen vlerat natyrore, turistike dhe i prodhimeve tradicionale të zonës ndërkufitare;
8. Të ndërtohet një mbikalim për shtazët e egra "urës ekologjike" mbi rrugën e kombit në mënyrë që t'ju mundësohej lëvizja e lirshme nga njeri anë në tjetrën;
9. Bashkëpunimi me Shqipërim për shpalljen Malin Pashtrik dhe Liqenin e Vermicës (pjesa e Shqipërisë) zone e mbrojtur ndërkufitare Kosove - Shqipëri;
10. Të bëhet shenjezimi i kufirit të jashtëm të parkut dhe promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore te zonës;
11. Të bëhet menaxhimi i mbeturinave dhe i ujërave të zeza për rreth Liqenit të Vërmicës nga niveli lokal.

X. MONUMENTET E NATYRËS

10.1. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes"

Qeveria e Kosovës në vitin 2009, ka shpallur Shpellen e Gadimës Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë, me sipërfaqe prej 39 ha. Ky monument, paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike, të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërfutur në rreshpet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku, e bëjnë këtë shpellë raritet të veçantë me përmasa botërore.

Shpellën e bëjnë të veçantë prezenca e Aragoniteve, të cilat karakterizohen me forma dhe drejtime të ndryshme të shtrirjes të cilat janë posaçërisht interesante dhe tërheqëse.

10.1.1. Gjendja

Gjatë viteve 2018 - 2021 gjendja e MNRV "Shpella e Gadimës" nuk është përmirësuar dhe shpella ballafaqohet me probleme të shumta. MMPHI ende nuk ka arritur të funksionalizoj

Drejtorin për Administrimin e Monumentit të Natyrës më Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", ashtu siç e parasheh Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233).
Gjatë kësaj periudhe, gjendja në MNRV "Shpella e Gadimes" nuk është e kënaqshme si pasojë e mungesës së stafit profesional dhe mungesës së investimeve në shpellë. Shqetësim për sigurinë e vizitorëve në shpellë paraqesin rrëshqitjet e ndryshme të cilat vijnë nga oxhaqet e shpellës, sidomos në periudhat e lagështa kur ka lëvizje të argjilës dhe rënia e copave të shkëmbinjve në korridoret që frekuentohen nga vizitorët.
Në afërsi të shpellës veprojnë një numër i konsiderueshëm i gurthyesve qe kanë krijuar një pamje të shëmtuar për zonën turistike. Nuk ka matje sizmike për efektet e minimeve nga gurthyesi në shpellën e Gadimes, por këto minime mund të kanë efekt negativ për shpellën.
Problem tjetër shqetësues në shpellë mbetet ndriçimi. Nga monitorimi në terren dhe njoftimi nga stafi i shpellës është konstatuar se kablloja kryesore e rrjetit elektrik nuk është ndërruar (qe nga vitet '70) dhe si e tillë paraqet rrezik për vizitor.
Gjithashtu vlen të theksohet se ndriçimi në shpellës nuk është i instaluar në mënyrë profesionale, pasi që një numër i madhe i dritave janë orientuar drejt stazës së vizitorëve. Ndriçimi në shpellë nuk fiket automatikisht pas largimit të vizitorëve nga galeria, por shpella është e ndriçuar gjatë gjithë kohës së prezencës së vizitorëve në shpellë, e që gjithashtu paraqet problem për shpellën. Problem tjetër është paraqitja e myshqeve dhe kërpudhave si pasojë e ndryshimeve mikroklimatike, të kushtëzuar me mbylljen hermetike të hyrjes-daljes si dhe ndriçimi afatgjatë dhe jo adekuat. Në korridore dhe galeritë e shpellës vërehen disa grafite dhe mbishkrime qe e dëmtojnë imazhin dhe origjinalitetin e shpellës.


Foto nr. 50. Gjendja e ndriçimit në Shpellën e Gadimës


Foto nr. 51. Myshqet në Shpellën e Gadimës

Gjatë periudhe 2018 - 2021 në baze të evidencës se administratës, shpellën e kanë vizituar rreth 50 mijë vizitor.

Tabela nr.5. Numri i vizitorëve në Shpellën e Gadimës

Viti	Numri i përgjithshëm i vizitoreve	Numri i vizitorëve të liruar nga Pagesa	Numri i vizitorëve me pagës 2 / €	Numri i vizitorëve me pagës 1 / €	Numri i vizitorëve me pagës 0.50/cent
2018	16757	1434	9552	5235	5681
2019	19862	1429	7775	6637	3441
2020	1505	213	603	489	200
2021	9084	2184	3843	2712	349

Burimi: MNRV "Shpella e Gadimes"

10.1.2. Rekomandimet

1. Funksionalizimi i plotë i organit për Administrimin e MNRV "Shpella e Gadimes";
2. Të ndërmerren masa urgjente për ngritjen e sigurisë për vizitorët nga rrëshqitja e argjilës dhe materialeve tjera dhe vendosja e rrjeteve mbrojtëse;
3. Të ndërmerren masa urgjente për përmirësimin e rrjetit elektrik në shpellë me qëllim të rritjes së sigurisë për vizitor;
4. Të përgatitet Plani Menaxhues për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes";
5. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MNRV "Shpella e Gadimes" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) dhe rregulloren (MMPH, Nr: 23/2014);
6. Inspektorati i MMPHI të merr masa ndaj ndërtimeve ilegale dhe objekti i cili ka qenë pronë e shpellës t'i kthehet organit menaxhues;
7. Të rritet numri i stafit profesional në MNRV "Shpella e Gadimes"
8. Të bëhet trajnimi profesional i stafit të shpellës së Gadimës;
9. Të behën matjet sizmikë në shpellë për konstatimin e ndikimeve nga minimet e gurthyesve;
10. Të ndalohen vizitorët në sallën e aragonitve dhe merren masat për mbrojtjen kristaleve të aragimiteve;
11. Të ndalohen të gjitha aktivitetet e gurthyesve në afërsi të shpellës së Gadimes;
12. Të behët rehabilitimi i zonës ku ndodhen gurthyesit;
13. Dhënia e biletave të behet me kupon fiskal;
14. Të hyrat nga vizitoret e shpellës, të shfrytëzohen për investime dhe hulumtime në shpellë;
15. Të hulumtohen korridoret dhe galeritë tjera në MNRV "shpellën e Gadimes" dhe të përgatitën për vizitor;
16. Të bëhet monitorimi i përhershëm i parametrave gjeo-klimatik dhe në bazë të kushteve klimatike të lejohen edhe vizitat e turistëve në shpellë;
17. Të bëhet promovimi i shpellës së Gadimës si pikë gjeoturistike në Kosovë dhe regjion.

10.2. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"

Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës" është një ndër zonat më të bukura dhe më interesante. Qeveria e Kosovës në vitin 2012 ka nxjerr vendim për shpalljen e Ujëvarave të Mirushës, Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë, me sipërfaqe prej 598.4 ha. Lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i Lumit Mirusha. Në këtë pjesë të kanionit janë krijuar 16 liqene me ujëvara, të cilat së bashku krijojnë një fenomen morfo-hidrologjik që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanionit. Forma karakteristike në përbërjen e relievit përveç ujëvarave dhe liqeneve janë edhe shpellat me forma dhe madhësi të ndryshme (Shpella e Dushit, Shpella e Kishës së Madhe dhe të Vogël, Shpella të liqeni i dhjetë etj.).

MNRV "Ujëvarave të Mirushës" është mjaft e pasur me lloje bimore, në të cilën dallojmë rreth 330 lloje të bimëve vaskulare dhe rreth 44 lloje të kërpudhave të larta (makromicetet).
Në aspektin faunistik, ky territor është poashtu i pasur me lloje të veçanta të shtazëve, të cilat janë të lidhura për biotope specifike dhe i përkasin llojeve endemike.



Foto nr. 52. Ujëvarat e Mirushës



Harta nr. 5. MNRV "Ujëvarat e Mirushës"

10.2.1. Gjendja

Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinore për zonën e mbrojtur "Ujëvarat e Mirushës" (2014) më qëllimi të parandalimit të zhvillimeve të pa planifikuara, që dëmtojnë zonën, mirëpo dukurit negative kanë vazhduar edhe më tutje. MMPHI ende nuk e ka funksionalizuar organin menaxhues për MNRV "Ujëvarat e Mirushës", që e cakton Ligji për Mbrojtjen e Natyrës.
Gjatë monitorimit në periudhën 2018 -2021, janë konstatuar ndërhyrje të konsiderueshme nga faktori njëri, sidomos gjatë e punimeve për hapjen e shtigjeve në drejtim të ujëvarave nga aksi rrugor Klinë - Gjakovë. Sipas Planit Hapësinore për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushes", traseja e projektit kalon përgjatë zonës së parë dhe të dytë të regjimit të mbrojtjes.
Plani Hapësinor, për zonën e mbrojtur "Ujëvarat e Mirushes", ka përcaktuar regjimin e mbrojtjes në masat për mbrojtjen e natyrës në pikën 1. 21. MMPH harton VSM (me VNM dhe VNS) të bazuar në Planin Hapësinor si kornizë e masave, projekteve dhe aktiviteteve që do të zhvillohen brenda MNRV "Ujëvarat e Mirushës".
Gjatë monitorimit të zonës është konstatuar se përveç zgjerimit të panevojshëm prej 12 m (sipas projektit gjerësia e shtegut do të jetë 6 m, 2 m shtegu i këmbësoreve, 2 m shtegu i gjelbër dhe 2 m shtegu për biçikleta), zgjërimi i aksit në pjesën e gjatësisë së tij i tejkalon këto përmasa të cilat mund të vërehet me degradimin e peizazhit dhe vegjetacionit.




Foto nr. 53 dhe 54. Zgjerimi i rrugës dhe rrëshqitja e dheut në në MNRV "Ujëvarat e Mirushës

Zgjerimet e aksit janë konstatuar edhe në segmentet e rrugës me bazë shkëmbore ku materiali është shfrytëzuar për shtrimin e trasesë. Me këtë rast duhet nënvizuar se në disa segmente, trasetë e shtigjeve janë hapur në afërsi të brigjeve të lumit Mirusha.

Dukuritë tjera negative në zonën e mbrojtur MNRV "Ujëvarat e Mirushës" janë dhe mbeturinat e ngurta, mbeturinat nga vizitorët, ndërtimet e objekteve ilegale, ndotja lumit nga banoret vendas në rrjedhjen e mesme, shkarkimi i ujërave të zeza në lum, ku si rezultat i kësaj ndotje ka ardhur deri të ngordhja e peshqve dhe gjallesave tjera në lum.

Po ashtu shqetësim mbetet shfrytëzimi i ujit në lumin Mirusha gjate stinës së verës nga banorët për qëllime bujqësore, ndërtimi i një pende në shtratin e lumit. Këto ndërhyrje po ndikojnë në shterjen e ujit në Ujëvarat e Lumit Mirusha.

Në kanionin e lumit Mirusha është vendosur në mënyrë ilegale nga individët dhe shoqatat e ndryshme zip line të cilët paraqesin rrezik për vizitoret, si dhe grafitë në muret shkëmbore etj. Të gjitha këto ndërhyrje ilegale dhe ndërhyrjet tjera kanë krijuar një imazh jo të mirë për MNRV "Ujëvarat e Mirushë".




Foto nr. 55 dhe 56. Ndërtimet ilegale në MNRV "Ujëvarat e Mirushës"

10.2.2. Rekomandime

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të themeloj organin për menaxhimin e zonës së mbrojtur MNRV "Ujëvarat e Mirushës";
2. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MNRV "Ujëvarat e Mirushës" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Planin Hapësinore për MNRV "Ujëvarat e Mirushes";
3. Inspektorati i MMPHI të inspekton në vazhdimësi gjendjen dhe të veproj konform ligjeve në fuqi;

4. Të gjitha aktivitetet brenda kufirit të zonës së mbrojtur “MNRV “Ujëvarat e Mirushes”, të realizohen me projekte konkrete dhe me pëlqim paraprake nga MMPHI-ja;
5. Të ndërmerren masa për rehabilitimin e zonës sidomos në pjesën e shtegut;
6. Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim negativ për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e MNRV “Ujëvarat e Mirushës” dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mbrojtjes së natyrës ;
7. Komuna e Malishevës të merr masa që ujërat e zeza dhe mbeturinat të mos derdhen në Lumin Mirusha;
8. Të përgatitet Plani i Menaxhimit për MNRV “Ujëvarat e Mirushës” me të cilin do të përcaktohen aktivitetet e lejuara sipas shkallës së mbrojtjes;
9. Të behet hulumtimi i florës, faunës dhe i veçorive gjeomorfologjik, speleologjike dhe hidrologjike në zonë;
10. Të rrënoen të gjitha ndërtimet ilegale në MNRV “Ujëvarat e Mirushës”;
11. Të ndërtohet qendra informuese turistike dhe edukativo- arsimore në këtë zonë;
12. Të vendosen tabelat informuese;
13. Vizitorët në MNRV “Ujëvarat e Mirushës” të shoqërohen nga ciceronët;

10.3. Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit

Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit janë vënë nën mbrojtje në vitin 1983, si monument natyror me sipërfaqe prej 89.94 ha. Shpella e Radavcit është shpellë tipike e burimeve. Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe veprimet ujërave nëntokësor të Drinit të Bardhë. Deri me tani janë hulumtuar rreth 2100 m kanale nëntokësore, por hulumtimet vazhdojnë akoma.
Shpella është e njohur edhe si “Bukuroshja e fjetur” dhe është hapur për vizitor në viti 2015. Për vizitor është e hapur vetëm galeria hyrëse, qendrore dhe ajo e vaskave. Shpella e Radavcit është edhe monument i trashëgimisë kulturore-lokalitet arkeologjik, ku mendohet se janë gjetur shenja të popullimit të lashtë nga koha e neolitit. Me shpalljen e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në vitin 2013, një pjesë e konsiderueshëm e zonës është përfshirë në kuadër të parkut.



Foto nr. 57 dhe 58. Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit

10.3.1. Gjendja

Bazuar në monitorimin e gjendjes në terren në Monumentin e Natyrës "Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit", janë konstatuar ndërhyrje të shumta nga faktori njeri. Ndërhyrjet kryesisht janë realizuar rreth ujëvarës, të cilat konsistojnë me vendosjen e kioskave të llojllojshme dhe pa kriter përgjatë rrugës që të dërgon tek burimi. Pastaj ndërhyrjet në zgjerimin e vendqëndrimeve për vizitor, hedhja e mbeturinave, prerja e drunjtëve, mungesa e tabelave informuese etj. Në vitet e mëhershme ndërhyrjet në rregullimin e rrjetit për shfrytëzimin e ujit nga ana e hidrocentralit për furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e sasisë së ujit në ujëvarën e Burimit të Drinit të Bardhë.
Në në shpellën e Radavcit zhvillohen aktivitet të ndryshme, si hulumtime nga speoleologet e huaj, intervenime në rregullimin e shtigjeve për vizitor në brendi të shpellës, elektrifikime, xhirimet, hedhja e mbeturinave etj. Të gjitha këto aktivitete behën në mënyrë ilegale, pa projekte konkrete, pa leje dhe pëlqime nga institucionet kompetente.




Foto nr. 59 dhe 60. Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur

10.3.2. Rekomandime

1. Të gjitha veprimtaritë dhe intervenimet të cilat realizohen brenda Monumentit të Natyrës "Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit" të janë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjin për Ujërat, etj;
2. Të definohen përgjegjësit për menaxhimin e shpellës se Radavcit në mes Komunës së Pejës dhe Shoqatës Speleologjike "Aragoniti" sipas Ligjit për mbrojtjen e Natyrës dhe ligjeve tjera në fuqi;
3. Të gjitha hulumtimet dhe aktivitetet brenda kufirit të zonës së mbrojtur Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit të realizohen me projekte konkrete dhe me pëlqim nga MMPHI;
4. Komuna e Pejës të themeloj organin për Administrimin e Shpellës se Radavcit dhe Burimin e Drinit të Bardhë
5. Inspektorati i MMPHI-së në bashkëpunim me Inspektoratin e Komunës se Pejës të inspektojnë zonën dhe të ndërmarrin masa konform ligjeve në fuqi;
6. Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim negative për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e zonës se mbrojtur dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mbrojtjes së natyrës;

7. Të realizohen projektet profesionale për hulumtimet e korridoreve dhe galeritë te reja në shpellën e Radavcit;
8. Komuna e Pejës të harmonizoj vendimin 02-numër 633/7, datë 29.12.1982 për mbrojtjen e Burimit të Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233);
9. Të rishikohet sipërfaqja e zonës se mbrojtur Burimi i Drinit të Bardh dhe Shpella e Radavcit;
10. Të mbrohet strikt dhe të ndalohet për vizitorë pjesa e shpellës me vlera arkeologjike;
11. Të ndalohen të gjitha ndërtimet ilegale brenda zonës se mbrojtur;
12. Të hartohet Plani Menaxhues për shpellën e Radavcit dhe Burimin e Drinit të Bardhë;
13. Të vendosen shenja - tabelat informuese në zonën e mbrojture;
14. Shpella e Radavcit dhe Burimi i Drinit të Bardhë te përfshihen në kuadër te programeve turistike dhe programeve edukativo arsimore, regjionale dhe me gjërë;
15. Të ndërtohet qendëra informuese turistike.

10.4. Bifurkacioni i Lumit Nerodime

Bifurkacioni i Lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy dete. Lumi i Nerodimës i cili buron në bjeshkët e Jezercit në afërsi të Ferizajt ndahet pakthyeshëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega e majtë, përmes Sazlis derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega e djathtë, përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në Detin Egje.

Në vitin 1979 Kuvendi Komunal i Ferizajt, Bifurkacionin e Lumit Nerodime e shpallë zonë të mbrojtur në kategorin Rezervat special i natyrës, me sipërfaqe prej 12. 78, 71 ha.

Me qenë se ekzistonte shpërputhje në sferën ligjore në mes kohës kur fenomeni është shpallur i mbrojtur dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 2018, Ministria në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt kanë formuar grupin punues për hartimin e profesionale për kategorizimimin e Bifurkacionit në kategorinë Monument Natyre.



Foto nr. 61. Bifurkacioni i Lumit Nerodime

Në vitin 2018, është përgatitur arsyeshmëria profesionale për rikategorizimin e zonës së mbrojtur “Bifurkacioni i lumit Nerodime” dhe i është rekomanduar komunës se Ferizajt që të nxjerr vendimin për kategorizimin e Bifurkacionit në kategorinë monument natyre. Kuvendi komunal i Ferizajt ka nxjerr vendimin për kategorizimin e “Bifurkacioni i Lumit Nerodime", si Monument i Natyrës, por ky vendim pas shqyrtimit të ligjshmërsië nga Ministria e Administratës Publike (MAPL) është kthyer në komunë për plotësim, por deri me tani komuna e Ferizajt ende nuk e ka plotësuar vendimin kështu që “Bifurkacioni i Lumit Nerodime", ka mbetur pa status të definuar të mbrojtës ligjore.



Harta nr. 6. Kufiri i Bifurkacionit të Lumit Nerodime i propozuar për mbrojtje si monument i natyrës

10.4.1. Gjendja

Edhe gjatë periudhës 2018-2021, gjendja në Bifurkacionin e Lumit Nerodime nuk është përmirësuar dhe Bifurkacioni nuk është funksional.

Përkundër intervenimeve qe janë berë në të të kaluarën, prapë ky fenomen i rallë natyror nuk është funksional. Intervenimet janë realizuar pa projekte të mirëfillta për funksionalizimin e bifurkacionit dhe nuk është përfshirë e gjitha zona , por vetëm disa segmente në shtratin e lumit Nerodime. Në shtratin e lumit janë krijuar pengesa, që janë material i sjellë nga vet lumi, mbeturina të hedhura nga banorët, shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit, por edhe pengesa të ndryshme të ngritura në shtratin e lumit nga operatorët ekonomik të cilët zhvillojnë aktivitetet e tyre në afërsi të zonës së mbrojtur, sidomos në degën e majtë. Si pasojë e aktiviteteve të lartpërmendura, por edhe mungesës së reshjeve gjatë verës dhe vjeshtës së hershme, Bifurkacioni shpesh herë ballafaqohet me mungesë të ujit në dy degët e tij. Gjendja në Bifurkacionin e Lumit Nerodime, nuk është e mirë (jo funksional), prandaj kërkohet që të merren të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e rrjedhës normale të ujit në të dy degët e Bifurkacionit.




Foto nr. 62 dhe 63. Gjendja në degën e majtë të Bifurkacionit

10.4.2 Rekomandimet

1. Meqenëse në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/ L-233, nuk ekziston kategoria Rezervat Special i Natyrës, atëherë rekomandojmë që mbrojtja ligjore e Rezervatit Special të Natyrës të Bifurkacionit të harmonizohet në kategorinë monument natyre, që nënkupton t'i ndërrohet kategoria e mbrojtjes;
2. Kuvendi Komunal i Ferizajt, urgjentisht të filloj proceduarat për nxjerrjen e vendimit për rikategorizimin e "Bifurkacionit të Lumit Nerodime", në kategorinë e Monumentit të Natyrës;
3. Inspektorati i MMPHI-së në bashkëpunim me Inspektoratin e Komunës së Ferizajt të inspektojnë zonën dhe të ndërmerren masa konform ligjeve në fuqi;
4. Komuna e Ferizajt të monitoron dhe të angazhohet në mirëmbajtjen e rrjedhës së lumit Nerodime, me qëllim të funksionimit të bifurkacionit, meqenëse në periudhat me zhvillim të hovshëm të vegjetacionit dhe rritjes së kërkesave për ujitje mund të krijohen pengesa dhe zvogëlimin e sasisë së ujit përgjatë rrjedhës ujore;
5. Të gjitha ndërhyrjet në zonën e mbrojtur të "Bifurkacionit të lumit Nerodime", të realizohen përmes projekteve profesionale në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës;
6. Komuna e Ferizajt në bashkëpunim me MMPHI-n, të hartoj një projekt për rregullimin e shtratit të lumit Nerodime, i cili do të mundësonte funksionimin normal të Bifurkacionit, në menyrë qe fenomenit t'i kthehet vlera natyrore dhe të shndërrohet në atraksion turistik;
7. Hartimi i Projektit për hapjen, pastrimin dhe rregullimin e shtratit të lumit nga 100 metra mbi ujëvarë deri të Mulliri i Nikës, në gjatësi prej rreth 1.3 km, për të vazhduar me degën e djathtë e cila i shkarkon ujërat në rrjedhën e Sazlisë me gjatësi rreth 1.2 km, që do të mundësonte funksionalizimin e fenomenit të Bifurkacionit.

10.5. Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë

Lumi Drini i Bardhë gjatë një procesi të gjatë gjeomorfologjik - hidrologjik ka krijuar një grykë në mes dy masiveve të shkëmbijve gëlqeror duke formuar një kanion shumë tërheqës dhe interesant. Kanioni është krijuar në periudhën e neogjenit të liqenit të Dukagjinit. Mirëpo, intensiteti i "prerjes" dhe thellimit të kanionit të epigjjenisë është kushtëzuar dhe nga proceset e lëvizjeve të mëvonshme tektonike. Gryka ka veçori tipike të kanionit dhe është zhvilluar në formacione karbonatike të kretakut të sipërm.
Kanioni shtrihet në rrjedhjen e mesme të Drinit të Bardhë, është monument i natyrës me karakter hidro-gjeomorfologjik dhe përfaqëson vlera natyrore gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrografike, floristike, vegjetative dhe faunistike. Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë për shkak të vlerave të lartpërmendura, në vitin 1986 është marrë nën mbrojtje si Monument Natyror me sipërfaqe prej 199 ha dhe shtrihet në territorin e komunave Rahovec (125 ha) dhe Gjakovë (74 ha).

10.5.1. Gjendja

Gjatë monitorimit të gjendjes së zonës tek Kanioni i Drinit të Bardhë, te Ura e Fshejtë janë konstatuar ndërhyrje në të dy anët e kanionit. Ndërhyrjet më të dukshme janë në pjesën e cila menaxhohet nga komuna e Gjakovës, e cila në kuadër të realizimit të projektit, rivitalizimi i Urës së Fshajtë & Kanioni, ndriçimi, shtigjet për ecje, ka intervenuar në hapjen e vend parkingut dhe një shtegu për vizitor.
Projekti nuk ka respektuar parimet për ndërtime në zonat e mbrojtura, shtegu në disa raste është me gjerësi më të madhe se 3 m. Komuna e Gjakovës gjatë kësaj periudhe ka ndërhyrë edhe me vendosjen e një "Ure Tibetiane" e cila lidhë të dy brigjet e kanionit në pjesën më madhështore të tij, duke mos respektuar Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.
Në pjesën e cila menaxhohet nga Komuna e Rahovecit, nga vizitat e më hershme janë konstatuar ndërhyrje të konsiderueshme, sidomos në pjesën poshtë magjistrales. Në kuadër të projektit për ridefinimin e statusit dhe kufirit të kësaj zone, që është në proces e sipër është propozuar qe kjo pjesa poshtë magjistrales të mos përfshihet në brenda kufirit të ri të zonës. Ndërsa në pjesën e sipërme të magjistrales komuna ka ndërtuar Kompleksi Memorial me obeliskun. Ndërhyrjet në këtë zonë edhe më shqetësues i bën fakti se në vendin e njëjtë në të cilin është hapur ky shteg, në pjesën që i takon Komunës së Rahovecit është konstatuar një lloj i ri bimor (*Sternbergia colchiciflora*) dhe gjinie të re (*Amaryllis*) për florën e Kosovës.



Foto nr. 64. Ndërhyrjet në zonen e mbrojtur

10.5.2. Rekomandimet

1. Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MN "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
2. Të ndalohen të gjitha ndërtimet dhe aktivitetet ilegale në këtë zonë,
3. Çdo ndërhyrje në ketë zonë të jet me projekte të studiuar dhe analizuar mirë dhe në përputhje me planet dhe programet komunale;
4. Inspektorati i MMPHI-së, në bashkëpunim me Inspektoratin e Komunës se Gjakovës dhe Rahovecit të inspektojnë zonën dhe të ndërmarrin masa konform ligjeve në fuqi;
5. Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim negative për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e Monumentit të Natyrës, dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mbrojtjes së natyrës;
6. Komuna e Gjakovës dhe e Rahovecit të nxjerrin vendim për rikategorizimin e Monumentit të Natyrës "Kanioni i Drinit Dardhë të Ura e Fshejtë" sipas propozimit të grupit punues (nr. prot. 3522/17);
7. Zona të promovohet dhe të shfrytëzohet për qëllime edukativo-arsimore.

10.6. Gjendja e disa Monumenteve Natyrore tjera

Gjatë vizitave monitoruese në Monumentet Natyrore në disa komuna si në: Prizren, Podujevë, Klinë, Malishevë, Skenderaj, Istog, Drenas, Mitrovicë, Obiliq, Suharekë është konstatuar se gjendja e disa prej monumenteve të mbrojtura nuk është e mirë. Në të gjitha rastet vërehet se gjendja e tyre ka ndryshuar si rezultat i ndikimit të faktorëve natyror, veprimit të insekteve të ndryshme, nga vjetërsia por edhe nga faktori njeri (zjarret) etj. Si rezultat i këtyre dukurive në disa prej tyre janë vërejtur dëmtime në trung, duke u manifestuar me zgavra të mëdha në brendi, tharje e degëve dhe njëkohësisht duke dobësuar qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e rrënjës dhe trungjeve, si dhe duke ndryshuar pamjen e përgjithshme të tyre.

Në Komunën e Malisheve nga faktori njeri, është dëmtuar dhe shkatërruar hyrja dhe hapësira mbi shpellën e Temeqines. Dëmtimi i shpella ka ardhur si rezultat i shfrytëzimit të guroreve gëlqërorë mbi shpellë dhe përreth saj nga banoret vendës për përfitime e ekonomike. Shumë monumentet të natyrës me karakter speleologjik ende nuk kanë organ për Administrimin e tyre dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri të dëmtimi i stolive shpellore si dhe hedhja e mbeturinave (Shpella e Panorcit, Shpella e Kusarit, Shpella e Kishnareskës, etj).
Ndërtimet e objekteve janë konstatuar edhe në afërsi të burimi të ujit mineral në Sallabajë dhe burimi i ujit në fshatin Shakovic të komunës së Podujevës. Këto ndërtime kanë ndikuar në degradimin e zonës si dhe në imazhin jo të mirë të zonës së mbrojtur.

Tabela nr. 6. Lisat e Monumenteve të dëmtuara

Nr:	Komunat	Monumente Natyrore	Viti	Nr.
1	Podujevë	Trungu i dushkut *(Quercus sp.)* në Llapashticë Epërme	2015	1
2	Klinë	Trungun e qarrit *(Quercus cerris)* në Zllakuçan Trungun e shpardhit *(Quercus frainetto)* në Gllarevë	1985 1985	1 1
3	Malishevë	Trungu i qarrit *(Quercus cerris)*, në Bubël Trungjet e bungut *(Quercus petraeae)* në Llozicë Shpella e Temeqinës	2014 1985 2014	1 2 1
4	Skenderaj	Trungjet e bungëbutës *(Quercu pubescens)* në Klladernicë Trungu i qarrit *(Quercus cerris)* në Kotorr	2007 2007	3 1
5	Istog	Trungjet e manit *(Morus nigra)* në Cerrcë	2008	1
6	Drenas	Trungjet e bungëbutës *(Quercus pubescens)* në Likoshan Trungu i bungëbutës *(Quercus pubescens)* në Likoshan Trungu i qarrit *(Quercus cerris L.)* në Krajkovë Trungjet e bungëbutës *(Quercus pubescens)* në Tërstenik	2006 2006 2006 2006	1 1 1 1
7	Mitrovicë	Trungu i ahut *(Fagus sylvatica)* në Bare Trungu i ahut *(Fagus sylvatica)* në Bajgorë	2019 2019	1 1
8	Obiliq	Trungu i rrënjës *(Quercus robur)* në Sibovc Trungu i manit *(Morus nigra)* në Mazgit	2019 2019	1 1
9	Suharekë	Kompleksin e trungjeve *(Quercus sp.)* në Papaz	2007	1
Gjithsejtë				21

Burimi: IKMN



Foto nr. 65. Trungu i qarrit *(Quercus cerris)* Bubël, Malishevë



Foto nr. 66. Trungu i dushkut *(Quercus sp.)* në Llapashticë, Podujevë

Gjatë monitorimit në tri vitet e fundit në disa zona të mbrojtura (Monumente Natyrore), janë konstatuar se disa monumente të natyrës janë dëmtuar tërësisht dhe i kanë humbur vlerën e zonës se mbrojtur. IKMN- ja, ka përgatitur raporte dhe i ka propozuar komunave përkatëse që të bëjnë shfuqizimin e vendimeve për monumentet e dëmtuara gjatë periudhave të ndryshme.

Tabela nr. 7. Lista e Monumenteve që e kanë humbur statuesin e zonës së mbrojtur

Emri	Komuna	Sipërfaqja në ari	Viti i mbrojtjes	Viti i dëmtimit	Kategoria
Trungu i rrënjës (*Quercus robur)* në Gurrakoc	Istog	12.5	2008	2021	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i blirit të argjendtë (*Tilia tomentosa Moench)* në Kaliqan	Istog	5	2008	2021	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i qarrit (*Quercus ceris L.*) në Drenovc	Malishevë	25	2014	2017	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i bungut (*Quercus pubescens)* në Ujmir	Klinë	2	2008	2018	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i plepit (*Populus sp.*) në Reçan	Suharekë	5	2007	2019	Monument natyror me karakter botanik
Burimi i ujit mineral në Reçan	Suharekë	1	2007	2019	Monument natyror me karakter hidrologjik
Trungjet e dushkut (*Quercus sp.*) në Grejkoc	Suharekë	15	2007	2019	Monument natyror me karakter botanik

Burimi: IKMN

10.6.1. Rekomandimet

1. Komunat të bëjnë monitorimin dhe të raportojnë në MMPHI për gjendjen e zonave të mbrojtura në territorin e tyre;
2. Të bëhet inspektimi i vazhdueshëm nga inspektoret komunal dhe të merren masat konform ligjeve në fuqi;
3. Komuna e Prizrenit të harmonizoj vendimin për vënien nën mbrojtje të përmendores natyrore, Gryka e Bistricës së Prizrenit (nr. 633-12, datë, 15. 11.1972, fleta zyrtare 51/76), me ligjin për mbrojtjen e natyrë (ligji nr. 03/L-233);
4. Komuna e Klinës të harmonizoj vendimin për vënien nën mbrojtje të përmendores natyrore të pjesës së grykës së lumit Klina (nr. 01-325-10, datë, 27.03.1985) me ligjin për mbrojtjen e natyrës (ligji nr. 03/L-233):
5. Komuna e Malishevës të themeloj organin për Administrimin e Shpellës së Panorcit;
6. Komuna e Gjakovës të themeloj organin për Administrimin e Shpellës së Kusarit;
7. Komunat të bëjnë konservimin e monumenteve (trungjeve) të dëmtuar;
8. Komuna e Podujevës të hartoj një plan rregullues për shfrytëzimin e burimeve të ujit mineral dhe termal në fshatin Sallabajë dhe Shakovic;
9. Të bëhet intervenimi fitosanitar në disa nga degët e thara në Monumentet Natyrore të karakterit botanik;

10. Të bëhet vendosja e tabelave informuese;
11. Të ndalohet shfrytëzimi i gurit, hedhja e mbeturinave dhe të gjitha aktivitetet negative në zonat e mbrojtura ku ndodhen shpellat;
12. Monumentet e natyrës të mbrojtura nëpër komuna të përfshihen në kuadër të hartave zonale;
13. Kuvendet komunale ti shfuqizojnë vendimet për monumentet e natyrës, që e kanë humbur statusin e zonës së mbrojtur.

XI. PEIZAZHET MBROJTURA

11.1. Peizazhi i Mbrojtur "Gërmia"

Peizazhi i Mbrojtur Gërmia shtrihet në verilindje të komunës së Prishtinës. Kuvendi Komunal i Prishtinës në vitin 2016 merr vendim për shpalljen e Gërmisë në kategorinë Peizazh i Mbrojtur, me sipërfaqe prej 1949 ha.

11.1.2. Flora dhe vegjetacioni

Nga hulumtimet e deritashme në masivin e Gërmisë janë të evidentuara: 610 lloje të florës vaskulare të grumbulluara në 82 familje duke mos njehsuar taksonet ruderale, 88 lloje të kërpudhave,14 lloje të myshqeve dhe 51 lloje të likeneve.
Vegjetacionin pyjor të Gërmisë e përbëjnë 4 bashkësi pyjore e këto janë: bashkësia e shpardhit dhe qarrit (*Quercetum frainetto-cerris scardicum Kras.), b*ashkësia e bungut dhe shkozës (*Querco-Carpinetum moesiacum*), bashkësia e bungut (*Quercetum moesiacum montanum*) dhe bashkësia e ahut (*Fagetumm moesiacum montanum*). Në masivin e Gërmisë, aktualisht ka(rriten) 6 lloje bimore endemike të Ballkanit, e këto janë: Grurëziu i Heraklës (*Melampyrum heracleticum*), Karafili i hajthëm (*Dianthus gracilis*), Karafili ngjyrë gjaku (*Dianthus cruentus*), Hithëbuta e bigëzuar (*Lamium bifidum*).



Foto nr. 67. Grurëziu i Heraklës (*Melampyrum heracleticum*)



Foto nr. 68. Hithëbuta e bigëzuar (*Lamium bifidum*)



Foto nr. 69. Karafili ngjyrë gjaku (*Dianthus cruentus*)

Llojet e bimore relikte në masivit e Gërmisë, bëjnë pjesë: Xerxelja dafinëz (*Daphne laureola*), Qarrziu (*Quercus trojana*), Lajthia e egër (*Corylus colurna*), Shtogri pendor (*Staphyllea pinnata*), Urthi (*Hedera helix*), Komandra e hijshme (*Comandra elegans*) dhe Hudhra erëmyshku (*Allium cupanii*). Llojet e bimëve të rralla dhe që janë në rrezik të zhdukjes në bazë të hulumtimeve deri me tani është vërtetuar se janë rreth 23 lloje bimore si: *Vingjra lulemadhe (*Lathyrus grandiflorus*) Vingjra pyjore (*Lathyrus sylvestris*) Koeloglosi i blertë (*Coeloglossum iride*) Ptilostemi i pirpiktë (*Ptilostemen strictus*) Qarrziu (*Quercus trojana*) Qumështorja gjethengushtë (*Euphorbia exigua*) Pedikularia tufore (*Pedicularis comosa*) Haraqina mjekësore (*Valeriana officinalis*) Lajthia e egër (*Corylus colurna*) Zhabinorja iliriane (*Ranunculus illyricus*) Liri (*Linum gallicum*) Haplofili (*Haplophyllum suaveolus*), Karafili gjethepishë (*Dianthus pinifolius*) etj*.



Foto nr. 70. Zhabinorja iliriane
(Ranunculus illyricus)



Foto nr. 71. Liri
(Linum gallicum)



Foto nr. 72. Haplofili
(Haplophyllum suaveolus)

Llojet e bimëve mjekësore përbëjnë 52 lloje të bimëve e që janë: Haraqina mjekësore (*Valeriana officinalis*),Sarusha mjekësore (*Stachys officinalis*) Sporisi mjekësor (*Verbena officinalis*), Helmarina (*Atropa bell-donna*), Bari i bletës (*Melissa officinalis*), Xhërrokulli vjeshtor (*Colchicum automnale*), Kalaminta mjekësore (*Calamintha officinalis*), Lulepëllumbi mjekësorë (*Fumaria officinalis*), Barhudhra mjekësore (*Alliaria officinalis*) Pulmonaria mjekësore (*Pulmonaria officinalis*), Luleshurdha mjekësore (*Taraxacum officinale*), Luleshqerra shumëvjeçare (*Bellis perenis*), Thana (*Cornus mas*), etj.

11.1.3. Fauna e Gërmisë

Fauna e Kosovës në tërësi, si dhe ajo e Gërmisë në veçanti, është pak e studiuar. Biotopet e ndryshme të Gërmisë si dhe lartësitë e ndryshme u ofrojnë kushte të mira për jetesë llojeve të ndryshme shtazore. Sipas hulumtimeve të kryera deri më tani përbëhet nga: 5 lloje ujëtokësorësh, 7 lloje rrëshqitësish, 65 lloje shpendësh, 19 lloje gjitarësh.

Gjithashtu në këtë masiv malor janë hulumtuar një numër i madh i insekteve nga rendet Orthoptera, Homoptera, Coleoptera, Diptera, Himenoptera dhe Lepidoptera që paraqesin grupin më të madh të organizmave.

Rrëshqitësit - *Natrix natrix* (bollujca e kenetave) *Zamenis longissimus* (bolla e shtepise), *Vipera ammodytes* (gjarperi i gurit, nepërka), *Vipera berus* (shlliga) etj.

Shpezët - *Cuculus canorus* (qyqja) *Dendrocopos major* (qukapikthi pika-pika), *Dryocopus martius* (qukapikthi i zi), *Garrulus glandarius* (grifsha), *Parus caeruleus* (trishtili i kalter), *Parus ater* (trishtili i zi), *Troglodytes troglodytes* (trumcaku), *Luscinia megarhynchos* (bilbili i rendomte), *Erithacus rubecula* (gushëkuqi), *Carduelis carduelis* (gardalina), *Serinus canaria* (zog bari sqepshkurtë), *Aegithalos caudatus* (trishtili bishtgjatë) etj.

Gjitarët - *Erinaceus europaeus* (iriqi), *Talpa europaea* (urithi), *Lepus europeus* (lepuri i fushës), *Sciurus vulgaris* (ketra), *Muscardinus avellanarius* (gjeri i lajthive), *Spalax leucodon* (klyshi i verber). *Canis lupus* (ujku), *Canis vulpes* (dhelpra), *Felis silvestris* (macja e egër), *Meles meles* (vjedulla), *Martes martes* (shqarthi i artë), *Mustela nivalis* (bukla e vogël), *Sus scrofa* (derri i egër), *Capreolus capreolus* (kaprolli) etj.

11.1.4. Gjendja

Edhe përkundër mirëmbajtjes së mirë të zonës rekreative nga organi menaxhues, në Peizazhin "Germia", janë evidentuar disa probleme rreth ruajtjes së vlerave natyrore. Mungesa e planit menaxhues, mos definimi i zonave në kuadër të peizazhit, tendenca e ndërtimit të "Parkut të Aventurave", në zonën më të pasur me biodiversitet, pyllëzimi me drunjtë jo adekuat për zonën, gjuetia ilegale, shqetësimi i faunës dhe florës, infrastruktura, turizmi i pa kontrolluar si dhe dëmtimet e vlerave natyrore janë ndër problemet kryesore të Peisazhit Gërmia. Dëmtime janë shkaktuar edhe në ekosistemet pyjore nga faktori antropogjen, si: prerja ilegale e pyjeve, zjarret, hedhja e mbeturinave, ndërtimet, organizimi i festivalit të muzikës "Sunny Hill Festival", etj.
Ndërsa nga faktori natyror janë vërejtur drunjtë e rrezuar nga kushtet atmosferike (era), paraqitja e krimbave dhe insekteve qe kanë ndikuar në dëmtimin e gjetheve të drunjtëve duke shkaktuar tharjen e pyjeve. Është shqetësues fakti se në bashkësitë pyjore të PM "Gërmisa" veçmas në ato të dushkut kemi dukurinë e tharjes së shumë drunjtëve nga veprimi i insekteve të caktuara si dëmtues të pyjeve. Prandaj shtrohet nevoja urgjente për një pastrim sanitar dhe dezinsektim të këtij masivi malor, veçmas zonës së mbrojtur.



Foto nr. 73. Dëmtimi i trungjeve nga insektet



Foto nr. 74. Ndërhyrjet në PM. "Gërmia"

11.1.5. Rekomandimet

1. Të hartohet Plani Menaxhues për Peizazhin e Mbrojtur "Gërmia";
2. Aplikimi i masave sanitare për sanimin e pyjeve të dëmtuara nga faktorët biotik dhe abiotik;
3. Vazhdimi i hulumtimeve me qëllim të inventarizimit të llojeve dhe habitateve;
4. Inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i MMPHI -së dhe Inspektorati Komunal;
5. Të ndalohen ndërtimet ilegale në Peizazhin e Mbrojtur "Germia";
6. Të rritet numri i stafit për menaxhimin e Peizazhit të Mbrojtur "Germia";
7. Të bëhet shenjzimi i shtigjeve dhe i kufirit të jashtëm të Peizazhit të Mbrojtur "Germia";
8. Të gjitha aktivitete dhe ndërhyrjet në Peizazhin e Mbrojtur të jenë në harmoni me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse;
9. Organi menaxhues të organizoj aktivitete të vazhdueshme edukativo–arsimore në Peisazhin e Mbrojtur "Germia".

11.2. Peisazhi i Mbrojtur "Shkugëza"

Perizazhi i Mbrojtur "Shkugëza" gjendet në pjesën jugore të komunës së Gjakovës, në mes dy kodrave të ndara nga lumi i vogël Shlepica, në lartësi mbidetare prej 410-460 m. Zona është e pasur me vlera të biodiversitetit, vlerat turistike, rekrative dhe edukativo-arsimore. Në vitin 2011, kuvendi komunal i Gjakovës ka marrë vendim per shpalljen e "Shkugëse" Peizazhi i Mbrojtur, me sipërfaqe prej 70 hektar.

11.2.1. Flora dhe vegjetacioni

Në vitin 1960, zona e Shkugzës ishte pyllëzuar me Pishë të Zezë (*Pinus nigra*). Një vlerësim fillestar i shumëllojshmërisë bimore rezulton në rreth 280 lloje. Prej tyre mund të hasen: Aguliçja e zakonshme *(Prinula vulgaris),* Kuqla dhëmbëqeni *(Erythronium dens – canis),* Bishtpelëza e deleve *(Festuca ovina agg.),* Bartheku *(Bromus sterilis),* Bari mijëfletësh *(Achillea millefolium),* Tërfili. *(Trifolium sp),* Qumështorja *(Euphorbia cyparisias),*

Gjethe heshtorja *(Plantago lanceolata),* Lisra *(Thymus sp.),* Sarusha *(Stachys sp.),* Kamashna *(Hieracium pilosella),* Sumbullaria *(Humulus lupulus),* Kulpra e egër *(Clematis vitalja),* Arrsi dushk vogël *(Teucrium chamaedrys),* Hipokeri rrënjak *(Hypochoeris radicata), Flokëza e livadheve (Poa pratensis).*

Drunjtë dominues, në varësi të vendeve të veçanta, janë *Pinus nigra* (pisha e zezë), Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), Panja (*Acer campestre*), Frashëri (*Fraxinus ornus*), Lajthia (*Coryllus avellana*), Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*), Thana (*Cornus mas*), Qarri *(Quercus cerris),* Bungëbuta *(Quercus pubescens)* dhe Shpardhi (*Quercus frainetto*).





Foto nr. 75. Aguliçja e zakonshme *(Prinula vulgaris)* Foto nr.76. Auqla dhëmbëqeni *(Erythronium dens-canis)*

11.2.2. Fauna

Zona e Peizazhit të Mbrojtur "Shkugëza" është një habitat i rëndësishëm për lloje të ndryshme të Fluturave *(Lepidoptera),* Brumbullin e rrezikuar *(Lucanus cervus),* Hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*), Breshka e pyllit (*Testudo hermanni*) *Muscardinus avellanarius* (gjeri i lajthive), *Spalax leucodon* (klyshi i verber). *Canis lupus* (ujku), *Canis vulpes* (dhelpra), *Felis silvestris* (macja e eger), *Meles meles* (vjedulla), *Martes martes* (shqarthi i artë), *Mustela nivalis* (bukla e vogël), *Sus scrofa* (derri i egër), etj.

Biodiversiteti i shtratit të lumit Shlepica është i kufizuar për shkak të ndotjes. Janë regjistruar llojet si :Tritoni (*Triturus vulgaris*), Bretkoca barkverdhë (*Bombina variegata*), *Rana esculenta* agg., Gjarpri i ujërave (*Natrix natrix*) etj.

Nga llojet e zogjëve më të pranishmet janë: Qukapiku i gjelbër (*Picus viridis*), Bilbili (*Lyscinia meganchynchos)* etj.

11.2.3. Gjendja

Gjatë monitorimit të Peizazhit të Mbrojtur "Shkugëza" për periudhën 2018 - 2021 janë vërejtur zhvillimet e disa aktiviteteve ekonomike brenda zonës së mbrojtur si: ndërtimi i restoranteve si dhe objekteve përcjellëse të tyre: kënde lojërash dhe vendpakingje. Problem tjetër është edhe mosmenaxhimi i mbeturinave , rreziku nga zjarret, betonizimi i shtigjeve, shkarkimi i ujërave të zeza e aktivitete të pakontrolluara pikniku. Përveç këtyre, në zonën e peizazhit funksionon edhe autolarja e makinave me pajisjet përcjellëse, e cila ka ndikuar negativisht në vlerat e Peisazhit të Mbrojtur "Shkugza"

11.2.4. Rekomandimet

1. Të përgatitet Planit Menaxhues për Peizazhin e Mbrojtur "Shkugëza";
2. Të ndalohen ndërtimet ilegale e objekteve;
3. Të bëhet menaxhimi me i mirë i mbeturinave (të ndalohet rreptësisht djegia e tyre);
4. Të ndërpriten prerjet ilegale të pyjeve dhe të bëhet pastrimi sanitar i zonës,
5. Pasi që zona është shndërruar në qendër rekreative nga banoret, duhet të pajiset me infrastrukturë përkatëse sipas parimeve për mbrojtjen e natyrës;
6. Të bëhet shenjzimi i shtigjeve dhe i kufirit të jashtëm të Peizazhit të Mbrojtur "Shkugëza";
7. Të gjitha aktivitetet në peisazhin e "Shkugëses" të kanë karakter kulturor, edukativo-arsimore, turistik dhe rekreative dhe të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

11.2. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"

Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës" gjenden në fashatin Selac në komunën e Mitrovicës, në vendin e quajtur Llomovë. Këto pyje shtrihen në ngastrat 28, 29 dhe 30 sipas Planit menaxhues të pyjeve *2014/2024*, që në vete paraqesin pyje të ahut në pjesën më të madhe. Duke marrë parasysh vitalitetin, moshën dhe rendësin që kanë pyjet e ahut për mjedisin, kjo zonë ne vitin 2019 nga Kuvendi Komunal i Mitrovices është shpallur "Peizazh i Mbrojtur" me sipërfaqe prej 93 ha.





Foto nr. 77. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës", Harta nr. 7. Peizazhi i Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"

Në këto masive pyjore gjenden edhe shumë burime ujore si dhe lloje të ndryshme të ekosistemeve alpine dhe sub-alpine[23]. Vlerat e trashëgimisë natyrore të peizazhit konsiderohen edhe me rëndësi gjeomorfologjie për nga shtrirja dhe forma.
Peizazhi i mbrojtur "Ahishtat e Llomovës" është i pasur në aspektin floristik dhe vegjetativ si: Lulekambana *(campanula glomerata),* Lulekambana gjethepjeshkë *(campanula persicifolia),* Liri i verdhë *(linum flavum),* Karafili armeria *(dianthus armeria)* etj.

[23] Propozimi për shpallje të zonës së mbrojtur, nr. 3530, datë: 17.10.2016, MBPZHR

Llojet e vegjetacionit pyjor kanë vlerë natyrore dhe shkencore dhe përbëhen nga llojet e Ahut *(Fagus sylvatica),* që mbulon sipërfaqen më të madhe, kurse në pjesën lindore të tyre gjendet një sipërfaqe autoktone me pyje të Hartinës *(Pinus sylvestris),* etj.



Foto nr. 78. Lulekambana *(campanula glomerata)*



Foto nr. 79. Liri i verdhë *(linum flavum)*

Peizazhi paraqet habitat të kafshëve të egra si: Ujku *(Canis lupulis),* Kaprolli *(Capreolus capreolus),* Dhelpra *(Canis vulpes),* Lepuri i fushave *(Lepus europenas),* Derrri i egër *(Sus scrofa),* Ariu i murm *(Ursus arctosa),* Vjedulla *(Meles meles),* Macja e egër *(Feslis sylvestris),* ndërsa shpezët përfaqësohen nga: Petriti i pulave *(Accepiter gentilis),* Shqiponja e maleve *(Aquilla chrysaetos),* Thëllëza e gurëve *(Alectoris graeca),* Fajkoi *(Falco naummani),* Pula e madhe e egër *(Tetrao orogallus),* Thëllëza e fushave *(Perdix perdix),* Sokoli *(Accipiter gentilis)* etj.

11.3.1. Gjendja

Gjatë vizitës monitoruese për periudhën kohore 2018 - 2021, janë konstatuar se faktorit njeri me aktivitetet e tij është duke shkaktuar një varg veprimesh negative në peizazh, siç janë prerja e trungjeve për përfitime ekonomike, hedhja e mbeturinave, zjarret etj. Këto ndikime po shkaktojnë degradimin e drejtpërdrejtë të vegjetacionit e pyjeve të ahut duke rrezikuar njëkohësisht llojet e shumta të habitateve natyrore. Degradimet e pyjeve janë bërë edhe nga faktorët natyror (si ortekut i borës gjatë dimrit në periudha të më hershme). Veprimet e tilla po rrezikojnë ekzistencën e llojeve të ndryshme të florës dhe faunës të cilat i kanë habitatet e tyre brenda peizazhit. Dukuritë e tilla reflektojnë negativisht edhe në vlerat turistike që i ofron peizazhi. Eko-turizmi në këtë zonë, ju ofron vizitorëve udhëtimin në vende të pa prekura dhe të veçanta siç janë pyjet e vjetra dhe të rralla të Ahut *(Fagus sylevstris)* dhe Hartinë *(Pinus sylvestris).* Prandaj, ruajtja e këtyre vlerave do të japë kontribut të veçantë në minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.



Foto nr. 80. Prerja e trungjeve të ahut në Peizazhin e Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës"

11.3.2. Rekomandimet

1. Të themelohet organi menaxhues nga Komuna e Mitrovicës;
2. Të hartohet plani menaxhues për Peizazhim e Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës";
3. Vazhdimi i hulumtimeve me qellim të inventarizimit të llojeve dhe habitateve;
4. Të bëhet shenjzimi i shtigjeve dhe i kufirit të jashtëm të peizazhit të Mbrojtur "Ahishtat e Llomovës";
5. Të ndërpritet prerja e pyjeve dhe të bëhet pastrimi sanitar i zonës;
6. Aplikimi i masave sanitare për sanimin e pyjeve të dëmtuara nga faktorët biotik dhe abiotik;
7. Inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i Komunës se Mitrovicës;
8. Të gjitha aktivitetet në zonën e mbrojtur të kanë karakter edukativo arsimore, turistikë dhe rekreative etj.
9. Të ndalohet prerja ilegale e pyjeve dhe hedhja e mbeturimave

11.3. Perizazhi i Mbrojtur "Lugina e Lumit Llapushnik"

Perizazhi i Mbrojtur "Lugina e lumit Llapushnik" gjendet në bjeshkët e fshatit Pogragjë, në komunën e Gjilanit. Në vitin 2020 është marrë nën mbrojtje si kategori e peisazhit nga Kuvendi i Komunës se Gjilanit, me sipërfaqje prej 76 ha.

Llojet e vegjetacionit pyjor dhe barishtor të cilat gjenden në këtë zonë kanë vlera natyrore dhe shkencore dhe si të tilla i japin pamje shumë të bukur kësaj pjese. Në kuadër të vegjetacionit pyjor, janë prezente këto lloje: Krekza *(Acer campestre)*, Shkoza e bardhë *(Carpinus betullus)*, Thana *(Cornus mas)*, Murizi *(Crataegus monogyna)*, Bagremi *(Akacia)* etj. Prej faunës janë llojet: Ujku *(Canis lupus)*, Dhelpra *(Ursus arctos)*, Derri i egër *(Sus scrofa)*, macja e egër (*Felis silvestris*), vjedulla (*Meles meles*), shqarthi i artë (*Martes martes*), qyqja (*Cuculus canorus*), qukapikthi pika -pika, (*Dendrocopos major*), qukapikthi i zi (*Dryocopus martius*) etj.



Foto nr. 81. Peizazhi i Mbrojtur “Lugina e lumit Llapushnik”

11.4.1. Rekomandimet

1. Të themelohet organi menaxhues nga Komuna e Gjilanit;
2. Të hartohet Plani Menaxhues për Peizazhim e Mbrojtur “Lugina e lumit Llapushnik”;
3. Vazhdimi i hulumtimeve me qellim të inventarizimit të llojeve dhe habitateve;
4. Të bëhet shenjëzimi i Peizazhit të Mbrojtur “Lugina e lumit Llapushnik”;
5. Të ndalohet prerja ilegale e pyjeve dhe hedhja e mbeturimave .

XII. ZONAT TJERA TË MBROJTURA

12.1. Vend gjuetitë me rëndësi të veçantë

Aktivitetet e Agjencisë Pyjore të Kosovës, përkatësisht Drejtorisë për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko-Turizëm në VGJRV zhvillohen duke u bazuar në Strategjinë nacionale të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe gjuetisë në Kosovë (2013 - 2023), si dokument bazik për ruajtjen e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtjen adekuate të kafshëve të egra, sigurimi e mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të tyre, Ligjit për Gjueti Nr.02/L-L53 dhe akte tjera nën ligjore që plotësojnë këtë ligj.

Edhe gjatë periudhës 2018-2021 fokusimi në menaxhimin e qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe gjuetisë ka qenë në VGJRV “Blinaja” dhe “Duboçaku”, me theks të veçantë në:

- Ruajtjen e habitatit;
- Arritjen e numrit optimal për të gjitha kafshët e gjuetisë;
- Mbajtjen e strukturës optimale të popullacionit sipas gjinisë dhe moshës;
- Gjendjen e mirë shëndetësore të kafshëve për gjueti;
- Mbrojtjen dhe ruajtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara;
- Arritjen e objektivave të planifikuar në menaxhimin e vend-gjuetisë në harmoni me programin e menaxhimit dhe zhvillimit, si dhe planin afatgjatë dhjetë vjeçar.

12.1.1. Vend gjuetia e rëndësisë së veçantë “Blinaja”

Shtrihet në tri Komuna, atë të Lipjanit, Drenasit dhe Shtimës dhe ka një sipërfaqe prej 2795 ha. Kjo vendgjueti është e tipit të mbyllur dhe shtrihet në një lartësi mbidetare nga 650-850 m, dhe posedon 40 ha livadhe, 32 liqej artificial, 88 vëzhgimore për vëzhgim dhe monitorim, 12 kurtha për zënien e derrave. Kurse zona ushqyese për kafshë të mëdha posedon 150 vende ushqimi, 26 tarraca nga betoni për derra, 2 për riprodhim, 32 zona për ujë, 15 vende për marrjen e kripës, zonë trajnimi për qenët e gjuetisë etj. Në total janë 2100 ha pyje shtetërore si dhe 600 ha pyje private, pjesa tjetër prej 90 ha është sipërfaqe bujqësore (livadhe) dhe diku rreth 5 ha sipërfaqe ujore.
Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe funksionalitet edhe në këto tri vitet e fundit janë bërë investime shtesë të konsiderueshme për renovimin dhe rivitalizimin e infrastrukturës, si: rregullimin e rrugëve pyjore, renovimin e rrethojës së jashtme, renovimin e objektit të Gjuetisë dhe atij për trajnime, renovimin e objekteve ndihmës (depo e ushqimit plotësues për kafshë të egra, depon e mjeteve dhe pajisjeve bujqësore, objektin -mini thertore për trajtimin e kafshëve të egra pas gjuajtjes dhe marrjen e mostrave për analiza), sigurimi i ushqimit për kafshët e egra gjatë sezonit dimëror, ngritjen e koritave për ushqim dhe kriporeve etj. Gjendja e këtij habitati është i mirë, falë angazhimit dhe përkushtimit në vazhdimësi të stafit me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes, kultivimit dhe kujdesit për sigurimin e ushqimit për kafshët e egra.

Llojet kryesore që kultivohen të faunës së egër në Blinajë janë: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dreri i kuq (*Cervus elaphus*), Dreri i murrm (*Dama dama*), Derri i egër (Sus scrofa),
Përveç këtyre llojeve në Blinajë janë prezentë edhe Vjedulla (*Meles meles*), Shqarthi i ahut (*Martes sp.)*, Shqarthi i pishës evropiane (*Martes sp.)*, Lepuri (*Lepus europeus*), Korbi (*Corvus corax*), Laraska (*Pica pica*), Shqiponja minj ngrënëse (*Buteo buteo*), Rosa e egër (*Anas querquerdula*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), etj.

Sipas Planit Menaxhues me pyje 2014-2023, në VGJRV në Blinajë volumi i masës drusore aktualë është 332325 m^3, me një rritje vjetore prej 2.93 %, përkatësisht 9737 m^3/vit.
VGJRV në Blinajë është nën menaxhim të APK-së dhe nuk ka veprime ilegale përkundër tentimeve të herë pas hershme për gjueti ilegale, të cilat parandalohen me kohë nga stafi për mbrojtje të pyjeve dhe gjahut i mbështetur në raste të caktuara edhe nga Policia.





Foto nr. 82, 83 dhe 84. Fauna në VGJRV “Blinaja” (Foto: A. Mavriqi, A. Llapashtica, L. Demaj 2021)

12.1.2. Vend gjuetia me rëndësi të veçantë "Duboçaku"

Sipërfaqja e kësaj vendgjuetie shtrihet në tri Komuna, atë të Skenderajt, Zubin Potokut dhe Mitrovicës me një sipërfaqe prej 6805.05 ha, ku prej tyre 2470 ha janë pronë shtetërore kurse pjesa tjetër pronë private dhe është gjueti e tipit të hapur.
Sipas Planit Menaxhues, Vend Gjuetia me Rëndësi të Veçantë "Duboçaku" 2011-2021, ka një vëllim të masës drusore prej 46954.40 m^3, me një rritje vjetore 2.2% përkatësisht në sasi prej 1693.00 m^3 dhe shtrihet në lartësi mbidetare prej 320 m deri në 1050 m. Kushtet hidrologjike janë të volitshme pasi që është e pasur me shumë përrenj dhe burime uji të cilët janë të përhapur në tërë sipërfaqen e vend gjuetisë dhe nuk shterojnë gjatë tërë vitit, që d.m.th se problemi i furnizimit me ujë për nevoja të faunës së egër nuk ekziston.

Nuk është bërë ndonjë inventarizim i numrit kafshëve të egra prezent, por bazuar në incizimet që janë bërë me kamera kurth dhe gjurmëve të tyre dihet se ekzistojnë lloje të ndryshme të tyre si Ariu i murrmë (*Ursus aretos*), Ujku (*Canis lupus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dreri i kuq (*Cervus elaphus*), Lepuri *(Lepus europeus*), Ketri (*Sciurus vulgaris*) etj.
Gjatë këtyre tri viteve janë bërë investime infrastrukturore si në: renovimin e objektit dhe zyrave, sigurimin e ushqimit shtesë gjatë sezonës dimërore (misër dhe kripë guri), rregullimi e koritave për ushqim shtesë dhe kriporeve, etj.
Në këtë vendgjueti ka tendenca për veprime ilegale të prerjes së pyjeve dhe gjahut ilegal, me një trend në rënie dy vitet e fundit falë angazhimit të stafit të VGJRV në Duboçak. Mirëpo problem në vete paraqet qasja e kufizuar në sipërfaqet që shtrihen në Komunën e Zubin Potokut. Në këtë vendgjueti gjatë kësaj periudhe është shtrirë rrjeti i furnizimit me energji elektrike si dhe nga pjesa e Komunës së Zubin Potokut është rinovuar rruga e cila shpien në afërsi gati deri tek objekti i VGJRV, në Duboçak.

12.1.3. Vend gjuetitë e përbashkëta

Bazuar në Ligjin nr.02/L53 për gjueti dhe objektivave të Strategjisë nacionale për menaxhim të qëndrueshëm të kafshëve të egra 2014-2023, gjatë kësaj periudhe nga komunat janë themeluar 33 vendgjueti të përbashkëta në sipërfaqe të përgjithshme prej 598686.01 / ha , prej të cilave (për mes të ankandit publik) janë dhënë në menaxhim 19 vendgjueti të përbashkëta (Gjilan 3, Dardanë 1, Shtime1, Hani i Elezit 1, Kaçanik 1, Mitrovicë 1, Vushtrri 2, Therandë 1, Malishevë 1, Lipjan 2, Kastriot 1, Fushë Kosovë 1, Graçanicë 1, Besianë 1 dhe Deçan 1) me një sipërfaqe të përgjithshme prej 375861.34 ha , kurse vlera e kontratave të lidhura mes komunave dhe operatorëve menaxhues të VGJP është 313 146.96 €.




Foto nr. 85 dhe 86. Fauna në VGJRP “ në Komunën e Therandës (2021)

12.1.4. Rekomandimet

1. Nxjerrja e një Rregulloreje (UA apo çmimorje) për menaxhimin e VGJRV në Blinajë për inkasimin e të hyrave nga shërbimet e ofruara;
2. Vazhdimi i riparimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve pyjore;
3. Pajisja me makineri adekuate për mirëmbajtjen e shtigjeve pyjore;
4. Hapjen e kanaleve kulluese të ujit dhe rrjedhës së ujit tepricë nga liqenet;
5. Të bëhet ndërtimi i ri i rrethojës së jashtme të VGJRV në Blinajë (e vjetra ka pësuar dëmtime serioze gjatë luftës së fundit dhe është amortizuar në shkallë të lartë),
6. Kompletimi me eksponate i muzeut të gjuetisë, ndërtimi i një makete relievore me të gjitha informatat e terrenit dhe vendosja e shenjave orientuese për shtigjet - rrugët e Blinajës dhe Duboçakut dhe hartat orientuese për vizitorë;
7. Parandalimi i gjuetisë ilegale dhe prerjeve ilegale të pyjeve nëpër vend gjueti,
8. Ngritje e nivelit të përgjegjësive ligjor dhe bashkëpunimi ndërinstitucional (MBPZHR-DP, APK, MMPHI, Komunat, Gjykatat, OJQ, dhe palë të tjera të interesit, me qëllim të implementimit të strategjisë nacionale të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe gjuetisë;
9. Funksionalizimi i sistemit të monitorimit, informimit dhe raportimit - SIPK (KFIS);
10. Arsimimi, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale;
11. Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi me media dhe nxjerrja e broshurave, fletushkave dhe posterëve mbi rëndësinë faunës së egër;
12. Inventarizimi nacional i kafshëve të egra;
13. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar (shkëmbimi i përvojave),
14. Vazhdimi i hulumtimit të vlerave të biodiversitetit në vendgjuetin e “Blinaja” dhe Duboçak

12.2. Natyra 2000

Rrjeti ekologjik Natyra 2000 është rrjeti më i madh i koordinuar i zonave të mbrojtura të BE-së. Ai mbulon më tepër se 18 % të tokës dhe më shumë se 8 % të territorit detar të BE-së.
Ky rrjet i zonave për ruajtjen dhe mbarështimin e llojeve të rralla dhe të rrezikuara, shtrihet për gjatë të gjitha vendeve të BE-së, me pretendim të shtrirjes edhe në vendet kandidate.
Rrjeti Natyra 2000 është themeluar në vitin 1992, me miratimin e Direktivës së BE-së për vendbanimet natyrore, që mbron botën e egër dhe vendbanimet natyrore në Evropë. Ndërsa Direktiva e BE-së për Zogjtë e Egër u miratua në vitin 1979 me qëllimin që të mbrohen llojet e egra të zogjëve dhe vendbanimet e tyre më të rëndësishme në Bashkimin Evropian.
Pas një pune të konsiderueshme të institucioneve dhe shkencëtarëve të ndryshëm, vendet kandidate përgatisin listat e zonave të propozuara me qëllim që të bëhen pjesë e Natyra 2000. Pasi që vendi të bëhet anëtare e BE-së, ato miratohen nga Komisioni Evropian dhe bëhen pjesë zyrtare e rrjetit të Natyra 2000. Synimet e rrjetit ekologjik Natyra 2000 është sigurimi afatgjatë i mbijetesës së llojeve dhe vendbanimeve të rralla dhe të rrezikuara në Evropë.
Natyra 2000 nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e natyrës, por bazohet edhe në një parim shumë më të gjërë të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm, ku njerëzit dhe bota e gjallë mund të bashkëjetojnë në harmoni.
Qëllimi kryesor i krijimit të rrjetit Natyra 2000 është që zonat të menaxhohen në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike edhe ekologjike, në këtë mënyrë duke e përmirësuar mbrojtjen dhe ruajtjen e llojeve dhe vendbanimeve.
Natyra 2000[24] është shtylla kryesore e Infrastrukturës së gjelbër Evropiane, e cila siguron shërbime të ekosistemit (ushqim, lëndë të parë, ajër dhe ujë i pastër) si dhe sigurimin e zhvillimit të tashëm dhe të ardhshëm.



Figura nr. 3. Natyra 2000

[24] https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

Procesi i krijimit të Rrjetit Natyra 2000 në Kosovë është në fazën fillestare, megjithatë një kornizë ligjore dhe politikat të cilat mbështesin themelimin e rrjetit ekologjik Natyra 2000 është e krijuar. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020 ka identifikuar nevojën për një inventarizim të zonave të mbrojtura në pajtim me kërkesat e Natyra 2000.
Me qëllim të implementimit të rrjetit ekologjik Natyra 2000, gjatë periudhës 2018-2021 janë ndërmarrë këto veprime:

- Inventarizimi i florës dhe faunës është bërë në vazhdimësi nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. (një aktivitet që është realizuar gjatë kësaj periudhe e që ia vlen të ceket është publikimi i Librit të Kuq të Faunës).
- Krijimi i hartave me të dhënat për vendbanimet natyrore të flores dhe faunës (është zhvilluar projekti "Inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazëve, tipat e vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre").
- Identifikimi i të gjitha zonave të rëndësishme dhe sigurimi i fondeve për realizimin e Natyra 2000 - aktualisht një fishe veprimi është përgatitur me emërtimin "Fuqizimi i kapaciteteve për zbatimin e acquisit në fushën e mbrojtjes së natyrës – Natyra 2000" i cili është përfshirë në listën e propozimeve potenciale preliminare për IPA III (2023-2024).

12.2.1. Rekomandimet

1. Identifikimi i të gjitha zonave potenciale për Natyre 2000 në Kosovë;
2. Inventarizimi i llojeve dhe i habitateve;
3. Sigurimi fondeve dhe i projekteve për identifikimin e zonave të Natyrës 2000;
4. Aplikimi në programet e IPA dhe BE për realizimin e Natyra 2000 në të ardhmen;
5. Bashkëpunim me vendet e regjionit qe e kanë realizuar Rrjeti Ekologjik Natyra 2000.

12.3. Pylli i Arinjve Prishtina

Gjendet në fshatin Marmor, 20 km larg Prishtinës dhe është hapur në vitin 2013, me mbështetje të organizatës FOUR PAWS nga Austria.
Toka në sipërfaqe prej 16 ha është dhënë në shfrytëzim nga komuna e Prishtinës për 99 vite.
Aktualisht në Pyllin e Arinjve Prishtinë jetojnë 20 arinjë, 17 prej tyre të shpëtuar në Kosovë dhe 3 të sjellur nga Shqipëria.
Falë kujdesit shëndetësor, sipërfaqes në dispozicion dhe programit të të ushqyerit, të gjithë arinjtë gëzojnë një shëndet të mirë. Që nga arritja e tyre në strehimore, gjendja e tyre është përmirësuar vazhdimishtë, ata tani shfaqin shumë më pak sjellje jo normale, të shkaktuara nga jeta e gjatë në robëri dhe të gjithë janë këthyer pothuaj plotësisht në instinktet e tyre natyrore, siç janë hapja e shpellave dhe procesi i letargjisë.

12.3.1. Gjendja

Në vitin 2018, me mbështetje dhe financim të organizatës FOUR PAWS, në Pyllin e Arinjve Prishtinë është ndërtuar Qendra per Edukim Mjedisor "Thesaret e Natyrës". Kjo qendër synimin kryesor ka ofrimin e një programi unik edukativ mjedisor. Ky program zbatohet në bashkëpunim me shkolla, kopshte dhe vizitorë të cilat me grupe të fëmijëve e nxënësve zhvillojnë orë mjedisore të cilat lidhen me mbrojtjen dhe mirëqenën e kafshëve dhe me problematikat tjera mjedisore. Brenda qendrës dhe jashtë saj, në vazhdimësi zhvillohen aktivitete të ndryshme edukative me fëmijë:



Foto nr. 87, 88 dhe 89. Pjesëmarrja e nxënësve në programin edukativ "Gjuetia për thesar"

Gjatë periudhe 2018 - 2021 numri i vizitorëve ka ndryshuar gjatë viteve, si rezultat i pandemisë (Covit 19).

Tabela nr.8 Numri i vizitorëve sipas viteve 2018 - 2021

Viti	2018	2019	2020	2021
Numri i vizitorëve	40,553	44,086	19,679	36,620

Burimi: Pylli i Arinjve Prishtina

12.3.2. Projektet e gjelbërta:

Në kuadër të Pyllit të Arinjve Prishtinë, në periudhën 2018-2021 janë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillohen edhe më tutje shumë projekte të gjelbërta të cilat për qëllim kanë ruajtjen e mjedisit dhe edukimin mjedisor tek vizitorët dhe fëmijët për ruajten e mjedisit. Këto projekte janë të fokusuara kryesisht në këto fusha: riciklim, kompostim, energji të ripërtritshme (43 kW panele solare), elektro bus për bartje të vizitorëve nga rruga kryesore deri te Pylli i Arinjve Prishtinë.



Foto nr. 90, 91 dhe 92. Projektet e gjelbërta

12.3.3. Rekomandimet

1. Pas trajtimit dhe rehabilitimit të arinjve të vegjël (të marrë nga internimi) të kthehen të lire në natyrë;
2. Pyllëzimi i hapësirave te Pylli i Arinjëve Prishtinë të bëhet me llojet e drunjve autokton;
3. Të realizohen fushat edukative në shkolla për mbrojtjen e shtazëve të egra;
4. Të realizohen aktivitet të përbashkëta me institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare për mbrojtje dhe promovimin e vlerave natyrës;
5. Të raportohet çdo vit në MMPHI për gjendjen e arinjve.

XIII. BIODIVERSITETI

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore, dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshinë diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve”[25].

Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur në aspektin biologjik dhe peizazhor.

Kosova edhe pse është një shtet me sipërfaqe të vogël (10.908 km^2) është mjaftë e pasur në aspektin e shumëllojshmërisë bimore dhe shtazore. Florën e Kosovës e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat. Edhe pse janë bërë hulumtime të florës, vegjetacionit dhe faunës të Kosovës nga autor vendore dhe ndërkombëtarë ende nuk është bërë një inventarizim i tërësishëm dhe nuk dihet numri i saktë i llojeve bimore dhe shtazore në Kosovë. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet së në Kosovë janë prezent afro 2800 - 3000 lloje të florës vaskulare.[26]



Foto nr. 93. Lule Bozhure (*Paeonia peregrina decora)*

13.1. Flora dhe vegjetacionit

Flora e vendit tonë është e begatshme me prani të llojeve bimore të rralla dhe endemike, të formave barishtore, shkurre dhe drunore. Bimët ednemike të Kosovës janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht me shtrirje të vogël hapësinore dhe shpesh janë në numër të

[25] Konventa e Biodiversitetit
[26] Libri i kuq i florës vaskulare te republikës se Kosovës

pakt llojesh. Përveç formave të lartpërmendura, ekzistojnë edhe llojet bimore mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra. Rajonet me të pasura me bimë mjekuese-aromatike dhe pemë frutore të egra janë: Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare të Kosovës, Pashtriku [1]etj.



Foto nr. 94. Tulepani Shqiptar (*Tulipa albanica*) foto XH. Mala

Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në: 139 asociacione apo fitocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa.



Foto nr. 95. Iriqza perhereblertë (*Saxifraga sempervivum)*



Foto nr. 96. Burgulli i Maqedonisë (*Sempervivum macedonicum)*

[1] Inventari bimët mjekësore aromatike dhe pemët frutore të egra, përgatitur nga Prof. Dr. Fadil Millaku

Numri i taksoneve të përfshira në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës sipas Raunkierit janë paraqitur në figurën nr 4,e cila paraqet se dominojnë Hemikriptofitet me 155 taksone, pastaj Gjeofitet me 32 dhe Kamefitet me 27. Në numër më të vogël janë Fanerofitet me 19 taksone dhe më së paku Terofitet me vetëm 4 taksone.

Figura nr. 4. Format jetësore të taksoneve sipas Raunkierit



Burimi: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

Nga 237 taksonet e punuara në Librin e Kuq, Fierorë janë 3 lloje, Farëzhveshura 4 lloje, Dikotile 210 taksone dhe Monokotile 20 taksone.

Figura nr. 5. Numri i taksoneve



Burimi: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

13.1.1. Statuti i llojeve te vlerësuara

Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës janë punuar gjithsejtë 237 taksone, nga të cilat në bazë të kritereve të IUCN-së (Bazuar në "Udhëzuesin për shfrytëzimin e Kategorive dhe Kritereve të Listës së Kuqe të IUCN'së" Versioni 8.1 (Gusht 2010) janë vlerësuar dhe kategorizuar si vijon: I Zhdukur (EX) 1 lloj, I zhdukur si gjendje spontane ose të egër (EW) 1 lloj, I rrezikuar në mënyrë Kritike (CR) 61 taksone, I Rrezikuar (EN) 86 taksone, I Përkeqësuar (VU) 19 taksone, Gati i Rrezikuar (NT) 34 taksone dhe Më pak i rrezikuar (LC) 35 taksone (Tab. 2), përderisa në kategoritë Të Dhëna të pamjaftueshme (DD) dhe Jo i Vlerësuar (NE) nuk kemi vënë asnjë takson. Figura nr. 6 paraqet numrin e taksoneve bimore të përfshira në Librin e Kuq e që ju takojnë kategorive të ndryshme të kërcënueshmërisë.

Figura nr. 6. Numri i llojeve bimore sipas kategorive të kërcënueshëmrisë



Burimi: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

Prej 237 taksoneve bimore të vlerësuara në përputhje me kriteret e Listës së Kuqe të IUCN'së, në kategorinë i Zhdukur (EX) janë 0.4 % (1 lloj), I Zhdukur si gjendje spontane apo të egër (EW) janë po ashtu 0.4 % (1 lloj), të Rrezikuara në mënyrë kritike 26 % (61 lloje), të Rrezikuara (EN) 36 % (86 taksone), të Përkeqësuara (VU) 8 % (19 taksone), Gati të Rrezikuara 18 % (34 taksone) dhe më Pak i Rrezikuar 16 % (35 taksone).

Tabela nr. 9. Numri i specieve bimore sipas kategorive të Listës së Kuqe të IUCN -së.

Kategoritë e Listës së Kuqe të IUCN'së	**Numri i specieve**	**Numri i specieve endemike të Ballkanit**	**Numri i specieve të përfshira në Librin e Kuq të Botës**	**Numri i specieve të përfshira në Librin e Kuq të Evropës**
I zhdukur (EX)	1	/	/	/

I zhdukur si gjendje spontane ose në të egër (EW)	1	/	/	/
I rrezikuar në mënyrë Kritike (CR)	61	32	3	6
I Rrezikuar (EN)	86	45	9	6
I Përkeqësuar (VU)	19	11	3	3
Gati i Rrezikuar (NT)	34	23	5	1
Më Pak i Rrezikuar (LC)	35	21	4	1
Numri i përgjithshëm i specieve	237	132	24	17

Burimi: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

13.1.2. Kërpudhat

Hulumtimi i fundit sjell të dhëna të detajuara në identifikimin e llojeve të kërpudhave nga pyjet gjetherënëse (pyjet e dushkut). Kërpudhat e identifikuara i përkasin vetëm dy grupeve themelore taksonomike Ascomycota dhe *Basidiomycota*, në pyjet e dushkut, pasi këto pyje mbulojnë pjesën më të madhe të vendit. Gjithsej deri me tani janë identifikuara 220 takson kërpudhash (219 lloje dhe një formë) të shpërndara në pyjet e dushkut në Kosovë, nga të cilat 14 lloje i përkasin divizionit *Ascomycota* dhe 206 lloje divizionit *Basidiomycota.* Gjithsej 166 lloje kërpudhash raportohen për herë të parë në Kosovë, pasi disa nga speciet ishin më parë të njohura në territorin e Kosovës. Nga 220 lloje të kërpudhave të identifikuara vetëm në pyjet e dushkut, divizioni me më shumë lloje është *Basidiomycota*, me 206 lloje (specie), 120 gjini të klasifikuara në 56 familje dhe divizioni Asomycota me 14 lloje, 13 gjini të klasifikuara në 10 familje.[27]

[27] Qendrim Ramshaj, Katarina Rusevska, Slavica Tofilovska, Mitko Karadelev (2021) , Checklist of macrofungi from oak forests in the Republic of Kosovo, Czech Mycology 73(1): 21- 42, Febuary 12, 2021 (Online Version, Issn 1805-1421).

Figura nr. 7. Grupet themelore taksonomike të kërpudhave në Kosovë



13.2. Fauna

Kosova hynë në radhën e vendeve me faunë më të pasur dhe me heterogjene të Gadishullit Ballkanik. Kjo pasuri faunistike është rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, euro-siberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe i ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike nga e kaluara.

Në vendin tonë mund të gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve e që janë mjaftë të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjërë. Disa prej tyre janë relikte e të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat e konventave ndërkombëtare.

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe shënimeve të literaturës në Kosovë jetojnë mbi 300 lloje të egra të kurrizorëve, prej të cilave rreth 30 lloje të peshqve, 10 lloje ujë tokësorë, 20 lloje rrëshqitës, mbi 220 lloje shpendë dhe rreth 40 lloje gjitarë.



Foto nr. 97. Gjeraqina këmbëshkurtër (*Accipiter brevipes*) foto A. K

Pyjet e larta dhe ekosistemet malore ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullatave të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj si: ariu i murrëm (*Ursus arctos*), rrëqebulli (*Lynx lynx*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtare, mjaft të rëndësishme për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Europës. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*) janë disa nga llojet më reprezentative të vendit, e të cilat kanë edhe status ndërkombëtar të mbrojtjes. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Evropiane), WR-RL (Lista e kuqe botërore).

Peshqit *(Pisces):* Lumenjtë e Kosovës i përkasin tri pellgjeve detare (Pellgut të Detit Adriatik, Detit Egje dhe atij të Detit të Zi), ku mund të ceket se vendi ynë ka një rëndësi të veçantë në përshkrimin e ihtiofaunës së Ballkanit. Zonat malore prehen nga përrenj të shumtë që sipas karakteristikës ihtiologjike, këto rrjedha i takojnë tipit të ujërave Salmonide, vendbanimi i të cilave përbëhet kryesisht nga populacioni i dy llojeve të troftës: troftës së përroit (*Salmo trutta m. fario L.* dhe *Salmo marmoratus C.*).

Ujëtokësorët *(Amphibia):* Në kuadër të ujëtokësorëve janë prezentë dy rende: *Ujëtokësorët me bisht (Urodela)* të përfaqësuara me një familje, 2 gjini dhe 6 lloje. Llojet më karakteristike të familjes Salamandridae janë: Picrraku *(Salamandra maculosa*), picrraku i zi (*Salamandra atra*), tritoni i zakonshëm (*Triturus vulgaris*).

Ujëtokësorët pa bisht *(Anura),* Në këtë rend bëjnë pjesë 5 familje dhe afërsisht me 7 lloje. Llojet më përfaqësuese të bretkosave janë: thithëlopa (*Bufo bufo*), thithëlopa e gjelbër (*Bufo viridis*), gargaliqi (*Hyla arborea*), bretkoca e pyllit e kuqërremët *(Rana temporaria*), bretkoca kërcimtare *(Rana dalmatina*), bretkoca e përrenjëve (*Rana graeca*) etj.

Rrëshqitësit *(Reptilia):* Nga grupi i Rrëshqitësve që gjenden tek ne përmendim 5 familje me 10 lloje. Dallohen breshkujza (*Emys orbicularis),* breshka tokësore (*Testudo graeca*), hardhuca e gjelber (*Lacerta viridis*), hardhuca e mureve *(Lacerta muralis*), hardhuca e përhimët *(Lacerta agilis*), gjarpri i madh i ujit *(Natrix natrix*), gjarpri i vogël i shiut *(Natrix tesselata),* nepërka *(Vipera ammodytes*), nepërka e malit (*Vipera berus*), kokëzogëza (*Anguis fragilis) etj*.



Foto nr. 98. Picrraku *(Salamandra salamandra)*



Foto nr. 99. Hardhuca e gjelbër (*Lacerta viridis*),

Shpendët *(Ornitofauna):-* Habitatet natyrore të vendit ofrojnë vendstrehim për shumë lloje të shpendëve, shumë prej tyre janë me status të pafavorshëm ruajtjeje në Ballkan dhe Europë. Deri më sot janë vërejtur mbi 220 lloje, por mendohet të ketë mbi 300 sosh. Numri më i madh i llojeve të shpendëve kanë shtrirje jashtëzakonisht të gjërë, ndërsa, një numër i vogël i tyre është i lidhur për lokalitete të ngushta. Lloje të rëndësishme të shpendëve janë: shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), fajkoi (*Falco naumanni*), gjeli i egër i madh (*Tetrao urogallus*), mbreti i shkurtes (*Crex crex*), thëllëza gurore (*Alectoris graeca*), etj.



Foto nr. 100. Thëllëza e malit-*Alectoris graeca*, (B.H)



Foto nr. 101. Zvarritesi krahekuq-T*ichodroma muraria* (B H)



Foto nr. 102. Lejleku i zi (*Ciconia nigra)* foto A. Mavriqi

Gjitarët (*Mammalofauna*), përfaqësohen gati me të gjitha llojet që jetojnë në Gadishullin Ballkanik. Grupi më i përfaqësuar i gjitarëve për nga numri i llojeve janë brejtësit. Klasën e gjitarëve e përbëjnë 3 lloje insektengrënës: iriqi (*Erinaceus europeus*), urithi (*Talpa europae*), rrëmihësi i rëndomtë (*Sorex araneus*), 19 lloje brejtës: lepuri i fushës *(Lepus europaeus*),

miu bizam (*Ondatra zibethica*), miu i fushës (*Arvicola terrestris*), miu i shtëpisë (*Mus musculus*), miu me vija *(Apodemus agrarius*), miu i pyllit (*Apodemus silvaticus*), gjeri i madh (*Glis glis*) etj, 11 lloje mishngrënës: Rrëqebulli *(Lynx lynx*), ariu i murrëm (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus),* dhelpra *(Canis vulpes*), macja e egër *(Felis silvestris*) etj, 1 lloj jopërtypës: derri i egër *(Sus scrofa*) dhe 3 lloje ripërtypës: kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra) etj*. Lakuriqët (*Chiroptera*) janë shumë pak të studiuar andaj nuk dihet numri i tyre.



Foto nr. 103. Aariu i murrëm (*Ursus arctos*),



Foto nr. 104. Kaprolli (*Capreolus capreolus*)



Foto nr. 105. Rrëqebulli Ballkanik *(Lynx lynx*), foto ERA

Një vlerësim më specifik për gjendjen dhe dendësinë e popullatave të llojeve të gjitarëve të egër në ekosistemet e pyjeve, përmes monitorimit me kamera kurth është bërë në kuadër të projektit: *Zhvillimi i metodës për matjen e shpërndarjes nacionale dhe densitetit të gjitarëve të egër duke përdorur kamerat kurth:* Rasti studimor për Kosovën.

Në tabelën nr. 10 janë prezantuar të dhënat për dendësinë mesatare të disa popullatave të gjitarëve të egër në Kosovë, bazuar në rezultatet e matjeve nga 10 pika monitoruese të projektit të lartpërmendur.

Tabela nr. 10. Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër[28]

Llojet	Densiteti /dendësia (individ / km)		Madhësia e popullatave pyjore	
	Mesatar	Shtrirja	Mesatar	Vargu
Dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*)	1.03	0.58-1.55	4935	2778-7433
Ujku i hirtë (*Canis lupus*)	0.08	0.04-0.12	374	202-584
Derri egër (*Sus scrofa*)	1.34	0.78-1.97	6469	3754-9460
Kaprolli (*Capreolus capreolus*)	3.19	1.90-5.00	15334	9126-24059
Vjedulla (*Meles meles*)	0.08	0.03-0.14	364	146-656
Lepuri i egër (*Lepus europeus*)	1.81	0.94-2.82	8728	4524-13572
Sqarthi (*Martes foina*)	0.36	0.16-0.59	1720	789-2831
Macja e egër (*Felis sylvestris*)	0.08	0.03-0.13	381	152-648
Ariu i murrëm (*Ursus arctos*)	0.25	0.12-0.41	1190	596-1966

13.2.1. Libri i Kuq i Faunës

Në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës (PMK) financuar nga Qeveria Suedeze - SIDA, është realizuar projekti (komponenta e dytë) " Inventarizimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës". Realizimi i këtij projekti ka rëndësi të madhe, pasi që për herë të parë është bërë inventarizimi i faunës në Kosovë, në bazë të të cilit do të hartohen politikat dhe strategjitë për mbrojtjen dhe konservimin e faunës në Kosovë.

Tabela nr. 11. Shpërndarja e llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës sipas IUCN

Grupet	Skajshmërisht i Rrezikuar CR	I Rrezikuar EN	I Cenuar VU	Gati i Kërcënuar NT	Shqetësim më i Vogël LC	Të Dhëna të Pamjaftueshme DD	Totali
Gastropoda			10	10			**20**
Bivalvia		1					**1**
Oligochaeta		1		2	2	7	**12**
Hirudinea						2	**2**
Arachnida					1	8	**9**
Araneae					1	7	**8**
Mesostigmata						1	**1**
Malacostraca			1			1	**2**
Diplopoda			3			6	**9**
Insecta	20	11	19	42	13	35	**140**
Ephemeroptera		4		4	2	2	**12**

[28] Developing methods for measuring national distributions and densities of wild mammals using camera traps: A Kosovo study; Sarah E. Beatham et al, 2020.

Plecoptera	5	1					**6**
Odonata				4	1	7	**12**
Coleoptera			3	2	4	17	**26**
Mecoptera						1	**1**
Diptera						2	**2**
Trichoptera	15	1	7	20	1	2	**46**
Lepidoptera		5	9	12	5	4	**35**
Cyclostomata				1			**1**
Actinopterygii	1	1	1	4	2	5	**14**
Amphibia		2	1		3	7	**13**
Reptilia			1	8	8	3	**20**
Aves	3	6	4	4		7	**24**
Mammalia	1	2	1	9	17	9	**39**
Totali	**25**	**24**	**41**	**80**	**46**	**90**	**306**

Burimi: Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës

Ne Librin e Kuq te Faunës te Republikës se Kosovës janë përfshire gjithsej 306 lloje, te cilat u takojnë këtyre grupeve te shtazëve: *Gastropoda, Bivalvia, Oligochaeta, Hirudinea, Arachnida (Araneae, Mesostigmata), Malacostraca, Diplopoda, Insecta (Ephemeroptera, Plecoptera, Odonata, Coleoptera, Mecoptera, Diptera, Trichoptera, Lepidoptera), Cyclostomata, Actinopterygii, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mammalia*.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës te Republikës se Kosovës i takon grupeve: Insektet (140 lloje), gjitaret (39), shpezët (24), zvarranikët (20) dhe guacat (20), kurse grupet e tjera janë te përfaqësuara me numër me të vogël të llojeve.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takojnë kategorive: të dhëna të pamjaftueshme (gjithsej 90) dhe gati i kërcënuar (gjithsej 80), kurse numri me i vogël i llojeve i takon kategorive: i rrezikuar (24) dhe skajshmërish i rrezikuar (25).

13.3. Gjendja

Aktivitetet e ndryshme siç janë: prerja ilegale e pyjeve, gjuetia ilegale, degradimi i habitateve, hapja e rrugëve të reja në zonat e mbrojtura, (Parkqet Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", MNRV "Ujëvarat e Mirushës" etj.,), zjarret, urbanizmi (ndërtimet ilegale në zonat e mbrojtura), dëgradimi i shtretërve të lumenjve, (realizimi i punimeve në shtratrin e lumenjve pa projekte konkrete), ndryshimet klimatike globale, etj., janë faktor që po ndikojnë direkt, që lloje të ndryshme bimore dhe shtazore të përballen më rrezik të zhdukjes. Habitate të rëndësishme janë duke u dëmtuar si rezultat i këtyre veprimeve, dhe ekosistemet po degradohen si pasojë e ndërhyrjes së faktorit njeri në dekadat e fundit. Si pasojë e prerjes së pyjeve pa kriter, sipërfaqe të mëdha të tyre dhe lloje të ndryshme bimore dhe shtazore, rrezikohen të humbin habitatin natyror. Si rezultat i kësaj, vjen në shprehje paraqitja e llojeve invazive të cilat shpesh arrijnë të ndryshojnë strukturën floristike të ekosistemeve autoktone.




Foto nr. 106 dhe 107. Dëmtimi i vegjetacionit në PK. “Bjeshket e Nemuna”



Foto nr. 108. Fragmentimi i habitateve në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Llojet mjekësore dhe aromatike janë të kërcënuara me zhdukje nga mbledhja e pakontrolluar e tyre. Sidomos është shqetësuese mbledhja e tyre në fazën e lulëzimit si dhe mbledhja e zhardhokëve dhe pjesëve të tjera reproduktive. Ky aktivitet ilegal për mbledhje e bimëve mjekësore, realizohet shpesh në zonën kufitare me Shqiperinë si dhe nga kompanitë dhe shoqatat qe merren me përpunimin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit,Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, gjatë vitit 2018 - 2021 ka vazhduar së realizuari aktivitetin e monitorimit të faunës së egër. Ky aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me zyrtarët e Parqeve Kombëtare dhe OJQ. Gjatë kësaj kohe është bërë vendosja e kamerave kurth, kryesisht në pjesët ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së kafshëve të egra.

Në vendet ku janë vendosur kamerat janë fotografuar dhe regjistruar llojet e ndryshme të gjitarëve si: Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Rrëqebulli *(Lynx lynx*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Ujku (*Canis lupus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes martes*), Baldosa (*Meles meles*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Lepuri (*Lepus europaeus*), Macja e egër (*Felis sylvestris*) etj. Të dhënat për praninë e llojeve të faunës së egër reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor në Kosovë, ku akoma ka mungesa thelbësore për një numër të madh të llojeve sa i përket të dhënave rreth popullatave, numrit të individëve, trendit të tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë.

Gjendja e përgjithshme e faunës është e përkeqësuar si pasojë e aktiviteteve ilegale që paraqitet në hapësirat e zonave të mbrojtura dhe në habitatet e tyre. Kërcënim kryesorë për faunën paraqesin: gjuetia ilegale, zhvillimi industrial, urbanizimi, peshkimi, deponitë ilegale, transporti dhe turizmi që është një dukuri në rritje në vitet e fundi edhe tek zonat e mbrojtura.

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë, dhitë e egra, rrëqebulli ballkanik, ariu, derri i egër, thëllëza e fushës, thëllëza gurore. Këto janë vetëm disa nga kafshët e egra që janë cak i gjahtarëve në Parqet Kombëtare dhe zonat tjera të mbrojtura.

Faktorë tjerë të humbjes së biodiversitetit janë edhe aktivitetet antropogjenë, si shpyllëzimet dhe shkretëtirëzimi i tokës së punueshme, shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, zjarret dhe hedhja e mbeturinave. Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve, ndryshimet në rrjedhën e ujit, ndërtimi i digave, tubacioneve, hidrocentralet, ndotjet e ndryshme, zjarret, etj., janë disa nga faktorët e degradimit dhe fragmentimit të habitateve dhe biodiversitetit në përgjithësi.

13.4. Konkluzionet

1. Nga monitorimi i faunës përmes kamerave – kurth, janë marrë informacione për praninë e disa llojeve të rralla të faunës në Kosovë;
2. Fauna është e kërcënuar nga gjueti ilegale, ndërtimet dhe nga degradimi dhe copëtimi i habitateve në zonat e mbrojtura;
3. Nuk dihet numri i saktë i llojeve bimore dhe shtazore në Kosovë;
4. Është përgatitur Libri i Kuq i Florës Vaskolare të Kosovës dhe Libri i Kuq i Faunës së Kosovës dhe është bërë vlerësimi i gjendjes së llojeve bimore dhe shtazore;
5. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi apo llojeve të caktuara në veçanti;
6. Kosova ka një biodiversitet shumë të pasur;
7. Mungesa e stafit në IKMN dhe në organet menaxhuese të zonave te mbrojtura për monitorimin e faunës;
8. Mungesa e fondeve për inventarizimin e plote te biodiversitetit etj.

13.5. Rekomandimet

1. Të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i Acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës.
2. Të vazhdohet me hulumtimin, evidentimin dhe monitorimin e vlerave të natyrës si dhe inventarizimin e llojeve bimore, shtazore dhe habitateve natyrore.
3. Të ndërmerren masa për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës sipas rekomandimeve dhe të gjeturave nga Libi i kuqë i florës dhe faunës së Kosovës.
4. Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore e shtazore.
5. Të bëhet një moratoriumi për ndalimin e gjuetisë në gjithë territorin e Kosovës për një periudhë të paktën 5 vjeçare.

6. Të fillohet me rehabilitimin e zonave të degraduara përmes aktiviteteve konservuese dhe restauruese (hartimit dhe zbatimit të planeve për llojet e veçanta dhe habitateve të tyre),
7. Mbrojtja e llojeve dhe habitateve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsyetimeve profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000.
8. Të përgaditet lista referente;
9. Organet për Administrimin e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektorati i MMPHI të monitorjonë dhe të parandalojnë aktivitetet ilegale, duke perfshirë edhe ato të gjuetisë.
10. Të sigurohen mjete financiare për inventarizimin e plotë të biodiversitetit.
11. Të ndërtohet muzeu i natyrës (ku do te prezantoheshin koleksionet e llojllojshmërisë së florës dhe florës).
12. Të themelohen organe menaxhuese për zonat e mbrojtura ku do te mbrohet biodiversiteti (flora dhe fauna) me rëndësi të veçantë.

XIV. HIDROCENTRALET NË ZONAT E MBROJTURA - RREZIK PËR BIODIVERSITETIN

Biodiversiteti është themelor për jetën në Tokë dhe për vetë mbijetesën e njeriut, ku përfshihen të gjitha llojet biologjike me përmbajtjen gjenetike të tyre, si dhe ekosistemet e ndryshme ku ato jetojnë dhe përmbushin funksionin normal të sistemeve natyrore dhe të vetë jetës. Me trendin aktual të zhvillimit ekonomik, biodiversiteti po kërcënohet seriozisht. Në këtë rast duhet përmendur edhe faktin se shumë nga këto lloje dhe habitate të cilat do të jenë pjesë e direktivave dhe konventave do të atakohen nga ndërtimet e hidrocentraleve brenda Parqeve Kombëtare. Kjo dukuri do të ndikojnë në shkatërrimin e habitateve të florës dhe faunës që jetojnë në këto mjedise.

Ndërtimi i hidrocentraleve brenda zonave të mbrojtura në përgjithësi dhe në Parqet Kombëtare në veçanti, shoqërohet me ndikime të drejtpërdrejta në vlerat e përgjithshme natyrore, florën dhe faunës ujore dhe tokësore, peizazhin dhe habitatet specifike, e veçanërisht mbi faunën, ku më të rrezikuarat janë llojet ujore, si peshqit, vertebrorët ujorë etj. Nga veprimet e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura bota e gjallë që gjenden në lum do të rrezikohen direkt dhe njëkohësisht do të ndodh shqetësimi i llojeve dhe habitateve të tyre.

Ndërprerja e rrjedhave ujore në lumenj ose përrenj nëpërmjet ndërtimit të digave, kanaleve dhe tubacioneve të hidrocentraleve janë shumë të dëmshëm për botën e gjallë, e cila konsiderohen si trashëgimi natyrore kombëtare.
Rrjedha e ujit është element përcaktues i mjedisit fizik në lumenjë dhe është përcaktues kryesor i përbërjes biotike: me ndikim në ndryshimin e habitateve tek bimët ujore dhe ato rreth shtratit lumor, ndryshimin e habitateve tek invertebrorët, peshqit dhe vertebrorët ujorë, etj.
Devijimi i ujit nga rrjedha natyrore për nevoja të hidrocentraleve do të ndikoj në ndryshimin e lagështisë së ajrit dhe mikroklimës e që për pasojë do të sjellë reaksion zinxhirë për shumë lloje shtazore ujore si peshq, insekte të ujit, molusqe, flutura, bretkosa, triton, shpendë ujorë, por edhe për bimët që gjenden përreth dhe në vet shtratin e lumit. Gjithashtu kjo do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në disa habitate të rëndësishme të florës, faunës, peizazhin natyror, si dhe dukuri të tjera të lidhura me të, siç mund të jetë erozioni apo rrëshqitjet masive të pjesëve shkëmbore të maleve përgjatë luginës së lumenjve.

Ulja e nivelit të ujit në shtretërit e lumenjve e shoqëruar me rritjen e temperaturës dhe uljen e oksigjenit të tretur, sjell uljen e popullatave të peshqve, ndërkohë që troftat e lumit pothuajse nuk mund të mbijetojnë në rrethana të tilla. Andaj, ndërhyrjet gjatë ndërtimit të hidrocentrale përveç ndikimeve në prishjen e baraspeshës ekologjike me pasoja për biodiversitetin dhe vlerat tjera natyrore përcjellet edhe me ndikim në klimën lokale të zonës.

Shembull i shkatërrimit të vlerave natyrore është funksionimi i hidrocentralit në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", konkretisht në Grykën e Deçanit, ku është degraduar shtrati burimor i lumit dhe mund të ceket se është shkatërruar gati e gjithë fauna që lidhet më rrjedhjen e Lumbardhit të Deçanit. Gjendja e njejtë është edhe te lumi Selac në Shalë të Bajgorës, i njohur për praninë e troftës autoktone, në shtratin e së cilës deri më tani janë ngritur dy hidrocentrale, ndërsa pritet që të ndërtohen edhe të tjetrë.

Gjendje shumë e rëndë është edhe ne lumin e Lepencit dhe degët e tij, ku një pjesë e konsiderueshme e sasisë ujore është futur në gypa, metodë kjo që po përdoret tek të gjithë hidrocentralet e ndërtuar rishtazi. Gjithashtu është ngritur një hidrocentral në afërsi të fshatit Firajë si dhe disa të tjerë pritet të ngriten në rrjedhën e poshtme të lumit me ç`rast gati se është shkatërruar në tërësi rrjedha natyrore e lumit bashkë me boten e gjallë.

Përgjatë luginave së rrjedhave lumore ku janë ndërtuar hidrocentralet gjenden shumë lloje të vegjetacionit të rralla e të rrezikuara, siç janë: *Pinus peuce, Pinus heldreichii, Abies alba, Picea excelsa, Cerastium alpinumn, Saxifraga stellaris, Saxifraga aizoides, Nartecium scardicum, Valeriana tripteris, Malva moschata, Cirsium candelabrum, Gnaphalium sylvaticum, Lychnis flos- cuculi, Lychnis coronaria, Tanacetum vulgare, Angelica pancicii, Acer intermedium, Achillea grandifolia, Saturea subspicata, Salix eleagnos* etj.

Nga llojet shtazore të pranishme në këto zona janë përfshirë në Anekset e Direktivave të e BE-së për habitatet dhe shpendët, vlen të përmendim: Lundërzën *(Lutra lutra),* Dhinë e egër *(Rupicapra rupicapra),* Ariun e murrmë *(Ursus arctos),* Kaprollin *(Capreolus capreolus),* Macën e egër *(Felis sylvestris),* Vjedullën *(Meles meles),* e gjithashtu Rrëqebullin Ballkanik *(Lynx lynx balcanicu*s), i vërejtur për herë të parë në Kosovë pas shumë viteve edhe atë mu në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe në PK. "Sharri", mandej, shpendët si Gjelin e egër *(Tetrao uragullus),* Thëllëzën e malit *(Alectoris graeca),* Shqiponjën e maleve *(Aquila chrysaetos),* Mëllenjën e ujit *(Cinclus cinclus),si dhe* peshqit si Troftën e përrenjve *(Salmo trutta m. Fario),* Troftën e mermertë *(Salmo marmoratus)* etj.
Prezenca e llojeve të lartpërmendura, si dhe llojeve të tjera në Listën e Kuqe të cilat mbrohen në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare është arsye që të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura respektivisht në Parqet Kombëtare dhe zonat tjara të pasura me biodiversitet.

Institucionet vendimmarrëse duhet të marrin përsipër që të sigurojnë mbrojtjen e resurseve natyrore, biodiversitetin dhe natyrën në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura, respektivisht Parqeve Kombëtare të cilat shpallen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve biologjike dhe të peizazheve natyrore. Në këtë rast mund të përmendim Parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", të cilat janë vendbanime për lloje bimore dhe shtazore të cilat nuk do të mbijetonin në mjediset tjera për shkak të kushteve të ndryshuara natyrore dhe ndërhyrjes së njeriut.

Hidrocentralet brenda Parqeve Kombëtare janë në kundërshtim edhe me Direktivat dhe Konventat ndërkombëtare si: Konventa e Bernës, Konventa e Diversitetit Biologjik, Direktiva e Habitateve natyrore, Direktiva kornizë për ujëra (2000/60/EC), Direktiva për ruajtjen e vendbanimeve të florës dhe faunës së egër (92/43/EEC), Direktiva për ruajtjen e zogjve të egër (2009/147/EC) etj.[29]

[29] Sqarim: *Rezoluta e Parlamentit Evropian, 15 shkurt 2017, raporti nr 2016/2312 - INI, kritikon ashpër Qeverinë e Shqipërisë dhe kërkon ndalimin e menjëhershëm të ndërtimit të Hidrocentraleve në Lumin Vjosa dhe shpalljen e lumit Vjosa Park Kombëtarë.*

Meqenëse Kosova në një periudhe të shkurtë kohore do të jetë nënshkruese e direktivave dhe konventave ndërkombëtare, Institucionet e Kosovës duhen të angazhohen në përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës me Direktivat e Bashkimit Evropian, kështu që tërë potenciali intelektuale duhet të fokusohet në kompletimin dhe miratimin e listës së llojeve dhe habitateve, që është kërkesë edhe e Bashkimit Europian.



Foto nr. 109. Degradimi i shtratit të lumit Berovec



Foto nr. 110. Degradimi i shtratit të Lumbardhit në Deçan

14.1. Rekomandimet

1. Të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në të gjitha zonat e mbrojtura;
2. Prodhimi i energjisë përmes hidrocentraleve duhet të zëvëndësohet më ndërtimin e objekteve tjera të energjisë së ripërtëritshme, si shfrytëzimi i energjisë së erës, diellit, etj, të cilat nuk kanë ndikim negativ në aspektin mjedisor, social dhe ekonomik;
3. Të merren të gjitha masat qe zonat e degraduar nga aktivitetet e hidrocentraleve të rehabilitohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme;
4. Të behën studime për sasinë e resurseve ujore në Kosovë dhe në bazë të tyre të hartohen politikat dhe strategjitë për shfrytëzimin e ujërave;
5. Shfrytëzimi i ujërave për qëllime të ndryshme të janë në pajtim edhe me komunitet lokal;
6. Të inspektohen vazhdimisht lumenjtë nga Inspektorati i MMPHI dhe komunat,ku veprohet sipas ligjeve në fuqi;
7. Inspektorati i MMPHI dhe komunal ti ndalojnë të gjitha aktivitete degraduese të lumenjve si: hedhja e mbeturinave të ngurta, shkarkimi i ujërave të zeza, hedhja e pesticideve, ndërrimi i rrjedhjeve lumore, digat, ndërtimet në afërsi të lumenjve, etj.

XV. PYJET

Bazuar në Ligjin për pyjet Nr. 2003/3, resurset pyjore konsiderohen pasuri kombëtare me interes të përgjithshëm. Pyjet kanë rëndësi në përmbushjen e qëllimeve në aspektin ekologjik-mjedisor, ekonomik dhe social. Roli social i pyjeve është një nga faktorët tjerë kryesor, i cili sot në mbarë globin trajtohet si qenësor për arsye që ndërlidhen me sigurimin e ushqimit dhe krijimin e vendeve të punës. Prandaj, politikat e ardhshme kombëtare apo ndërkombëtare, përveç qasjes në rolin e pyjeve në aspektin ekologjik-mjedisor dhe atë ekonomik, janë përqendruar së tepërmi në krijimin e vendeve të punës në zonat e thella rurale, me qëllim të mbajtjes së popullatës në këto zona, bazë për sigurimin e ushqimit, përmes difersifikimit dhe shtimit të vlerave.

Mbështetur në Inventarizimi Kombëtar të Pyjeve /IKP në vitit 2012, Kosova është e mbuluar me 44.7 % me pyje, e që konsiderohet një potencial i qëndrueshëm për zhvillim të vendit, nga të cilat rreth 62 % janë pyje publike ndërsa rreth 38 % konsiderohen si pyje private. Bazuar në inventarin e pyjeve, zonat e mbrojtura apo pyjet shtrihen në rreth 12 % të sipërfaqes së përgjithshme të tyre dhe në vete përfshijnë rreth 36 % të volumit të përgjithshëm. Ndikimi për qasje ekonomike është i kufizuar, bazuar në faktin e mësipërm të përmbledhjes në vëllim, por edhe në faktin se pyjet me vlera më të mëdha ekonomike (pyjet e larta-trungishtet) gjenden brenda dy Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Figura nr. 8. Klasat e përdorimit të tokës në % nga sipërfaqja e përgjithshme



Burimi: MBPZHR. Inventarizimi Nacional i Pyjeve, 2012.

Pyjet e Kosovës janë të dominuar nga pyjet fletore, duke mbuluar 93 % (449,400 ha) të sipërfaqeve pyjore, ku më shumë se gjysma janë një-moshare. Ndërsa 5 % (23,800 ha) e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyjet halore të cilat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të klasave të ndryshme strukturore. Në total, rreth 50 % e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

Tabela nr. 12. Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbujve, (ha)

Përbërja e pyjeve	Rigjenerimi	Një-moshar	Dy-katësh	Shumë-moshar	Totali
Halorë	2,200	6,600	6,200	8,800	**23,800**
Përzier	0	400	3,200	4,200	**7,800**
Fletorë	45,400	236,000	123,600	44,400	**449,400**
Totali	**47,600**	**243,000**	**133,000**	**57,400**	**481,000**

Burimi: MBPZHR. Inventarizimi Nacional i Pyjeve, 2012

Shumica e sipërfaqes pyjore përbëhet nga grumbuj pyjorë të përzierë (21 % e sipërfaqes pyjore përbëhet nga 4 - 5 lloje të ndryshme drurësh). Afro 85 % e pyjeve rigjenerohen në mënyrë vegjetative përmes lastarëve të cungjeve.

Sipas rezultateve të IKP-së, prerja vjetore e qëndrueshme vlerësohet të jetë 1.45 milionë m³/vit, me afro 630 000 m³ në pyje të cilësisë së lartë dhe 815 000 m³ në pyje cungishte të cilësisë së ulët. Megjithatë, aktualisht prerja vjetore e lëndës drunore arrin në 1.6 milionë m³, që është rreth për 1/4 më e lartë se niveli i rekomanduar dhe afatgjatë. Për më tepër, vetëm 10 – 15 % e vëllimit pyjor aktualisht prehet sipas rregulloreve ekzistuese, që do të thotë se MBPZHR-ja – Agjencia Pyjore e Kosovës shfrytëzojnë afro 200 000 m³ në vit. Arsyet kryesore për këtë janë prerët ilegale dhe aktivitetet joformale në pyje, pronat e fragmentuara dhe të vogla të pyjeve private (një/dy hektarë mesatarisht), si dhe shkalla e ulët e zbatimit të planeve menaxhuese të pyjeve.

Potenciali i resurseve pyjore nuk shfrytëzohet plotësisht për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të teknologjisë së duhur dhe të personelit të trajnuar, dobësive të strukturave organizative dhe të zbatimit të legjislacionit lidhur me mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve. Të dhënat sipas IKP të fundit, tregojnë se gjithsej 58.200 ha pyje ndikohen negativisht nga faktorët biotikë dhe abiotikë, ku rreth 5.8 milionë m³ dëmtohen si pasojë e këtyre faktorëve. Insektet dhe sëmundjet janë shkaktarë për dëmtimin e 14.600 ha të kësaj sipërfaqeje. Prerja ilegale e pyjeve janë ndër faktorët kryesor që ndikojnë në dëmtimin e pyjeve. Fshatarët e varfër që jetojnë afër zonave pyjore, bëjnë prerjen e drunjve për mbijetesë. Sipas inventarizimit të fundit të pyjeve, 40 % e pyjeve publike dhe 29 % e pyjeve private në Kosovë janë demtuar nga aktivitetet e pakontrolluara ose nga prerjet ilegale. Vëllime të larta të mbetjeve pyjore shpesh mbesin në pyll pas prerjeve, gjë që çon në humbje të biomasës qe mundë të përdorej për bioenergji dhe shton rrezikun e dëmtive nga insektet dhe rrezik të shtuar nga zjarret pyjore.

Ngritja e pyjeve të reja dhe përmirësimi i shëndetit të pyjeve janë adresuar përmes: Programi Kombëtar i Pyllëzimit dhe Ripyllëzimit i Kosovës (PKPR) 2018-2027 dhe Programi Kombëtar i Shëndetit të Pyjeve (PKSHP) 2018-2027. PKPR-ja, synonte rritjen e pyjeve të Kosovës me 5 %, mirëpo është vlerësuar si program tejet ambicioz dhe vështirë i realizueshëm.

Ndërkaq, PKSHP-ja synonte përmirësimin e shëndetit të pyjeve, por zbatimi i tij mbetet sfidë për institucionet përgjegjëse të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve si shkak i mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve financiare.

Pyllëzimet kryesisht janë bërë me lloje halore, trend i cili ka vazhduar deri ne vitin 2018 kur është aprovuar Plani Kombëtar për Pyllëzime dhe Ripyllëzime 2018-2027, i cili favorizon pyjet fletorë. Pyllëzimet me llojet jo-autoktone, të cilat përbëjnë kërcënim për pyjet natyrore, mbulojnë 0.6 % të pyjeve. Lloji kryesor është akacia me prejardhje nga juglindja e SHBA-së, e cila fillimisht u soll në Evropë, pastaj edhe në Kosovë, me qëllim të kontrollimit të erozionit. Akacia mbulon 2400 ha dhe bashkë me Larshin dhe Pseudocugën, gjithsej sipërfaqja me specie jo-autoktone sillet rreth 3200 ha.
Aktivitetet e pylltarisë realizohen sipas Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet, ndërsa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të një ligji të ri për pyjet. Ekzistojnë 45 akte nënligjore (udhëzime administrative) që lidhen me pylltarinë dhe gjuetinë dhe disa prej tyre janë ndryshuar dhe plotësuar. Përveç Ligjit për Pyjet, janë rreth 13 ligje që ndërlidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me pyjet e Kosovës.
Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) në kuadër të MBPZHR-së është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore publike dhe kontrollimin e menaxhimit të pyjeve dhe tokave pyjore private përfshirë grumbullimin e produkteve pyjore jo drusore. Departamenti i Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së, është përgjegjës për politikat dhe strategjitë e sektorit të pylltarisë. Autoritetet pyjore komunale janë përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve dhe dhenien e lejeve për prerjen e trungjeve.

15.1. Aktivitetet për menaxhimin e pyjeve

Gjatë periudhës 2018-2020 pyjet janë mbuluar me plane afatgjate 14 njësi menaxhuese, ku janë monitoruar dhe kontrolluar gjatë gjithë kohës së mbledhjes së shënimeve në bazë te taksave në terren si dhe është raportuar në tri faza për punët e kryera.
Faza I - krijimi i bazës së të dhenave dhe dixhitalizimi i njësisë menaxhuese.
Faza II - mbledhja e shënimeve të detajuara në terrene, dhe
Faza III - përpunimi i të dhënave bazuar në shënimet si pjesa tekstuale, tabelare dhe hartografike.
Gjatë periudhes 2018 - 2020, janë përgatitur Planet Menaxhuese për Njësi Menaxhuese (NJM):

- 2018 - Bellosicë 4185 ha (Podujevë), Koritnik II 970 ha (Dragash), Duboçak 500 ha (Zubin Potok), (Pejë), Maja e Zezë 6601 ha (Pejë), Gnjzhansk 2719 ha (Leposaviq), Guri i zi 2100 ha (Kamenicë), Bodoshnjak 4957 ha, (Kaqanik - Hani i Elezit), gjithsejtë 22032 ha.
  2019 - Bjeshkët e Moknës 5351 ha (Zubin Potok), Kodra e bardhë - Lokvë 4426 ha (Leposaviq), gjithsejtë 9777 ha,
- 2020 - Lugu i Butë 3446 ha, (Istog), Ahishta 823 ha (Kaçanik), Goshtcë, 2310 ha (Viti), Bredhiku 1262 ha (Dragash), Opojë 2927 ha, (Dragash), gjithsejtë 10768 ha.

15.2. Aktivitetet për mbrojtjen e pyjeve

Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme për mbrojtjen e pyjeve, si ngritje të procedurave për kundërvajtje dhe penale, kontrolle në terrene pyjore, tregje, dhe rrugët pyjore.

Autoritetet komunale, kanë raportuar për numrin e kallëzimeve penale dhe kundërvajtjeve. Sasinë e materialit drusor të raportuar si dëm pyjor dhe vlerën e dëmi të shkaktuar.
Në aspektin e mbrojtjes së pyjeve nga prerjet e ilegale është raportuar edhe sasia e materialit drusor të konfiskuar i cili është prerë dhe transportuar në mënyrë të parregullt.

Tabela nr.13. Kallëzimet - fletëparaqitjet, 2018 - 2020

Dëmi Pyjor		Copë	m³	Gjithsej në €
2018	Fletëparaqitje kundërvajtje	4,501	7,589	992,320
	Fletëparaqitje penale	1,147	6,430	829,427
	Gjithsej	**5,648**	**14,019**	**1,821,747**
2019	Fletëparaqitje kundërvajtje	3,099	16,875	713,203
	Fletëparaqitje penale	664	3,143	381,307
	Gjithsej	**3,763**	**20,019**	**1,094,510**
2020	Fletëparaqitje kundërvajtje	2764	4,715	569,551
	Fletëparaqitje penale	610	2,683	343,258
	Gjithsej	**3374**	**7,398**	**912,808**

Burimi: MBPZHR

15.3. Zjarret pyjore gjatë vitit 2018 - 2020

Zjarret pyjore paraqesin një nga sfidat e mëdha të institucioneve, sidomos gjatë periudhës së fillimit të pranverës dhe gjatë verës. Sipas analizave dhe statistikave të ndryshme mbi 99 % e zjarreve në pyje dhe toka pyjore shkaktohen nga faktori njeri, ndërsa vetëm 1 % e tyre nga shkaktarë të tjerë abiotik. Gjatë periudhës me thatësira të verës të vitit 2020, numri i rasteve dhe përfshirja e sipërfaqeve pyjore nga zjarret pyjore ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Kjo si shkak i temperaturave të larta dhe nga pakujdesia e njerëzve.

Tabela nr.14. Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja në ha, 2018-2020

Regjioni		Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjithsej
viti								
2018	Nr. i rasteve	25	2	9	32	5	10	83
	Gjithsej (ha)	576	3	47	211	8	104	949
2019	Nr. i rasteve	62	17	18	51	17	53	218
	Gjithsej (ha)	472	452	1403	194	86	526	3133
2020	Nr. i rasteve	59	17	6	58	19	11	170
	Gjithsej (ha)	371	618	322	762	84	247	2404

Burimi: MBPZHR

Figura nr. 9. Sipërfaqja e djegur e pyjeve në ha (2008-2020)[30]



Burimi: Agjencioni i Pyjeve të Kosovës [31]

Agjencia Pyjore e Kosovës është duke vazhduar bashkëpunimin me institucionet e rendit, emergjencave dhe sigurisë në raste që paraqitjes së zjarreve pyjore. Ky bashkëpunim krijon mundësinë për zvogëlimin e përhapjes së zjarreve në sipërfaqet pyjore dhe në tokat rreth pyjeve. Gjatë vitit 2020, APK në bashkëpunim me MPMS në gjashtë regjionet ka angazhuar rreth 290 punëtorë sezonal për mbrojtje e pyjeve nga zjarret. Nga APK dhe AME, janë trajnuar dhe certifikuar 240 punëtorë për shuarje të zjarreve në pyje.

15.4. Aktivitetet në pyllëzime

Mbështetur në planin vjetor të menaxhimit me pyje, pyllëzimet e tokave pyjore janë realizuar në të gjithë territorin e Kosovës. Gjatë vitit 2018 në regjionin e Prishtinës, Mitrovicës dhe Pejës janë pyllëzuar rreth 136 ha, ndersa në regjioni e Prizrenit, Ferizajit dhe Gjilanit jane pyllëzuar reth 160 ha. Ndërsa gjatë vitit 2019 - 2020 janë pyllëzuar rreth 800 ha, sic shihet në tabelën vijuse.

Tabela nr.15. Pyllëzimet, 2019-2020

Regjioni / viti	Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjithsej
2019	65	74	50	95	65	71	419
2020	58	69	55	65.20	69.40	64	380.60

Burimi: MBPZHR

[30] Agjencioni i Pyjeve të Kosovës
[31] Agjencioni i Pyjeve të Kosovës

XVI. INSPEKTIMI DHE PROCEDURAT LIGJORE TË NDËRMARRA NË FUSHËN E MBROJTJES SË NATYRËS

Në kuadër të kompetencave të kontrollit nga ana e Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit sipas detyrës zyrtare, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektive dhe kontrollit përmes inspektimit të natyrës në kuadër të zbatimit të ligjeve në fushën e mbrojtjes së natyrës, gjatë periudhës 2018 - 2021 ka realizuar 361 aktivitete të ndryshme, të cilat janë pasqyruara në tabelën nr. 16.

Tabela nr.16. Veprimet e ndërmarra në fushën e natyrës

Aktivitete inspektuese në fushën e natyrës	***2018***	***2019***	***2020***	***2021***
Vendime	-	1	7	7
Gjoba mandatore	-	20	-	4
Gjoba administrative	-	-	-	2
Procedura gjyqësore / kundërvajtëse	2	2	-	-
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	34	34	25	17
Mbikëqyrje me ekipe inspektive	-	-	-	142
Rekomandime, urdhëresa dhe informata	32	12	-	20

Burimi: Inspektorati i MMPHI-së

Sfidë kryesore e cila paraqitet në realizimin e inspektimeve mbikëqyrëse dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore në fushën e natyrës mbetet zbatimi i Ligjit Nr. 04/l-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit. Ky ligj përcakton që Inspektorati i Mbrojtjes së Natyrës duhet të ushtrojë mbikëqyrje inspektive dhe kontrollën përmes inspektimit në natyrë në zbatimin e këtij ligji si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës. Gjithashtu duhet të ushtroj detyra dhe përgjegjësit e tij në mbrojtje të natyrës, duke harmonizuar aktivitetin e tij me kërkesat e Bashkimit Evropian për rrjetin "Natyra 2000".

Me Rregulloren (QRK), Nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është paraparë që Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor të jenë të punësuar tridhjetë e një (31) nëpunës, por që faktikisht gjendja ekzistuese është ndryshe. Në këtë Departament është i punësuar vetëm një (1) inspektor i natyrës në nivel qendror.

Duke marrë parasysh obligimet ligjore dhe përqindjen e territorit të Kosovës e cila është e mbrojtur për natyrën e saj, është e pamundur që inspektimi mbikëqyrës i fushës së natyrës të bëhet vetëm nga një inspektor. Gjithashtu edhe në nivel lokal, nuk ka të punësuar inspektor në kuadër të komunave të cilët janë të specializuar vetëm për fushën e natyrës.

Përgjithësisht, në ndërhyrjet e palejueshme në fushën e ndërtimit, mjedisit dhe ujërave, pjesa tjetër e inspektimeve është realizuar përmes 4 897 aktiviteteve, si në tabelën nr. 17.

Tabela nr.17. Inspektimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit

Lloji i aktivitetetit inspektuese në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit	2018	2019	2020	2021
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	763	796	250	561
Vendime	131	126	64	212
Gjoba mandatore	4	148	11	231
Gjoba administrative	-	-	67	228
Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje	522	500	86	-
Inicime në Gjykata	62	63	30	6
Procedura përmbarimore	-	-	-	36

Burimi: Inspektorati i MMPHI-së

Gjatë punës në terren për mbrojtjen e natyrës Inspektorati i MMPHI-së, ka vlerësuar se është e nevojshme të bëhet:

- Rishikimi i vendimeve në Parqe Kombëtare rreth dhënies së Lejeve të Ndërtimit;
- Evitimi i konfliktit të kompetencave në mes të nivelit qëndror dhe lokal për lëshimin e kushteve dhe lejeve ndërtimore si dhe realizimin e mbikëqyrjes inspektuese për objektet me leje;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe çdo aktiviteti tjetër ilegal në zonat e mbrojtura;
- Mungesa e aktit juridik për kompetencat dhe procedurat e lëshimit dhe ekzekutimit të vendimeve për rrënim të objekteve pa leje;
- Mungesa e zyrtarit juridik në kuadër të Inspektoratit, për përgatitjen e akteve juridike të cilat i obligon Ligji i Inspektoratit dhe përfaqësimit nëpër gjykata rreth inicimeve për shkeljet e konstatuara;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore për përshpejtimin e procedurave të lëshimit të dokumentacionit nga MMPHI;
- Parandalimin e veprimeve ilegale për shfrytëzimin e resurseve natyrore si inerteve të lumit, gurit gëlqeror, thëngjillit etj;
- Shkarkimi i pa trajtuar i ujërave në rrjedhat e lumenjëve - mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave kryesisht nga ekonomitë familjare por edhe nga veprimtaritë tjera;
- Ndërhyrjet në pronat ujore dhe në zonat e mbrojtura ujore;
- Ndërtimiet në prona ujore në afërsi të rrjedhave të lumenjve dhe ujë rrjedhave tjera si dhe në zonat e mbrojtura të akumulacioneve - liqejve artificiale si në Liqenin e Batllaves, Badovcit, Radoniqit etj;
- Prodhuesit dhe ambalazhuesit e ujit dhe lëngjeve të obligohen për taksa ujore, janë mbi 50 operatorë të cilët prodhojnë ujë dhe lëngje e të cilët operojnë pa dokumentacion përkatës, për shkak të skadimit të lejeve ujore dhe obligimeve për leje mjedisore, mos përmbushjes së obligimeve të pagesave për shkak të tarifës së lartë të taksës ujore, refuzimit për pagesa, procedurave administrative të ndryshimit të udhëzimit administrativ për taksa ujore, Vendimit të Qeverisë për falje të borxheve etj;

- Ngritja e bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe lokal duke qenë të vetëdijshëm se ka mungesë të inspektorëve lokal në fushën e mjedisit dhe ujërave etj.

Drejtoritë për Administrimin e Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" konform përgjegjësive të ligjeve për parqet kombëtare, të natyrës dhe legjislacionin tjetër përkatës në fushën administrative, kundërvajtëse, penale, civile e përmbarimore gjatë periudhës 2018-2021, ka ndërmarrë veprime të nevojshme për zbatimin e obligimeve. Këto veprime janë paraqitur në tabelën nr. 18 për Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", kurse në tabelën nr. 19 për Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri".

Tabela nr.18. Veprimet e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Aktivitete të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"	***2018***	***2019***	***2020***	***2021***
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Pejë	67	78	39	25
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Gjakovë	3	-	1	-
Kërkesa kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Pejë – Divizioni për Kundërvajtje	6	8	-	-
Kërkesa kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Deçan	6	1	-	-

Burimi: Inspektorati i MMPHI-së

Tabela nr.19. Veprimet e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri"

Aktivitete e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Sharri"	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj	132	198	63	13
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren	3	5	9	3
Kërkesa kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prizren	-	1	-	-
Kërkesa kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Shtërpcë	6	1	-	-
Kërkesa kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Kaçanik	3	3	-	-
Kërkesa kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Dragash	-	1		-

Burimi: Inspektorati i MMPHI-së

XVII. DISA PROJEKTE DHE AKTIVITETE TË RËNDËSISHME PËR MBROJTJEN E NATYRËS 2018 - 2021

Gjatë periudhës 2018 - 2021 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me institucionet tjera ka realizuar disa projekte dhe aktivitete të rëndësishme që kane ndikuar në mënyrë të drejtpërsëdrejti në përmirësimin e gjendjes se biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe natyrës në përgjithësi.
Instituti, po ashtu është angazhuar edhe në ngritjen e bashkëpunimit jo vetëm me institucionet relevante kombëtare përgjegjëse për ruajtjen e natyrës por edhe me ato ndërkombëtare, institucionet akademike edhe kërkimore, si dhe me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të arritjes së synimit të përbashkët për mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore.

17.1. Raportimi në EEA/EIONET

Në kuadër të bashkëpunimit dhe raportimit në Agjencinë Europiane të Mjedisit - EEA dhe në Rrjetin Europian të Sistemit te Informimit dhe Mbikqyerjes (EIONET), Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka raportuar në këto institucione prej vitit 2011
Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve në procesin e raportimit për indikatorët e biodiversitetit IKMN edhe gjatë periudhës 2018 - 2021 me sukses ka raportuar në EIONET për indikatorin e zonave të mbrojtura (Common Database on Designated Areas - CDDA).
Vlen të theksohet se edhe gjatë kësaj periudhe, sikurse edhe në vitet paraprake, ky raport është vlerësuar maksimalisht nga EEA.



Harta nr. 8. Performanca e përgjithshme e shteteve në raportimin e vitit 2020

17.2. Cenzusi Ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit 2021 në Kosovë

(2021) - Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës me ndihmën e vullnetarëve nga Wildlife Albanian Photographers - WAPH, Kosova Wildlife Care - KWC, për herë të tretë me radhë kanë realizuar aktivitetin Cenzusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit. Ky numërim u realizua pothuajse në të gjitha zonat ku ka prezencë të baseneve ujore si dhe në disa pjesë të rrjedhave lumore. Aktiviteti është realizuar në kuadër të IWC 2021 (International Waterbird Census) që organizohet në nivel botëror, që prej 55 vitesh, nga Wetlands International.
Nga rezultatet e mbledhura mund të konstatohet se janë vrojtuar gjithsej 19 lloje të shpendëve të ujit me një numër total prej 8.250 individësh. Edhe këtë herë shumica e shpendëve të ujit të numëruar me këtë rast ishin Rosa e egër (*Anas platyrhynchos*) me 5.477 individë dhe Rosa kërre (*Anas crecca)* me 1.985 individë që përbënin mbi 90 % të numrit të përgjithshëm të shpendëve.

17.3. Shpallja e llojeve të mbrojtura

(2021) - Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e natyrës, me iniciativën e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, Ministri i MMPHI-së, përmes vendimeve të ndara ka marrë në mbrojtje disa raca autoktone të pëllumbave të Kosovës.
Me miratimin e këtyre vendimeve, llojet autoktone të pëllumbave: Pëllumbi dhe Pelikani i Pejës, Kryemusmi i Gjakovës, Gjylia e Prizrenit, Akrobatiku-Dyneku i Kosovës, dhe Kuti i Drenicës i janë shtuar Regjistrit të Vlerave të Mbrojtura të Natyrës, që mirëmbahet nga Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtyre vendimeve është mbrojtja e këtyre llojeve sipas ligjit dhe përcaktimi i kushteve të mbajtjes. Gjithashtu përmes këtyre vendimeve synohet që këto lloje të mbrohen nga rreziku për përzierje gjenetike me racat e huaja dhe nga rreziku për nxjerrje jashtë vendit e këtyre racave me qëllim të kryqëzimit me racat tjera.
Vendimet përmbajnë edhe arsyeshmërine profesionale për marrjen në mbrojtje të këtyre llojeve si dhe përshkrimin e karakteristikave themelore të tyre, të cilat janë hartuar nga një grup punues ndërinstitucional i udhëhequr nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Vënia nën mbrojtje institucionale e këtyre racave autoktone të pëllumbave është e një rëndësie të veçantë edhe për faktin se këto raca tani do të prezantohet ndërkombëtarisht si raca autoktone të Republikës së Kosovës, lloje vendore të zbutura, përmes së cilave do të paraqitet edhe begatia e vlerave të biodiversitetit të vendit.



Foto nr. 111. Llojet autoktone të pëllumbave

17.4. Atllasi i Bimëve të Kosovës

(2021) - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka përkrahur realizimin e botimit të Atllasit të Bimëve të Kosovës. Ky atlas është rezultat i një pune hulumtuese disa vjeçare të ekspertëve vendor të botanikës dhe paraqet një publikim shumë të rëndësishëm në këtë fushë.

Ekipi i ekspertëve që ka marrë pjesë në hartimin e këtij atllasi, gjatë punës në terren ka mbledhur 1130 lloje bimore, duke përfshirë rreth 1/3 e bimëve të Kosovës. Ky dokument është i rëndësishëm për institucionet qendrore, lokale, si dhe ato akademike, sepse përmban të dhëna shkencore të rëndësishme për florën e Kosovës. Këto të dhëna janë me vlerë të veçantë për Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, pasi që mundësojnë plotësimin e bazës së të dhënave dhe krijimin e një inventari të detajuar për llojet bimore.

Në kuadër të llojeve të bimëve të përfshira në këtë atllas ka edhe llojet bimore endemike të Ballkanit dhe Kosovës, si dhe lloje të rralla e të rrezikuara. Ky dokument është një bazë e mirë edhe për hartimin e politikave, strategjive dhe planeve për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të rrezikuara të bimëve.

Botimet e ngjashme, kontribuojnë në rritjen e vetëdijes të të gjitha shtresave për njohjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit të llojeve bimore të vendit tonë. Po ashtu, ky atllas do të jetë në shërbim edhe institucioneve arsimore të niveleve të ndryshme që do të mundsojë njohjen me llojet bimore të Kosovës dhe përhapjen e tyre.



Foto nr. 112. Atllasi i Bimëve të Kosovës

17.5. SPELEOMEDIT një monografi për Speleologjinë e vendeve të Mesdheut

(2021) - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e vitit 2021 si vit Ndërkombëtar i Shpellave dhe Karstit, Unioni Ndërkombëtarë i Speleologjisë së Mesdheut ka publikuar monografinë "Speleomedit - *Pamje panoramike e shpellave dhe karstit të vendeve të Mesdheut*", që përfshinë një përmbledhje të punimeve që prezantojnë shpellat dhe fenomenet karstike të vendeve të Mesdheut.



Kjo momografi jep një kontribut të rëndësishëm për ndërgjegjësim të përbashkët dhe për të forcuar lidhjet ndërmjet grupet speleologjike dhe institucionet kërkimore në vendet e Mesdheut, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe veprimeve për të mbështetur mbrojtjen e karstit dhe të shpellave.

Monografia është e strukturuar me artikuj të përgjithshëm që japin një pamje panoramike të karstit, gjeomorfologjisë, hidrologjisë, bio – gjeografisë, biologjisë, arkeologjisë, nëntokësore si dhe historisë dhe kulteve të lidhura me shpellat në vendet e mesdheut. Në një nga artikujt e këtij publikimi është prezantuar edhe speologjia e Kosovës.

17.6. Habitati i llojit endemik Boshtra, një vlerë e shtuar e regjistrit të zonave të mbrojtura

(2021) - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë evidentimin e vlerës së natyrës - vendbanimin e llojit endemik *Forsythia europaea* (Boshtra) që gjendet në kodrën e Goleshit, zonë kjo që përfshinë territorin e Komunës së Fushë Kosovës, Drenasit dhe Lipjanit.
Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të MMPHI-së, Universitetit të Prishtinës dhe nga komunat përkatëse ka hartuar arsyeshmërinë profesionale si dokument bazë për vënien nën mbrojtje të kësaj vlere natyrore. Kuvendet e këtyre komunave kanë nxjerrë vendimet mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si zonë e mbrojtur Boshtra (*Forsythia europaea).*
Sipërfaqja e tërësishme e kësaj zone është 123.54 ha (51.92 ha Fushë Kosovë, 38.42 ha, në Drenas dhe 33.2 ha në Lipjan). Të dhënat e prezantuara në arsyeshmërinë profesionale janë mbledhur nga arkiva e Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës por edhe gjatë ekspeditave hulumtuese në terren të realizuara nga ana e grupit punues dhe ekspertë e fushave përkatëse.
Forsythia europaea (Boshtra) është bimë drurore - shkurre, endemike dhe relikte terciere e Kosovës dhe Shqipërisë. Ky lloj në Kosovë rritet në zona shkëmbore– serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre.
Ky lloj është vlerësuar në Librin e Kuq të florës vaskulare të Kosovës në kategorinë LC (më pak i rrezikuar) pasi që lloji për momentin nuk është i kërcënuar në atë masë sa që të futet në ndonjë kategori më të lartë. Habitatet ku rritet ky lloj janë të pasura edhe me lloje tjera endemike dhe relikte që kanë rëndësi shkencore.





Foto nr. 113. Forsythia europaea (Boshtra) Harta nr. 9. Vendbanimi i llojit endemik *Forsythia europaea*

17.7. Përfaqësuesit e Parqeve Kombtare, diskutojnë për bashkërendimin e aktiviteteve në kuadër të rrjetit të Parqeve Dinarike

(2021) - Përfaqësuesit e zonave të mbrojtura të Kosovës, anëtarë të rrjetit të zonave të mbrojtura të Dinarideve, drejtori i DAPK "Sharri", drejtori i DAPK "Bjeshkët e Nemuna", dhe organit menaxhues të Peisazhit të Mbrojtur "Gërmia", janë takuar për të diskutuar lidhur me bashkërendimin e veprimeve në kuadër të pjesëmarrjes në aktivitetet e projektit të Parqeve Dinarike. Njëherit, në këtë rast ata kanë pranuar edhe certifikatet e anëtarësimit në këtë rrjet të zonave të mbrojtura.

Parqet e Kosovës janë anëtare më të drejta të plota të rrjetit të Parqeve Dinaride që nga viti 2014. Rrjeti i Parqeve Dinaride, përbëhet nga 95 zona të mbrojtura nga Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i zi, Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia. Qëllimi i rrjetit është që përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitete të përbashkëta të përmirësohet menaxhimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore në zonat përkatëse të mbrojtura anëtare të rrjetit.

17.8. Unazimi i dy individëve të llojit Lejleku i Zi (*Ciconia nigra*)

(2021) Janë unazuar për herë të parë në Kosovë dy individë të llojit Lejleku i Zi (*Ciconia nigra*). Këto janë zogjtë e parë të këtij lloji që unazohen në Kosovë dhe unazimi i tyre është realizuar në folenë e tyre që ndodhet në një lokalitet në Komunën e Kamenicës. Ky aktivitet është realizuar si bashkëpunim në mes të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Shoqatës së Fotografëve të Jetës së Egër në Kosovë.
Unazimi i lejlekëve është aktivitet i rëndësishëm sepse në bazë të shifrave (kodeve) që mbajnë unazat, konfirmohet që këta janë lejlekë të Kosovës. Unazat e përdorura për këtë aktivitet janë donacion nga Instituti MaxPlanck për Ornitologji i Gjermanisë, me të cilin IKMN-ja, ka bashkëpunim në këtë fushë. Në të ardhmen planifikohet, që këtyre zogjëve t`u vendosen edhe GPS për të përcjellë lëvizjen dhe shtegëtimin e tyre.



Foto nr. 114. Foto Unazimi i individë të llojit Lejleku i Zi

17.9. Bashkëpunim me UP- FSHMN - Departamentin e Biologjisë

(2021) Studentët e drejtimit Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit nga UP kanë vizituar Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Gjatë kësaj vizite studentët patën mundësi të shohin nga afër punën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe të njihen me mundësinë për tu angazhuar me punë praktike në Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, përkatësisht në kuadër të hulumtimeve që Instituti i Natyrës realizon në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.



Foto nr. 115. Bashkëpunim me UP - Departamentin e Biologjisë

17.10. Parku Kombëtar "Sharri" habitat i një kërpudhe shumë të rrallë

(2020) - *Zeus olympius*, është një lloj kërpudhe shumë e rrallë që gjendet në Kosovë, e që është e njohur vetëm nga dy vende të tjera të botës. Kërpudha për herë të parë në Kosovë u zbulua nga një ekip mikologësh nga Maqedonia e Veriut në vitin 2018 gjatë një hulumtimi në Prevallë në një lartësi mbidetare rreth 1.600 m.

Zeus olympius u gjet për herë të parë në vitin 1986 në malin Olimp në Greqi, ndërsa në vitin 2012 ajo u gjet edhe në malin Pirin në Bullgari. Këpurdha rritet në grupe të vogla mbi pjesë të vdekura të degëve të vogla të pishës boshnjake (*Pinus heldreichii* syn.) Lloji është pjesë e Global Fungal Red List Initiative (Nisma e Listës së Kuqe Globale Kërpudhore), në të cilën ajo është cilësuar si "potencialisht e rrezikuar në mënyrë kritike". Të dhënat për Kosovën tashmë janë inkorporuar në bazën e të dhënave të Nismës së Listës së Kuqe Globale Kërpudhore.

Kërpudha u gjet dhe u përcaktua nga ekipi i mikologëve nga Fakulteti i Shkencave Natyrore në Shkup, në kuadër të projektit të tyre "Kërpudhat e Kosovës". Deri më tani, kërpudhat e Kosovës kanë qenë pak të studiuara dhe kishte pak të dhëna zyrtare në dispozicion. Projekti ka prodhuar të dhëna për mbi 380 lloje të ndryshme, duke i përfshirë në një bazë të dhënash online, posaçërisht të krijuar Fungi of Kosovo (Kërpudhat e Kosovës). Lista, e përgatitur në linjë me kriteret e IUCN-së, do të jetë një themel për përpilimin e një Liste Zyrtare të Kuqe të Kërpudhave dhe përgatitjen e legjislacionit për mbrojtjen e kërpudhave.



Foto nr. 116. Kërpurdha (*Zeus olympius*)

17.11. Shenjëzimi i rezervateve strikte të natyrës

(2020) - Duke marrë për bazë rëndësinë që kanë Rezervatet Strikte për mbrojtën e vlerave natyrore, ekosistemeve të rralla dhe llojeve të veçanta të florës dhe faunës, AMMK/IKMN gjatë vitit 2020, në kuadër të projektit për shenjëzimin e zonave të mbrojtura ka bërë shenjëzimin e Rezervateve Strikte.
Projekti është realizuar në rezervatet strikte që shtrihen në dy parqet kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", si dhe në pjesë të tjera të territorit të Kosovës dhe kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për rëndësinë që ka mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore përmes vendosjes së njoftimeve zyrtare në këto zona për publikun e gjërë.



Foto nr. 117. Shenjëzimi i rezervateve strikte

17.12. Me moton " Është koha për natyrën", AMMK shënoi Ditën Botërore të Mjedisit

(2020) - AMMK-ja, përmes Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Sharri", dhe në bashkëpunim me organizatën WWF Adria zyra në Prishtinë, ka shënuar 5 Qershorin - Ditën Botërore të Mjedisit.

Aktiviteti kryesor është zhvilluar në zonën turistike të Prevallës, në rrugën Prevallë-Brezovicë, ku është ndërmarrë aksion për pastrim të mbeturinave përgjatë rrugës dhe rrjedhës së lumit, si dhe ecje në natyrë deri tek lokacioni Burimi i Madh apo i njohur ndryshe si Shtëpia e Vëzhguesve. Dita Botërore e Mjedisit është shënuar me moton "Koha për natyrën". Duke e ditur faktin që të gjitha të mirat materiale, ushqimi, ajri që thithim, uji që pimë dhe klima që na rrethon, vijnë nga natyra. Moto ka për synim që të nxisë aktivitete që promovojnë mbrojtën e natyrës dhe rolin e saj për mirëqenien dhe shëndetin publik.



Foto nr. 118. Shënimi i ditës Botërore të Mjedisit.

17.13. Cenzusi ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit

(2020) - Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës me ndihmën e vullnetarëve nga "WildlifeAlbanian Photographers - WAPH", "Kosova Wildlife Care - KWC" si dhe ekspert e dashamir të natyrës kanë kryer për herë të dytë me radhë në Kosovë Censusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit. Ky aktivitet i realizuar në kuadër të IWC 2020 (International Waterbird Census) që organizohet në nivel botëror, që prej 54 vitesh, nga Wetlands International, ka përfshirë pothuajse të gjitha vendet ku ka prezencë të baseneve ujore.
Duke marrë parasysh të ftohtit e muajit janar Liqeni i Livoqit dhe ai i Përlepnicës ishin plotësisht të ngrira. Liqeni i Vasileves si dhe Ligatina e Hencit edhe pse të ngrirë janë vizituar nga ekipa e terenit me ç`rast janë evidentuar vetëm disa lloje te shpendëve jo-ujore.
Të vetmet sipërfaqe, pjesërisht të ngrira, ku kishte shpendë uji ishin Liqeni i Badovcit, Liqeni i Batllaves, Liqeni i Radoniqit. Nga rezultatet e mbledhura mund të konstatohet se u vrojtuan 12 lloje të shpendëve të ujit me një numër total prej gjithsej 9.334 individësh. Shumica e shpendëve të ujit të numëruar me këtë rast ishin *Anas platyrhynchos* me 7315 individë, Anas crecca me 1330 individë dhe *Chroicocephalus ridibundus* me 453 individë që përbënin së bashku 97,49% të numrit të përgjithshëm të shpendëve.

17.14. Flora e Kosovës pasurohet edhe me një gjini dhe lloj të ri bimor

(2020) - Zyrtarët nga Drejtoria e Parkut Kombëtarë Sharri dhe nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, kanë zbuluar një gjini dhe lloj të ri për florën e Kosovës - Sternbergia colchiciflora Waldst. et Kit. (*Amaryllidaceae*). Rezultatet janë publikuar në revistën prestigjioze të fushës së botanikës - Acta Botanica Croatica. Pothuajse 30 individë të rritur të këtij lloji u regjistruan për herë të parë në Kosovën jugperëndimore, në lokalitetin e Kanionit të Drinit të Bardhë afër Urës së Fshejt.
Duke marrë parasysh numrin e ulët të individëve dhe shpërndarjen shumë të kufizuar, ky lloji duhet të trajtohet si takson i rrezikuar në mënyrë kritike në Kosovë.
Sternbergia colchiciflora është lloj në Lista te Kuqe të llojeve të rrezikuara, të përkeqësuar dhe gati të kërcënuara në shumë vende të Evropës. Ky llojë është renditur gjithashtu në Shtojcën II të Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër (CITES). Përcaktimi i nivelit të rrezikshmërisë se llojit është bërë duke u bazuar në kriteret e IUCN.



Foto nr. 119. *Sternbergia colchiciflora Waldst. et Kit.* (*Amaryllidaceae*)

17.15. Publikohet Libri i Kuq i Faunës së Kosovës

(2019) - Publikimi i Librit të Kuq të Faunës së Kosovës është realizuar në kuadër të projektit "Inventarizimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës" si pjesë e Programit Mjedisor te Kosovës (PMK) financuar nga Qeveria Suedeze - SIDA.
Në kuadër të projektit për hartimin e Librit të Kuq të Faunës janë realizuar edhe aktivitete tjera si: përgatitja e metodologjisë së punës për hartimin e Librit të Kuq të Faunës bazuar në kriteret e IUCN, puna hulumtuese në terren dhe organizimi i punëtorive me institucione relevante.
Finalizimi i këtij projekti ka rendësi të madhe për MMPHI, MBPZHR, UP, QJQ dhe institucionet tjera te sektorit te mbrojtjes se biodiversitetit sepse për herë të parë në Kosovë është berë inventarizimi i faunës dhe në baze të dhënave të Librit të Kuq të Faunës, do të hartohen politikat dhe strategjitë për mbrojtjen dhe konservimin e faunës në Kosovë.

Ne Librin e Kuq te Faunës te Republikës se Kosovës janë përfshire gjithsejte 306 lloje, të cilat u takojnë këtyre grupeve te shtazëve: *Gastropoda, Bivalvia, Oligochaeta, Hirudinea, Arachnida (Araneae, Mesostigmata), Malacostraca, Diplopoda, Insecta (Ephemeroptera, Plecoptera, Odonata, Coleoptera, Mecoptera,Diptera, Trichoptera, Lepidoptera), Cyclostomata, Actinopterygii, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mammalia*.

Gjatë implementimit të projektit për Librin e Kuq në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës në aktivitetet e hulumtimit të kafshëve, është evidentuar edhe prania për here të pare e një lloj te ri ne Kosove. Ky lloj takon grupit Insecta, rendit Trichoptera dhe gjinisë *Potamophylax*, *grupit Juliani*, qe është grup endemik i Ballkanit me përhapje të ngushtë.

Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës të Republikës se Kosovës i takon grupeve: Insecta (140 lloje), Mammalia (39), Aves (24), Reptilia (20) dhe Gastropoda (20), kurse grupet e tjera janë te përfaqësuara me numër më të vogël të llojeve.



Foto nr. 120. Libri i Kuq i Faunë

17.16. Zbulohet një lloj i ri për faunën e Kosovës

(2019) - Në kuadër të procesit për hartimin e Librit të Kuq të Faunës së Kosovës, të realizuar në kuadër të Programit Mjedisor për Kosovën KEP 2016, në mesin e shumë llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës, është zbuluar edhe një lloj i kërmillit që për herë të parë përmendet në listën e llojeve shtazore të Kosovës.

Lloji i kërmillit *Vertigo moulinsiana* është gjetur në zonat e përmbytura të lumit Lepenc në fshatin Drekovc të Ferizajt, në një ekosistem të livadheve me lagështi i rrethuar me toka punuese dhe pyje të plepit. Sipas burimeve të deritanishme nga hulumtimet e realizuara në Kosovë, nuk ka qenë i identifikuar më herët në vendin tonë. Sa i përket shkallës së rrezikshmërisë në nivel Evropian, sipas kategorizimit nga Unioni Ndërkombëtarë i Konservimit të Natyrës (IUCN), lloji është vlerësuar se i takon kategorisë "I përkeqësuar" (Vulnerable A2ac).

Lloji është identifikuar gjatë hulumtimeve të realizuara në Kosovë nga ekspertët hungarez në bashkëpunim me ekspertin e Kosovës nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Prishtinës. Ky aktivitet ishte pjesë e hulumtimeve për hartimin e Librit të Kuq të Faunës së Kosovës, që është realizuar nga Institutit për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Programit Mjedisor për Kosovën KEP 2016. [32]

[32] Të dhëna më të detajuara për llojin janë prezantuar në punimin e publikuar në edicionin e muajit shkurt 2019, të Buletinit të IUCN nga Grupi i Specialistëve të Butakëve, të cilin e gjeni në linkun vijues https://www.hawaii.edu/cowielab/Tentacle/Tentacle_27.pdf.



Foto nr. 121. Vertigo moulinsiana, lloj i ri për faunën e Kosovës

17.17. Kosova anëtarësohet në organizatën ndërkombëtare IUCN

Në vitin 2019 Republika e Kosovës është anëtarësuar në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), selia e së cilës ndodhet në Zvicër. Procesi i anëtarësimit në këtë organizatë është udhëhequr nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkërendim dhe koordinim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Me këtë anëtarësim, Kosova fuqizon edhe më tutje subjektivitetin e saj ndërkombëtar. Ndërsa përfitimet për vendin do të jenë të shumëanshme në çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë dhe mandatin e organizatës.

IUCN është organizata e vetme për mbrojtjen e natyrës, duke siguruar kështu, që çështja e ruajtjes së natyrës të ketë zërin e saj në nivel më të lartë të qeverisjes ndërkombëtare.

Figura nr. 10. IUCN

17.18. Trajnimi i stafit të Parqeve Kombëtare për monitorimin e faunës së egër

(2018) - Ky trajnim është organizuar në kuadër të komponentës së dytë të Programit KEP 2016, "Monitorimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës".
Programi Mjedisor për Kosovën, i propozuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është mbështetje e ofruar nga SIDA dhe i menaxhuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Pjesëmarrës të trajnimit janë kryesisht stafi i parqeve kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshket e Nemuna" dhe zyrtarë tjerë nga institucionet qendrore që puna e tyre ndërlidhet me menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e zonave të mbrojtura apo edhe hartimin e politikave për sektorin e natyrës. Teknika dhe metoda për monitorimin e faunës së egër para pjesëmarrësve po demonstrohen nga ekspertë vendore të fushave përkatëse.



Foto nr. 122. Trajnimi i stafit të Parqeve Kombëtare për monitorimin e faunës së egër

17.19. Vendosen platforma për fole të lejlekëve

(2018) IKMN në bashkëpunim me kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike (KEDS), kanë bëre vendosjen e platformave për fole të lejlekëve në disa shtylla elektrike, në disa lokalitete në Komunën e Kaçanikut. Vendosja e këtyre platformave folenizuese, të përgatitura nga ana e KEDS - it, me udhëzim dhe rekomandim të IKMN-së, është praktike në shumë vende evropiane por edhe nga rajoni dhe ka si qëllim zhvendosjen e folesë për së paku gjysmë metër mbi linjat e energjisë me tension të lartë duke shmangur prekjen e telave me materialet e folesë. Njëra prej qëllimeve të këtij aktiviteti, përveç krijimit të kushteve për mbrojtjen e këtij lloji të rrallës të faunës sonë është gjithsesi edhe promovimi i një shembulli pozitiv për të mbrojtur lejlekun e bardhë dhe habitatin e saj.



Foto nr. 123. Vendosja e platforma për folet e lejlekëve

17.20. Ekspeditë hulumtuese Speleologjike

(2019) Instituti i Kosove për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me shoqatën speleologjike Bullgare kanë realizuar një ekspeditë hulumtuese në shpellat e Kosovës. Gjatë kësaj ekspedite janë bërë matjet e korridoreve dhe galerive të disa shpella në Malin Mokna, (Shpella e madhe e Gollostenës, Shpella e Vogël e Gollostenës, Shpellat Binjaket, Shpella e Keqe, etj.), konkretisht në komunën e Istogut, po ashtu janë punuar edhe hartat (profili) për shpellat e hulumtuar.



Foto nr. 124. Ekspeditë hulumtuese Speleologjike

17.21. Bashkëpunimi me Shoqatën Evropiane "Brezi i Gjelbër Evropian"

Nisma për Brezin e Gjelbër Evropian është iniciuar që nga viti 2003, vazhdoi mandej me 24 shtator 2014, në Sllavonice të Republikës Çeke, ku themelua Shoqata Evropiane "Brezi i Gjelbër", ndërsa regjistrimi zyrtar i saj u bë në muajin shkurt të vitit 2015.

Deri më tani në të janë anëtarësuar 27 organizata qeveritare dhe joqeveritare me gjithsej 14 shtete evropiane si dhe është themeluar Bordi i saj në të cilin marrin pjesë 7 organizata dhe është vendosur që kryesuese të jetë fondacioni EURONATYRA nga Gjermania.

Në këtë Shoqatë përveç 16 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian bëjnë pjesë edhe disa shtete jo anëtare të saj, siç janë: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut, Turqia, etj. Kosova është anëtarësuar në "Brezi i Gjelbër Evropian", në vitin 2015 dhe përfaqësohet nga Institutit të Kosovë për Mbrojtjen e Natyrës. Ndërsa zonat të cilat përfshinë në kuadër të tij janë pjesët e parqeve kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" , si dhe parku i natyrës "Pashtriku".



Harta nr. 10. Harta e shtrirjes së Brezit të Gjelbër

17.22. Aktivitetet e organizuara nga MMPH për shënimin e "Ditës Ndërkombëtare të biodiversitetit" dhe promovimin e vlerave të natyrës 2018 - 2021

(2018) MMPH-ja, në bashkëpunim me organizatat dhe institucionet tjera relevante si komunat, OJQ "ERA", "FINQ", "KERRC", shoqërinë civile dhe Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" kanë shënuar 22 majin - Ditën Botërore të Biodiversitetit në ambientet e këtij universitetit, ku temë kryesore ishte integrimi i biodiversitetit, mbështetjes për njerëzit, si dhe jetesës së komuniteteve.





Foto nr. 125 dhe 126. Shënimi i Ditës Botërore të Biodiversitetit (2018)

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me biodiversitetin, Ministria gjatë vitit 2019 shënoi Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit, në lokacionin Limth, në hapësirat e Parkut Kombëtar "Sharri", me moton "Biodiversiteti ynë, ushqimi ynë, shëndetit ynë".



Foto nr. 127. Shënimi i Ditës Botërore të Biodiversitetit (2019)

MMPHI –ja, sipas kalendarit mjedisor në bashkë organizim me UP-në, Komunën e Prishtinës dhe OJQ-të “ Era” dhe Kosova Environmental Education & Research Center, ne vitin 2021 shënoi Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit në peisazhin e mbrojtur “Gërmia” në Prishtinë. Motoja ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit për vitin 2021 ishte: “Ne jemi pjesë e zgjidhjes”.



Foto nr. 128. Shënimi i Ditës Botërore të Biodiversitetit (2020)

XVIII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Gjendja e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit në Kosovë është jo e kënaqshme dhe e kushtëzuar nga faktorët biotik dhe abiotik. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e vendit.

Konkluzionet

1. Implementimi pjesshëm i ligjeve në fuqi që lidhen me çeshtjën e ruajtjes së vlerave natyrore dhe biodoversitetit;
2. Mungesa e institucioneve për mbrojtjen e natyrës;
3. Numri i pamjaftueshëm i stafit profesional në IKMN
4. Numri i pa mjaftueshëm i inspektorëve për mbrojtje e natyrës,
5. Mungesa e stafit në Drejtorit e Parqeve Kombëtare dhe në organet tjera menaxhuese për zonat e mbrojtura;
6. Mos miratimi i planit hapësinore për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
7. Mungesa e planit menaxhuese për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe zonave tjera të mbrojtura (PM. "Germia", MNRV, Shpella e Gadimes, Parku i Natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës" dhe Peisazheve) etj;
8. Mungesa e Planeve Rregulluese për zonat e treta në Parqet Kombëtare;
9. Mos themelimi i organeve manxhuese për zonat e mbrojtura të parapara sipas ligjit (MNRV "Shpella e Gadimes" dhe "Ujëvarat e Mirushës", PN "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës" ZVM "Ligatina e Hencit" dhe Peisazheve të Mbrojtura etj.
10. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore në zonat e mbrojtura;
11. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve minerale (shkëmbinjëve gëlqeror nga gurthyesit);
12. Shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve në shtratin e lumenjve;
13. Numri i madh i ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura;
14. Mungesa e hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
15. Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitateve të tyre;
16. Fondet e pamjaftueshme për mbrojtjen e natyrës;
17. Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura (asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve, ndërtimet ilegale, prerja e pyjeve, hapja dhe zgjerimi i rrugëve të reje, ndërtimet infrastrukturore, zjarret, mbeturinat etj.);
18. Turizmi i pa kontrolluar në zonat e mbrojtura;
19. Gjuetia ilegale ne zonat e mbrojtura.

Rekomandimet

